

PËRFAQËSIMI I KOMUNITETEVE NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

SEVDIE KADRIU

Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin Juridik, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku**

Numri i fjalëve: 58.018

Tiranë, Maj 2016

DEKLARATË E AUTORSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë autorë tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Pikëpamjet e prezantuara në këtë punim doktoral, janë personale dhe nuk pasqyrojnë gjithsesi pikëpamjet e ndonjë prej institucioneve të përfshira në këtë studim.

ABSTRAKTI

Një vend, i cili dëshiron të jetë pjesë e vendeve të botës, demokratike duhet të plotësojë edhe kriterin e ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme dhe demokratike, duke pasur parasysh para se gjithash respektimin e të drejtave të grupeve të caktuara të shoqërisë-sidomos nga aspekti etnik. Prandaj, shumë organizma ndërkombëtare dhe vende të ndryshme të botës çështjen e përfaqësimit të komuniteteve pakicë nëpër institucione shtetërore e trajtojnë në agjendën prioritare të hulumtimeve shkencore, si një çështje të rëndësishme së veçantë ose edhe si një çështje e cila gjithnjë e më tepër pretendohet të rregullohet me norma të përgjithshme unike ndërkombëtare. Pra, janë grupet etnike ato të cilat vazhdojnë të mbledhin elitat e ndryshme politike dhe shkencore nëpër konferenca e simpoziume, takime të ndryshme ndërshtetërore për të shtruar dhe zgjidhur probleme të ndryshme minoritare nëpër shumë vende.

Fillimi i procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, në fund të viteve të 80-ta, i dha fund kësaj krijese artificiale të bazuar në hegjemoninë serbe dhe hapi rrugën për realizimin e së drejtës në vetëvendosje të kombeve dhe krijimin e shteteve të reja të pavarura. Këto procese ishin rrjedhojë logjike e proceseve demokratike të zhvilluara në rajon në frymën demokratike dhe që shënuan fundin e diktaturave socialiste të politikave hegjemoniste në rajon.

Fillet e tranzicionit demokratik në Kosovë i hasim në fillim të vitit 1990, në kohën e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, kur shqiptarët e Kosovës, krahas deklarimit për pavarësi, braktisën edhe sistemin monist jugosllav dhe bënë hapat e parë drejt pluralizmit

politik dhe organizimit demokratik të vendit. Edhe pse gjatë periudhës së okupimit (1990-1998), në Kosovë janë mbajtur dy cikle të zgjedhjeve parlamentare, nuk mund të flitet për një fillim të parlamentarizmit dhe tranzicionit demokratik të shoqërisë në Kosovë sepse ajo gjatë kësaj periudhe ballafaqohej me sfidën e mbijetesës së okupimit nga Serbia. Organizimi paralel i institucioneve më tepër paraqiste një tentativë për ndërtimin e pavarur të strukturave shtetërore, sesa paraqiste një funksion të mirëfilltë të pushtetit.

Pas luftime, Kosova, në bazë të Rezolutës 1244 ishte nën Protektoratin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që nënkuptonte administrimin e përkohshëm të Kosovës nga kjo organizatë e cila, këtë e bënte me Misionin e saj në Kosovë të njohur me shkurtesën UNMIK. Misioni i Organizatës Kombeve të Bashkuara në Kosovë UNMIK-u udhëhiqej nga Autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-se, i cili kishte për detyrë të ndihmonte vendorët në krijimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ). Misionin e tyre e filluan së pari me formimin e Këshillit të Përkohshëm Administrativ-(KPA), në të cilin ishin të përfaqësuara të gjitha grupet politike dhe bashkësitë etnike që jetonin në Kosovë, ndërsa më vonë nxirret Korniza Kushtetuese e Kosovës, dokument i cili ishte miratuar me konsensus në mes të strukturave ndërkombëtare dhe UNMIK-ut në njërën anë dhe atyre vendore të KPA-së në anën tjetër. Përmes kësaj kornize filloi ndërtimi i institucioneve vendore nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, krejt kjo deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt 2008 dhe nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës po në të njëjtin vit.

Gjatë gjithë kësaj kohe, krahas shtet ndërtimit institucional të Kosovës, është ndërtuar edhe infrastruktura ligjore e cila kishte të bënte me promovimin e minoriteteve, të cilat jetonin

në Kosovë. Në të njëjtën kohë, u përcaktuan kuotat dhe mënyrat e përfaqësimit të tyre në të gjitha institucionet shtetërore, nga niveli komunal- në nivelin qendror e presidencial.

Pra, nëpërmes të këtij studimi jam përpjekur që të pasqyroj shkallen e përfaqësimit të komuniteteve neper institucionet shtetërore, dhe zbatimin e politikave publike përmes normave ligjore dhe ndikimi i faktorëve të tjerë të jashtëm me qëllim të arritjes së krijimit të mbi-përfaqësimit për grupe të caktuara minoritare.

Fjalët kyçe: sistem, institucione, komunitete pakicë, mbi-përfaqësim.

ABSTRACT

In order for a county to be part of the democratic world it must meet certain criteria of building democratic and sustainable institutions, having into consideration human rights for specific groups of society, especially their ethnic aspect. There are many different international organizations and different countries worldwide, the representation and integration of non-majority communities into their states' institutions, is part and priority of their investigation agenda, and study cases in regards to special issues or matters that is aiming to be regulated with more general and unique norms. So, there are different ethnic groups that continue to meet up with their political and special elite groups in different conferences and symposiums, or interstate meetings in order to help in resolving different minority problems that exist in different countries.

Since the start of collapse of former Yugoslavia, which happened late 80s, and ended the artificial ruling state, lead to Serbian hegemony against other nations, it opened the road for self-determination for former Yugoslav nations which created new independent states. Those processes were part of initial democratic steps and logical aftermath of the region as a new democratic era which ended socialist dictatorships and hegemonic regimes in the region.

Early 1990 Kosovo started of organizing and transitioning parallel democratic institutions, at the time of the breakup of the Yugoslav Federation, the Albanians of Kosovo, along with the declaration of independence, left the monist party system in Yugoslavia, and made steps towards political pluralism and democratic organization of the country. Although during

the period of occupation (1990-1998), Kosovo has held two early parliamentary and democratic elections which helped transition of the society in Kosovo that faced the survival challenge occupation by Serbia. The organizing of more parallel institutions represent an effort to build independent state structures, rather than presenting a genuine function of independent building institutions and the government.

After the war, based on UN resolution 1244, Kosovo was under governing authority of Security Council of the United Nations, which meant the interim administration of Kosovo, known by the acronym UNMIK. The Organization of the United Nations in Kosovo, known as UNMIK, was the heard authority and was headed by Special Representative of the Secretary-General of UN, with the mission to assist locals in creating the Provisional Institutions of Self-Government (PISG). Their first mission began with the formation of the Provisional Administrative Council (PAC), that was meant to represent all political groups and ethnic communities living in Kosovo, and later implemented the Constitutional Framework, that was a document which was adopted by consensus among the international structures and UNMIK, and local PAC on the other side. Through this framework began construction and building of local institutions under international supervision, until the declaration of independence of Kosovo, on February 17, 2008, which lead to creating the Constitution of the Republic of Kosovo at same year.

Throughout this time, besides the Kosovo state institution building, legal infrastructure was built which had to do with the promotion of minorities that live in the country. At the same

time, seats were determined and ways of their representation in all state institutions, from the municipal, central and presidential level.

Through this study and other general analyses that were done in regards to this problem, emphasizes the manner of representation for small communities in the state institutions, the techniques that were applied through the laws, norms and other outside factors aiming representation of specific minority groups

Key words: *system, institutions, non-majority communities, representation*

DEDIKIMI

Ky punim doktoral i dedikohet me shumë kënaqësi njerëzve më të afërt që më rrethojnë dhe më vlerësojnë, veçanërisht prindërve të mi dhe familjes sime që më kanë mbështetur përgjatë gjithë kësaj sfide dhe rrugëtimit të vështirë, të cilët nuk kursyen asgjë nga vetja e tyre për gjithçka që kam arritur deri më sot.

FALENDERIME

Së pari, një falënderim i veçantë për Prof. Asoc. Dr. Migena Leskovikun, e cila si udhëheqëse e temës së doktoratës, përkundër shumë angazhimeve më ka orientuar e mbështetur gjatë gjithë punës së bërë.

Falënderim dhe mirënjohje po ashtu kam edhe për udhëheqësin PhD. Ervis Iljazaj dhe Prof. Dr.Tonin Xhuraj, të cilët përgjatë gjitha ditëve doktorale më kanë udhëhequr dhe sugjeruar në vazhdimësi, me qëllim që puna ime sot të kurorëzohet me sukses.

Gjithashtu, një detyrim i sinqertë mirënjohjeje përveç prindërve dhe familjes sime shkon edhe për kolegët e grupit të gjeneratës së parë të studimeve të doktoratës në UET të cilët më kanë ndihmuar në drejtim të realizimit të temës duke shkëmbyer ide dhe duke diskutuar për çështje të debatueshme që kanë qenë në fokus të trajtimit.

Sevda

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakti

Dedikimi

Falënderime

Lista e shkurtesave

Tabelat

Përmbajtja

KAPITULLI I	2
1. Hyrje	2
1.1. Struktura e punimit doktoral	9
1.2. Objektivat e përgjithshme të punimit	12
1.3. Metodologjia e punës kërkimore	13
1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat	16
1.5. Literatura dhe kufizimet gjatë trajtimit të punimit	17
KAPITULLI II	19
2. SHPJEGIME HYRËSE MBI ÇËSHTJEN E MINORITETEVE	19
2.1. Konceptet dhe nocionet themelore mbi minoritetet	19
2.2. Vështrime të përgjithshme historike lidhur me trajtimin e minoriteteve	24
2.3. Instrumentet ndërkombëtare për trajtimin e çështjes së minoriteteve	27
KAPITULLI III	34
3. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI TË DREJTAT E MINORITETEVE QË JETOJNË NË KOSOVË	34
3.1. Pozita e minoriteteve në Kosovë në periudha të ndryshme kohore	34
3.2. Struktura e popullatës sipas komuniteteve që jetojnë në Kosovë	42

3.2.1.	<u>Komuniteti shqiptar</u>	44
3.2.2.	<u>Komuniteti serb</u>	46
3.2.3.	<u>Komuniteti boshnjak</u>	50
3.2.4.	<u>Komunitetit turk</u>	52
3.2.5.	<u>Komuniteti rom</u>	53
3.2.6.	<u>Komuniteti ashkali</u>	55
3.2.7.	<u>Komuniteti egjiptian</u>	57
3.2.8.	<u>Komuniteti goran</u>	58
<u>KAPITULLI IV</u>		60
4.	<u>KONCEPTET DHE NOCIONET THEMELORE MBI PËRFAQËSIMIN</u>	60
4.1.	<u>Përfaqësimi i minoriteteve në Republikën e Kosovës në organet e nivelit qendror</u>	67
4.1.1.	<u>Pjesëmarrja e minoriteteve në Zyrën e Presidencës</u>	68
4.1.2.	<u>Pjesëmarrja e minoriteteve në Pushtetin Legjislativ</u>	70
4.1.3.	<u>Pjesëmarrja e minoriteteve në përbërjen e Pushtetit Ekzekutiv</u>	76
4.1.4.	<u>Përfaqësimi në Shërbimin Civil të Kosovës</u>	85
4.1.5.	<u>Përfaqësimi në Sektorin e Sigurisë</u>	98
4.1.6.	<u>Përfaqësimi në Agjencionet e Pavarura</u>	113
4.2.	<u>Përfaqësimi i minoriteteve në Pushtetin Gjyqësor</u>	121
4.3.	<u>Përfaqësimi i minoriteteve në Republikën e Kosovës në organet e nivelit lokal</u>	130
<u>KAPITULLI V</u>		138
5.	<u>SISTEMI ZGJEDHOR NË KOSOVË</u>	138
5.1.	<u>Sistemi zgjedhor në Kosovë nga aspekti i pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë</u>	138
<u>KAPITULLI VI</u>		150
6.	<u>ANALIZA E KORNIZËS LEGJISLATIVE PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE PAKICË QË JETOJNË NË KOSOVË</u>	150
<u>6.1 Aspekte krahasuese të legjislacionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në vendet e rajonit</u>		177
6.1.1.	<u>Kroacia</u>	178
6.1.2.	<u>Mali i Zi</u>	180
6.1.3.	<u>Serbia</u>	182
6.1.4.	<u>Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM)</u>	183

6.1.5. Shqipëria	187
<u>KAPITULLI VII</u>	191
<u>KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME</u>	191

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BE- Bashkimi Evropian

BNK- Bashkëpunim Ndërkufitar

BNj - Burime Njerëzore

DASHC- Departamenti i Administratës së Shërbimit Civile

EULEX- Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

ECMI- Qendra Evropiane për Çështje të Komuniteteve pakicë

FSK- Forca e Sigurisë së Kosovës

IGJK- Instituti Gjyqësor i Kosovës

IPK- Inspektorati Policor i Kosovës

KPA- Këshilli i Përkohshëm Administrativ

KGJK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK- Këshilli Prokurorial i Kosovës

KKK- Këshilli Konsultativ për Komunitete

KKR- Komisioni Komunal për Ri integrim

KDIKK- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

KPMK- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës

KQZ- Komisioni Qendror Zgjedhor

KKMPK - Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

KNEDR- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit
Racor

KSAK- Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

KLDMNJ- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

LVL- Ligji për Vetëqeverisje Lokale

LZL - Ligji për Zgjedhje Lokale

MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim

MAP- Ministria e Administratës Publike

MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

NP- Ndërmarrje Publike

NjKDNj - Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

PA- Pakoja e Ahtisarit

PQ -Pushteti Qendror

PNDKP- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

PK- Policia e Kosovës

RS- Republika e Serbisë

RAE- Komuniteti rom, ashkali, egjiptian

SHCK- Shërbimi Civil i Kosovës

UNMIK- Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

EULEX- Sistem i Drejtësisë Evropiane në Kosove

ZCK-ZKM- Zyra për Çështje të Komuniteteve-Zyra e Kryeministrit

ZKKK -Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Tabelat:

Tab. 1: Rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 sipas strukturës etnike të popullsisë

Tab. 2: Komunitat në të cilat shqiptarët janë komunitet pakicë në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011

Tab. 3: Komunitat në të cilat serbët janë komunitet pakicë në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 si dhe raporteve të OSBE-së mbi profilet e komuniteteve nga viti 2010 dhe raportit mbi profilet e komunave të vitit 2013

Tab. 4: Numri i të punësuarve në nivelin qendror të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve

Tab. 5: Numri i të punësuarve në nivelin lokal të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve

Tab. 6: Numri i të punësuarve në nivel vendi të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve

Tab. 7: Struktura etnike brenda Policisë së Kosovës (stafi me uniformë dhe civil)

Tab. 8: Struktura etnike brenda Policisë së Kosovës (stafi me uniformë, pa përfshirë stafin civil)

Tab. 9: Struktura etnike brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës

KAPITULLI I

“Ekzistenca e një minoriteti është një çështje fakti dhe jo një çështje e së drejtës”

Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare,

1930

1. Hyrje

Kosova pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008 është përfshirë në një proces të rëndësishëm tranzicioni në drejtim të fuqizimit të pavarësisë dhe sovranitetit shtetëror, në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore demokratike si parakusht për të siguruar një shoqëri të qëndrueshme dhe shumë-etnike. Njëra ndër premisat themelore që një synim i tillë të arrihet ishte dhe vazhdon të jetë përfshirja e komuniteteve pakicë pavarësisht grupit etnik që i takojnë, brenda sistemit kushtetues dhe juridik të vendit si dhe integrimi sa më i gjerë i tyre, në strukturat e pushtetit qoftë në nivel lokal apo qendror.

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara në vitin 2014, nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, numri i përgjithshëm i popullsisë që jetojnë në Kosovë është 1.815.606 banorë.¹ Shumicën dërmuese të këtij numri të përgjithshëm e përbëjnë shqiptarët me rreth 92%, kurse pjesa tjetër, përbëhet kryesisht nga serbët me rreth 3.5%, të cilët kryesisht janë të shpërndarë në enklava serbe, si dhe grupet e tjera etnike që përbëjnë po ashtu rreth 3.5% të numrit total.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vlerësim Popullsia e Kosovës 2013, shtator 2014

Korniza ligjore që ndërlidhet me mbrojtjen e të drejtave të gjitha grupeve etnike që jetojnë në Kosovë, përkrahet fuqimisht nga një gamë e gjerë institucionesh në nivel qendror të cilat bartin përgjegjësinë kryesore për hartimin si dhe zbatimin e këtyre akteve juridike që shërbejnë për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve në përgjithësi si dhe përfaqësimit të tyre në veçanti. Në këtë rrafsh, pas themelimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, qysh në vitin 2002 është themeluar Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore, e cila ka funksionuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në atë periudhë dhe ka pasur për qëllim që të monitorojë dhe të ofrojë këshilla për ministrinë brenda fushëveprimit të tyre, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, inkurajimin e mundësive të barabarta, lidhur me çështjet gjinore si dhe me avancimin e një qeverisje të mirë.

Si rrjedhojë, në vitin 2007 në kuadër të secilës ministri të Qeverisë së Kosovës janë themeluar njësi të veçanta për të drejtat e njeriut, që roli i tyre nuk ka qenë ekskluzivisht vetëm mbikëqyrja e përputhshmërisë së politikave, legjislacionit dhe aktiviteteve të udhëhequra nga këto institucione me standardet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por edhe mbikëqyrja sa i përket shkallës së përfaqësimit të komuniteteve jo shumice në jetën politike dhe institucionale të Kosovës.

Për dallim nga vendet tjera, termi “komunitet” në Republikën e Kosovës përdoret për të treguar dy çështje të ndryshme: e para, me termin komunitet nënkuptohet një grup njerëzish me tipare të përbashkëta etnike, gjuhësore, kulturore, religjioze, historike etj, kurse e dyta, në aspektin ligjor ky term ju atribuohet minoriteteve apo grupeve etnike që janë rezident në Kosovë. Pra, legjislacioni kosovar termin komunitet e përkufizon si: grupe

kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura me ligj.² Ky përkufizim nuk e përjashton mundësinë që secili pjesëtar që i takon një komuniteti ka të drejtën që lirisht të zgjedh se dëshiron apo jo të trajtohet si i tillë, dhe në raste të tilla, nuk do të rezultojë asnjë dëm apo diskriminim, nëse ai zgjedh të ushtrojë apo jo të drejtat të cilat lidhen me komunitetin.³

Në këtë sens, të gjithë qytetarëve që jetojnë në Republikën e Kosovës ju njihen në mënyrë të barabartë të drejtat elementare të njeriut, siç mund të jenë: liria e të menduarit, të shprehurit, të mediave, të grumbullimit në asociacione të ndryshme, të besimit dhe ushtrimit të fesë, mbrojtja e përgjithshme kundër diskriminimit, e drejta në jetë e tjera. Në këtë kuadër, edhe komunitetet që përbëjnë popullatën pakicë të Kosovës, kanë të drejtë që në mënyrë të lirë të pa penguar të kultivojnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre, duke ruajtur identitetin e tyre përmes avancimit të elementeve esenciale që lidhen me identitet siç janë: feja, gjuha, tradita, dhe trashëgimia kulturore .

² Ligji Nr. 04/L-020 per ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 per Mbrojtjen dhe Promovimin e te Drejtave te Komuniteteve dhe Pjesëtarëve te tyre ne Republikën e Kosovës, neni 1, paragrafi 1.4

³ Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1, paragrafi 1.5

Këto të drejta fundamentale duke përfshirë edhe të drejtat shtesë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, burojnë nga një sërë aktesh juridike të aprovuara, qoftë të nivelit primar apo sekondar, duke filluar nga vet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila në një kapitull të veçantë trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke vazhduar me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, që së bashku, përbëjnë kornizën baze legjislative mbi të drejtat e komuniteteve.

Të gjithë qytetarët e Kosovës, janë të mbrojtur me ligj nga diskriminimi qoftë direkt apo në mënyrë të tërthortë mbi baza të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo religjioz. Në këtë aspekt, Republika e Kosovës garanton që të gjitha komunitetet t'i gëzojnë në mënyrë tërësisht të barabartë të drejtat e tyre elementare, duke ndërmarrë masa adekuate për përmirësimin e situatave ku këta persona mund të përjashtohen nga ushtrimi i barabartë i të drejtave të tyre siç mund të jenë: masat për promovimin e barazisë së plotë në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore duke përfshirë edhe arsimin, median, shëndetësinë dhe shërbimet e tjera publike.⁴

Njëra ndër elementet më të rëndësishme në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në Kosovë, përveç të drejtave të veçanta që u njihen lidhur me përfaqësimin e tyre në organet legjislative dhe ekzekutive, lidhet edhe me nivelin e përfaqësimit të tyre në kryerjen e shërbimeve publike, si një kusht i domosdoshëm në këtë drejtim duke u bazuar në parimet e përgjithshme të mos-diskriminimit, mundësive të

⁴ Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 3, paragrafi 3.3

barabarta dhe përfaqësimit të barabartë. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të kenë përfaqësim të duhur dhe proporcional në shërbimin civil si dhe në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.⁵ Në këtë aspekt, së paku 10% të pozitive në nivel të pushtetit qendror duhet të jenë të plotësuar me staf nga komunitetet jo shumicë që jetojnë në Kosovë, dhe që i përmbushin kriteret për punësim, ndërsa, në organet e nivelit lokal përfaqësimi i komuniteteve duhet të reflektojë në mënyrë proporcionale me përbërjen demografike në komunë.⁶ Për më tepër, ekziston Rregullorja e veçantë për Procedurat e Përfaqësimit të Duhur dhe Proporcional të Komuniteteve që nuk janë shumicë në Shërbimin Civil të Kosovës, që është derivat i Ligjit mbi Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, e që në mënyrë të detajuar përcakton procedurat për përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal.

Në këtë drejtim, përveç proporcionit të përgjithshëm për pozitat e rezervuara për komunitete jo shumicë në nivel qendror, së paku 10% e posteve brenda kategorive funksionale i rezervohen këtyre komuniteteve duke i lënë mundësinë secilit institucion që të përcaktojë se cilat së paku dy prej katër kategorive funksionale në kuadër të standardeve duhet të rezervojnë këtë 10 % të posteve për komunitetet jo shumicë që jetojnë në Kosovë.

Përfaqësimi efektiv i këtyre komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës, në jetën politike dhe institucionale vlerësohet si një element qenësor për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe shumë-etnike, që përbën krijim të kushteve të përshtatshme për integrim në institucionet shtetërore të Kosovës. E drejta e përfaqësimit, siç dihet fare mire,

⁵ Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 5, paragrafi 5.1

⁶ Po aty, neni 11

është e ndërlidhur me standarde të njohura ndërkombëtarisht, si dhe me të drejtat elementare, siç janë: barazia e plotë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit dhe kulturës në përgjithësi të pakicave kombëtare.⁷ Po ashtu, të drejtën e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, e parasheh shumë qartë edhe një dokument tjetër shumë i rëndësishëm siç është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁸ sipas të cilit, komunitetet jo shumicë kanë të drejtë dhe mundësi të marrin pjesë në drejtimin e punëve publike, në mënyrë direkte apo përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të ligjshme dhe demokratike.

Duke u nisur nga akti më i lartë juridik i vendit siç është Kushtetuta si dhe instrumentet tjera juridike që e përcjellin atë, (marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare, ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore) të gjitha së bashku komuniteteve pakicë në Kosovë ju garantojnë të drejta të veçanta. Krijimi gradual i institucioneve të Kosovës dhe paralelisht hartimi i legjislacionit si dhe ndikimet e ndryshme, qoftë të brendshme apo edhe të jashtme, kanë krijuar një pozitë tejet të favorshme në aspektin e të drejtave të komuniteteve pakicë të Kosovës dhe në aspektin e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike të Kosovës. Shpallja e pavarësisë së Kosovës e pastaj themelimi i shumë mekanizmave institucional, qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë lokal, kanë krijuar mundësi që komunitetet jo shumicë, në përgjithësi, të integrohen më lehtë në shoqërinë kosovare dhe të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në jetën publike dhe politike të vendit. Në këtë kuadër, kur flasim për drejtat

⁷ Konventa Kornize e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, neni 13

⁸ Pakti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25

e minoriteteve nuk mund të lëmë pa përmendur edhe procesin e decentralizimit si një ndër proceset më të rëndësishme të institucioneve të Kosovës.

Përmes këtij procesi u mundësua krijimi i komunave të reja me shumicë serbe, me përgjegjësi apo kompetenca shtesë të deleguara nga niveli qendror tek nivelet komunale dhe në këtë mënyrë u motivua edhe integrimi i komunitetit serb për të qenë pjesë e këtyre institucioneve. Si rrjedhojë e këtij procesi është bërë i mundshëm, që komunitetet në përgjithësi, duke përfshirë këtu edhe atë serb, të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës: politike, sociale, ekonomike, kulturore etj. Kjo pjesëmarrje aktive e komuniteteve pakicë u arritë pavarësisht faktit se shoqëria kosovare si tërësi akoma ballafaqohet me probleme të shumta siç janë: ekonomia e pazhvilluar, papunësia e lartë, varfëria, migrimet, korrupsioni si dhe probleme të tjera të cilat normalisht që kanë ndikuar dhe ndikojnë në shkallën e integritetit të gjithë shoqërisë kosovare në përgjithësi, po në veçanti edhe të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Në fakt, përfaqësimin e komuniteteve pakicë në Kosovë në jetën publike të saj, e mundëson para se të gjithash korniza ligjore në fuqi, por nga ana tjetër s’duhet harruar faktin se një përfaqësim i tillë është bërë i mundshëm falë edhe një sistemi zgjedhor proporcional i cili mundëson përfaqësim të grupeve të vogla apo partive që u përkasin komuniteteve pakicë, që të jenë pjesë e përfaqësimit.

Mirëpo, edhe përkundër të gjitha këtyre masave të ndërmarra, për shkak të disa faktorëve që u përmendën më sipër, shkalla e papunësisë në Kosovë mbetet shumë e lartë, jo vetëm

kur bëhet fjalë për komunitetet pakicë po kjo çështje paraqet shqetësim edhe për pjesëtarët e komunitetit shumicë, shqiptar që jetojnë në Kosovë.

1.1. Struktura e punimit daktoral

Lënda e studimit të kësaj teme është e ndarë në shtatë kapituj dhe secili prej kapitujve trajton çështje të veçanta sipas ndërtimit të tezave të punimit.

Në kapitullin e parë, trajtohen:

- Objektivat e përgjithshme të punimit,
- Metodologjia e punës kërkimore,
- Pyetjet kërkimore dhe hipotezat,
- Literatura dhe kufizimet gjatë trajtimit të punimit.

Në kapitullin e dytë, trajtohen:

- Konceptet dhe nocionet themelore mbi minoritetet, trajtimi i minoriteteve nëpër faza të ndryshme historike si dhe trajtimi i tyre bazuar në instrumentet ndërkombëtare që lidhen me çështjen e tyre siç janë: Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 27; Konventa Kornizë për Mbrojtjen Pakicave Kombëtare të vitit 1995, etj.

Në kapitullin e tretë, trajtohen temat:

- Vështrime të përgjithshme mbi të drejtat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë,
- Pozita e minoriteteve në Kosovë gjatë periudhave të ndryshme kohore
- Struktura e popullatës sipas përkatësisë etnike që jeton në Kosovë, duke u bazuar në rezultatet zyrtare të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 si dhe duke marrë për

bazë edhe burimet alternative të raporteve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) lidhur me numrin e qytetarëve të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në pjesët veriore të Kosovës.

Në kapitullin e katërt, trajtohen:

- Konceptet themelore mbi përfaqësimin. Çka në fakt paraqet përfaqësimi, si janë të përfaqësuara komunitetet minoritare në nivele të ndryshme në kuadër të institucioneve të Kosovës etj.
- Niveli i përfaqësimit të minoriteteve në zyrën e Presidentit të Kosovës, në Kuvend, Qeveri, në Shërbimin Civil të Kosovës, pastaj niveli i përfaqësimit në Sektorin e Sigurisë si në Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe në Policinë e Kosovës. Po ashtu, në këtë pjesë të punimit është paraqitur edhe niveli i përfaqësimit të komuniteteve në Sistemin Gjyqësor, në Agjencionet e Pavarura që janë të themeluara me ligj dhe të cilat për punën e tyre i raportojnë Kuvendit të Kosovës si dhe janë dhënë edhe shpjegime lidhur me përfaqësimin e pakicave në organet e nivelit të pushtetit lokal.

Në kapitullin e pestë, trajtohet:

- Sistemi zgjedhor në Kosovë, shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë. Kësaj çështjeje ligjvënësi i ka kushtuar një vëmendje të posaçme të nxjerrjes, fillimisht, të rregulloreve të UNMIK-ut, e më vonë edhe të ligjeve nga ana e Kuvendit të Kosovës mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e denjë të komuniteteve pakicë qoftë në Kuvendin e Kosovës, qoftë edhe në Kuvende Komunale, por edhe në organe dhe mekanizmat e tjerë të rëndësishëm të nivelit të përgjithshëm dhe atij lokal.

- Gjithashtu, në këtë kapitull është trajtuar sistemi proporcional i përfaqësimit si një model më i favorshëm, dhe i cili ofron një përfaqësim më të mirë të komuniteteve në institucionet e vendit përmes arritjes së përfaqësimit edhe të grupeve më të vogla politike.

Në kapitullin e gjashtë:

- Analizohet kuadri ligjor duke përfshirë nga dispozitat kushtetuese me të cilat rregullohen aspektet që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë dhe deri te dispozitat tjera më të rëndësishme ligjore siç janë: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve si dhe Ligji Kundër Diskriminimit.

Në kapitullin e shtatë:

- Si rezultat i analizimit dhe vlerësimit të kapitujve janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse lidhur me pakicat nacionale në Kosovë. Janë evidentuar masat që janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren në të ardhmen në funksion të avancimit të drejtave të tyre në mënyrë që të rritet niveli i përfaqësimit të komuniteteve pakicë nëpër institucione publike si dhe janë propozuar strategjitë për rritjen e përqindjes së përfaqësimit, sidomos të pakicave nacionale që nuk i takojnë komunitetit serb. Për të respektuar parimin e barazisë para ligjit të të gjithë qytetareve të Kosovës, i cili është një nga parimet themeltare të Kushtetutës së Kosovës, janë propozuar edhe masa të tjera politike shumë të rëndësishme, të cilat

do të ndikonin në arritjen e një përfaqësimit sa më të drejtë të të gjitha komuniteteve, por edhe komunitetit të pakicës.

1.2. Objektivat e përgjithshme të punimit

Tema të cilës i referohem në këtë punim doktoral lidhet me përfaqësimin të pakicave kombëtare në institucionet publike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nevojat për ndryshimet që duhet të bëjë në të ardhmen, duke marrë për bazë konventat dhe standardet më të larta ndërkombëtare që trajtojnë çështjen e minoriteteve, të drejtat dhe liritë e tyre, me theks të veçantë participimin e tyre në sistemet politike në kuadër të shteteve në të cilat ato komunitete jetojnë.

Përcaktimi për t'u marrë me këtë temë ka të bëjë me pasqyrimin real të gjendjes së komuniteteve që jetojnë në Kosovë, si dhe vënia në pah e nivelit të përfaqësimit të tyre në institucione publike, që nga niveli më i ulët e deri në nivelin qendror dhe zyra e presidentit si organi më i lartë i një shteti. Trajtimi i kësaj tematike edhe sot e kësaj dite prapëseprapë paraqet një ndër sfidat më të mëdha të teorisë dhe praktikës në shumë fusha të interesit shkencor në shumë vende të botes, po edhe në Kosovë.

Rezultatet e shumë raporteve të publikuara nga misione të ndryshme ndërkombëtare, po edhe atyre vendore, që lidhen me të drejtat e komuniteteve, me theks të veçantë në aspektin e përfaqësimit të tyre në sistemin politik të vendit dhe në këtë kuadër edhe integrimin e tyre në institucionet e shtetit, e kanë tërhequr vëmendjen time për t'u marrë dhe e trajtuar problemin e vazhdueshëm të përfaqësimit të ultë të komuniteteve pakicë në të gjitha nivelet e pushtetit në Kosovë.

Në këtë kontest, objektivat kryesore të këtij disertacioni, konsiderojmë së mund të janë përmbushur përmes:

- Hulumtimit nga aspektet e të drejtës ndërkombëtare, të teorive dhe koncepteve themelore mbi përfaqësimin e minoriteteve,
- Njohjes me bazën juridike në të cilën mbështetet mbrojtja e të drejtave të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, dhe
- Prezantimit të konkluzioneve mbi nivelin e zbatimit të kornizës ligjore që në Kosovë është në fuqi dhe që mbulon fushën e të drejtave të pakicave kombëtare me qëllim të ofrimit e rekomandimeve që ky nivel të shënojë shkallë më të lartë të zbatimit në praktikë të këtyre të drejtave.

1.3. Metodologjia e punës kërkimore

Nga titulli i këtij punimi doktoral si dhe struktura e tezave të punimit “Përfaqësimi i Minoriteteve në Institucionet e Kosovës”, është përcaktuar metodologjia e punës dhe mënyra e trajtimit të këtij problemi në punim. Gjatë hartimit të kësaj teme janë përdorur disa metoda që unë gjykoj se janë të rëndësishme si: metoda historike, interpretuese dhe ajo analitike.

Përmes metodës historike, nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, gjegjësisht rregullave dhe konventave të ndryshme ndërkombëtare, janë hulumtuar të drejtat e minoriteteve dhe mbrojtja e tyre nëpër periudha të ndryshme kohore, duke hulumtuar legjislacionin nacional i cili përcakton rregullat për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve

pakicë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Pra, përmes kësaj metode është paraqitur mënyra e shtet ndërtimit të institucioneve të Kosovës dhe mekanizmave të ndryshëm institucional të cilët janë marrë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të minoriteteve në Kosovë. Po ashtu, është bërë një analizë historike e përfaqësimit të komuniteteve nga periudha pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, ndërsa me fokus të veçantë është paraqitur niveli dhe mënyra e përfaqësimit të këtyre minoriteteve në institucione dhe mekanizma që nga ditët e para të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, d.m.th që nga vitit 2008.

Përmes metodës interpretuese është bërë interpretimi i normave ligjore, juridike nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik i vendit, deri te interpretimi i ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera juridike, të cilat institucionet e vendit i kanë nxjerrë ekskluzivisht në përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve minoritare që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Gjatë hulumtimit të këtij punimi, gjithashtu i është bërë edhe një vështrim analitik edhe legjislacionit ndërkombëtar i cili ka të bëjë me të drejtat e minoriteteve si dhe marrëveshjeve të fundit të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim të faktorit ndërkombëtar.

Po ashtu, gjatë punës në përgatitje të këtij punimi doktoral rol të rëndësishëm i kemi kushtuar edhe metodës analitike dhe shpjegimeve të gjetura në nga literatura të ndryshme, përkatëse shkencore. Gjithashtu, janë trajtuar çështje komplekse në fushën e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve, si në aspektin e përfaqësimit të tyre nëpër institucione ashtu, e po

ashtu edhe në aspektin e zgjidhjeve kushtetuese dhe ligjore të kësaj problematike. Metoda analitike na ka ndihmuar që të arriturat shkencore në këtë fushë të jenë pjesë e rëndësishme e këtij disertacioni, jo thjesht si referenca, po janë përdorur edhe si një burim i rëndësishëm për shqyrtim të bazuar kritik, nga fakti se efektet praktike që ka dhënë kjo metodë janë të dukshme.

Pra, përmes kësaj metode është bërë një analizë e përgjithshme lidhur me diversitetet e popullatës që jeton në Kosovë, si dhe një analizë e përgjithshme e përfaqësimit të këtyre komuniteteve në institucionet e vendit; nga niveli më i ulët i tyre, deri te niveli më i lartë, siç është Presidenca e Kosovës. Po ashtu, me ndihmën që paraqet kjo metodë, kemi arritur të bëjmë një analizë edhe zbatimit të sistemit proporcional në Kosovë, si dhe arsyeve të zbatimit të tij si një sistem më të favorshëm për arritje të përfaqësimit të grupeve më të vogla etnike në kuadër të legjislativit të Kosovës.

Gjatë procesit të hartimit të këtij punimi, gjithashtu, jam përqendruar edhe në grumbullimin e the dhënave kuantitative dhe kualitative, duke pas në konsideratë edhe burime të tjera të rëndësishme. Kjo është arritur falë vizitave në terren dhe intervistave që kam bërë me nëpunës shtetëror të nivelit qendror dhe atij lokal, po edhe me diskutime të shumta me përfaqësues të mekanizmave institucionalë të themeluara me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve pakicë.

1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Siç mund të vërehet metodologjia e përdorur në këtë punim doktoral është mbështetur në qëllim dhe objektivat e përgjithshme.

Nga ky këndvështrim, qëllimi kryesor që synohen të arrihen përmes këtij punimi doktoral është që tu përgjigjemi pyetjeve kërkimore të parashtruara në këtë punim, e që janë si më poshtë:

1. Cilat grupe etnike mund të konsiderohen si të marginalizuara ose më pak të përfaqësuara në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës?
2. Rezervimi i vendeve, apo përcaktimi i kuotave në institucionet shtetërore për minoritetet në Kosovë, a është standard i demokracisë apo, është shkelje e së drejtës ndërkombëtare?
3. Cilët janë faktorët kryesor të jashtëm që kanë ndikim në procesin e integritetit të komuniteteve pakicë, sidomos komunitetit serb në institucione publike të vendit?
4. Cilat masa duhet të ndërmerret politika kosovare në drejtim të rritjes së shkallës së zbatimit të legjislacionit në praktikë, me qëllim që ky sistem juridik i Kosovës të pranohet nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë?
5. Çfarë rekomandime të këtij punimi doktoral do të shërbenin si bazë e mirë për të ardhmen, që gjatë ndryshimeve ligjore të merren parasysh grupet etnike jo serbe me qëllim që edhe ato të kenë përfaqësim më adekuat, sesa kanë aktualisht?

Mbi bazën e këtyre pyetjeve kërkimore në fund të punimit duhet të jemi në gjendje të vërtetojmë hipotezën e përgjithshme si dhe nën hipotezat tjera elaboruese të parashtruara si më poshtë:

- Hipoteza e përgjithshme: Politikat publike të ndjekura nga ana e Qeverisë së Kosovës janë qenësore për krijimin e kushteve të favorshme për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në institucionet publike në Kosovë.
- a) Nën hipoteza e parë: Pavarësisht legjislacionit të miratuar në favor të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, politikat publike të ndjekura nga ana e Qeverisë së Kosovës nuk kanë arritur nivelin e duhur të zbatimit të tyre dhe krijimit të kushteve për përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve pakicë në të gjitha institucionet publike në Kosovë.
- b) Nën hipoteza e dytë: Përfshirja e komuniteteve pakicë nëpër institucione shtetërore të Kosovës, nuk është vetëm proces i brendshëm, por shpesh ky proces është i ndikuar nga faktorë të tjerë të jashtëm.
- c) Nën hipoteza e tretë: Politika zyrtare e Kosovës e mbështetur nga faktori ndërkombëtar, në shumë raste, komunitetin serb në Kosovë e ka trajtuar si komunitet të privilegjuar karshi komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë.

1.5. Literatura dhe kufizimet gjatë trajtimit të punimit

Gjatë hartimit të këtij punimi doktoral është shfrytëzuar literaturë parësore dhe dytësore, si dhe dokumente të tjera të aprovuara nga institucionet e Kosovës, si: Kushtetuta, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të cilat ekskluzivisht janë marrë me çështjen e komuniteteve pakicë në Kosovë.

Kjo teme gjithashtu është pasuruar edhe fale të materialeve dhe dokumenteve të tjera të hartuara nga organizata të ndryshme ndërkombëtare të cilat pas përfundimit të luftës kanë

vepruar në Kosovë dhe të cilat janë marrë me çështjen e mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të minoriteteve që jetojnë në Kosovë. Nga ana tjetër, gjatë trajtimit të kësaj teme kam hasur në pengesa dhe vështirësi të ndryshme, të cilat herë-herë më kanë penguar në arritjen e trajtimit më objektiv të këtij problemi, si dhe në trajtimin shumëdimensional dhe esencial të kësaj problematike. Analizimi i të dhënave të marra nga burime të ndryshme raportuese, shpeshherë edhe kontradiktore në mes vete, si të dhëna dytësore më kanë orientuar në hulumtimin dhe analizën e të dhënave parësore me anë të cilave i jam përgjigjur shumë pyetjeve kërkimore të cilat i kam shtruar paraprakisht. Vështirësi tjetër që po ashtu më përcolli gjatë hartimit të këtij punimi ishte edhe mungesa e saktë e numrit të serbëve që jetojnë në Kosovë. Kjo për faktin se deri më tani kemi burime të ndryshme të të dhënave rreth përqindjes dhe numrit të pjesëtarëve të këtij komuniteti që jeton në Kosovë.

Tjetër vështirësi gjatë trajtimit të kësaj teme ka qenë edhe pamundësia për të lëvizur lirshëm, kryesisht në pjesët veriore të Kosovës, ku do të kishim mundësi të merrnim informata kthyes nga ana e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë që jetojnë në atë pjesë, lidhur me mënyrën se si ato komunitete e shohin integrimin e plotë të tyre në këto institucione.

Po ashtu, sfidë tjetër ka qenë edhe pamundësia e lëvizjes së lirë nëpër vende të ndryshme të BE-së, me qëllim të njohjes më për së afërmi me politikat që këto shtete ndjekin në rastet kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe përfaqësimit të tyre nëpër institucione publike dhe shtetërore.

KAPITULLI II

2. SHPJEGIME HYRËSE MBI ÇËSHTJEN E MINORITETEVE

2.1. Konceptet dhe nocionet themelore mbi minoritetet

Të gjithë e dimë se gjatë gjithë historisë njerëzore luftërat kanë sjellë dëme të mëdha njerëzimit në aspekte të ndryshme si ato sociale, ekonomike, politike etj. Ndarjet më të mëdha të kombeve u krijuan kryesisht me Luftën e Parë Botërore dhe deri pas Luftës së Dytë Botërore. Si rezultat i këtyre ndarjeve të kombeve dhe krijimit të shteteve lindi edhe problemi i minoriteteve, i cili si problem nuk është trajtuar asnjëherë sa duhet.

Çështja e trajtimit dhe marrjes në mbrojtje të minoriteteve ka filluar kryesisht pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, ku me Traktatin e Versajës i dalë në fund të luftës, fuqitë e mëdha i imponuan Evropës ndarje të reja territoriale, të cilat ndarje për disa kombe patën edhe pasoja tragjike. Ato kombe u ndanë në shumë shtete dhe për pasojë, disa nga to humbën dhe shtetësinë e tyre për të marrë atë të shtetit brenda territorit të të cilit ekzistonin.

Ndarjet e këtilla të kombeve krijuan edhe nevojën dhe ndërgjegjësimin e shumë shteteve për krijimin e mekanizmave të ndryshëm të cilat do të merreshin me mbrojtjen e minoriteteve, të cilat në të kaluarën bënin pjesë në kombin e shumicës. Për të shmangur çdo tendencë separatiste aleatët e atëhershëm imponuan disa detyrime të caktuara lidhur me trajtimin e minoriteteve. Besimi mbi mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Evropë në

atë kohë i ishte besuar Lidhjes së Kombeve.⁹ Pas dështimit të përpjekjes së Lidhjes së Kombeve në krijimin e një dokumenti unik në mbrojtjen e minoriteteve një detyrë të tillë pas Luftës së Dytë Botërore, konkretisht viteve të fundit i është besuar mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtar si Organizatës për Siguri dhe Bashkim Evropian, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Këto organizata evropiane sikur edhe ato organizata ndërkombëtare më të hershme po ashtu, kishin vështirësi juridike dhe politike në përcaktimin e normave ndërkombëtare që rregullonin mbrojtjen e minoriteteve.

Në Gjykatën e Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare, në vitin 1930 është thënë: “Ekzistenca e një minoriteti është një çështje fakti dhe jo një çështje e së drejtës”¹⁰, ndërkaq, ne sot mund të themi se: ekzistenca e një minoriteti është një çështje faktike dhe jo një çështje e thjeshtë juridike e së drejtës, me të cilën duhet të merremi dhe ta trajtojmë njëtrajtshëm për të gjithë.

Respektimi i të drejtave të minoriteteve në një vend është shumë i rëndësishëm dhe po ashtu është faktorë shtytës që e përcakton demokracinë, paqen dhe stabilitetin e atij vendi. Megjithatë, jo rrallëherë qeveritë e shteteve të ndryshme, këtë problem e kanë shfrytëzuar thjeshtë për qëllime të veta politike e jo nga fakti i shqetësimit me të drejtat e minoriteteve.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, deri me sot, janë nxjerrë shumë dokumente dhe traktate shumëpalëshe ndërkombëtare. Një ndër më të rëndësishmet është edhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës, e cila në përmbajtjen e vet mekanizmave të

⁹ Florence Benoti-Rohmer, Çështja e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë, Tiranë 1996 I cili e citon, F A. Mandelstam (1923)

¹⁰ Florence Benoit- Rohmer, Çështja e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë, Tiranë 1996, faqe 16 paragrafi 3

saj të kontrollit dhe shteteve të cilat e zbatojnë atë, sa i përket çështjes së minoriteteve, u lë hapësirë të gjerë të vlerësimit.

Gjatë gjithë kësaj kohe, d.m.th deri më sot janë hasur vështirësi të mëdha në mbrojtjen e minoriteteve, por edhe në vet përcaktimin e termit apo nocionit se çka në fakt kuptojmë me termin minoritet. Ekzistojnë shumë tekste ndërkombëtare që kanë dhënë përkufizime të ndryshme për nocionin e minoritetit. Megjithatë, përvoja ka treguar se është e vështirë të jepet një përkufizim i saktë, i cili do të përfshijë të gjitha kategoritë e minoriteteve për shumë arsye, por njëra nga arsyet kryesore është edhe vetë llojllojshmëria e grupeve të minoriteteve dhe vështirësitë e tjera për t'i klasifikuar këto grupe si grupe homogjene. Arsye tjetër është edhe fakti se vet disa shtete unitare kanë qenë skeptike rreth përkufizimit të saktë të këtij termi, duke mos dashur kështu të cenonjë rindarje territoriale dhe nxitje te egove apo kauzave separatiste. Pra, njohja e të drejtave më të mëdha kolektive është konsideruar si një rrezik potencial për tendenca separatiste që mund të çojnë në pretendime territoriale.

Megjithatë, deri me sot instrumentet e ndryshme ndërkombëtare nuk përmbajnë ndonjë përkufizim të përgjithshëm të minoriteteve, duke mos përjashtuar këtu edhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të miratuar nga Këshilli i Evropës, në nëntor të vitit 1994. Një përpjekje rreth përcaktimit të këtij përkufizimi, megjithatë, e ka bërë Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me 1993, mirëpo ky projekt nuk u

miratua nga Komiteti i Ministrave të këtij Këshilli. Sipas këtij projekti shprehja “minoritet kombëtar”¹¹ tregon një numër personash të cilët jetojnë në një shtet të caktuar e të cilët:

- a) banojnë në territorin e një shteti dhe janë shtetas të tij,
- b) mbajnë lidhje të vjetra e të forta dhe të qëndrueshme me këtë shtet,
- c) shfaqin karakteristika etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore të veçanta,
- d) edhe pse të pakët në numër në krahasim nga pjesa tjetër e popullsisë së këtij shteti ose të një rajoni të këtij shteti, janë përfaqësues në mënyrë të mjaftueshme,
- e) janë të frymëzuar nga vullneti për të ruajtur kulturën, traditat, fenë dhe gjuhën e tyre.

Sipas këtij përkufizimi ekzistimi i minoriteteve varet kryesisht nga faktorët: objektiv dhe subjektiv.¹²

- *Objektiv* (ekzistenca brenda një shteti të caktuar të grupeve të veçanta të popullsisë që kanë karakteristika etnike, fetare e gjuhësore të qëndrueshme) dhe

- *Subjektiv* (që ka të bëjë me vullnetin për të ruajtur karakterin e veçantë të grupit). Sipas kësaj rrjedh se, vetëm grupet që i ruajnë dallimet e tyre e gëzojnë të drejtën të kenë një trajtim special të minoritetit, ndërsa, të tjerët që janë asimiluar me vullnetin e tyre dhe janë shkrirë në shumicën e popullatës nuk mund të trajtohen si të tillë.

Mungesa e një përkufizimi të saktë e të përgjithshëm për pakicat sipas Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike¹³ si dhe nenit 14 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut nuk e ka

¹¹ Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë 2010, faqe 238

¹² Florenco Benotit-Rohmer, Çështja e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë, Tiranë 1996, faqe 14

penguar Komitetin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, e as Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për t'i zgjidhur problemet e ndryshme të minoriteteve që janë paraqitur. Megjithatë, Asambleja Kombëtare e Këshillit të Evropës, e cila është marrë me mbrojtjen e minoriteteve, kishte hartuar një projekt për trajtim më të gjerë të mbrojtjes së minoriteteve nga ajo që ishte bërë deri me sot. Ky projekt shkonte edhe përtej Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku dhe për herë të parë jepet një formulim, i cili më vonë do të përdoret në të gjitha dokumentet tjera ndërkombëtare. Rekomandimi i tillë thoshte: “Në shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personat që u përkasin këtyre pakicave nuk duhet të privohen nga e drejta që t’i kenë së bashku me pjesëtarët e tjerë të grupit të vet, jetën e vet të veçantë kulturore, të predikojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre ose të përdorin gjuhën e tyre“¹⁴.

Prandaj, mungesa e një përkufizimi të përgjithshëm dhe të saktë të konceptit të minoritetit, megjithatë, nuk ka qenë pengesë për zbatimin e rregullave të shpallura nga Konventa Kuadër¹⁵. Komiteti i ekspertëve më shumë ka preferuar të përdorë shprehjen “minoritet kombëtar” se sa të identifikojë minoritetet nëpërmjet dallimeve të ndryshme etnike, fetare ose gjuhësore. Megjithatë, ky term përdoret rrallë në tekstet e ndryshme ndërkombëtare për arsye të dykuptimësisë së tij, sepse ai merr domethënie të ndryshme kur i referohemi koncepteve të ndryshme si atij francez, sllav, gjerman etj.

¹³ Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 2200 A (XXI) datës 16 dhjetor 1966 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 27

¹⁴ http://www.avokati.org/?page_id=1839

¹⁵ Florenco Benoit –Rohmer, Çështje e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë faqe 46 , I cili e citon Henrich Klebs (1995 në f.166)

2.2. Vështrime të përgjithshme historike lidhur me trajtimin e minoriteteve

Realisht çështja e trajtimit të minoriteteve ka tërhequr vëmendjen e publikut dhe është shtruar në shkallë ndërkombëtare sidomos pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Ky fat e përcolli edhe kombin shqiptar, i cili për më tepër, gjatë luftërave ballkanike të periudhave ndërmjet viteve 1912-1913, ishte ndarë dhe copëtuar për pazare konjunkturale politike nga fuqitë e mëdha për interesa të shteteve fqinje. Për të krijuar mundësi ekzistenciale popullsive të mbetura jashtë shteteve amë, sidomos për të shmangur tendencat e tyre për separatizëm, fuqitë aleate përcaktuan disa kritere apo detyrime në lidhje me trajtimin e këtyre pjesëtarëve minoritarë, detyrime këto që u dedikoheshin atyre shteteve të cilat, në kuadër të territorit të vet, kishin pjesëtarë të minoriteteve. Lidhja e Kombeve, si organizatë e parë ndërkombëtare, ushtronte rolin e garantuesit përmes shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe peticioneve që asaj i drejtoheshin në emër të minoriteteve të ndryshme, nën pretendimin e tyre se bëhej fjalë për shkelje të të drejtave elementare të tyre.

Për këtë qëllim, në kuadër të Këshillit të Lidhjes funksiononte një Komitet i veçantë, i cili merrej me shqyrtimin e këtyre kërkesave, e që jo rrallë, ky komitet ndihmohej edhe nga e ashtuquajtura Dhoma e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare, përmes ofrimit të mendimeve profesionale, sidomos për çështje diskutabile juridike.

Ndërkaq, pas Luftës së Dytë Botërore, me gjithë pasojat që ajo luftë la pas, vëmendja u fokusua posaçërisht tek çështja e të drejtave individuale të njeriut dhe në këtë mënyrë, në vend të avancimit dhe të zgjidhjes sa më të përsosur të drejtave të minoriteteve,

margjinalizojë këto të drejta duke i kthyer ato në të drejta individuale. Si rezultat i migrameve të shumta, në vitin 1945, çështja e trajtimit të minoriteteve u aktualizua shumë dhe u bë temë e cila nuk mund të anashkalohej. Në këtë periudhë, u shfaqen rryma të ndryshme, po mbi të gjitha dy prej tyre ishin mbizotëruese:

- Mbrojtja e komuniteteve pakicë, pra, minoriteteve që të bëhej nëpërmjet nënshkrimit të traktateve të paqes; dhe
- Mbrojtja e këtyre minoriteteve të trajtohej së bashku me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të ishte nën ombrellën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në këtë drejtim, nënshkrimet e Traktateve të Paqes që ndodhën në vitin 1947, u ballafaquan pothuajse me po ato probleme që u shfaqen me rastin e nënshkrimit të Traktatit të Versajës, në vitin 1919, me të cilin u garantohej të gjithë individëve, pavarësisht nga raca, gjuha ose feja, ushtrimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Përveç këtyre traktateve, u nënshkruan edhe dokumente bilaterale, sidomos midis shteteve kufitare, ku flitej edhe për minoritetet përkatëse dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Megjithatë, për një kohë të gjatë, minoritetet janë vlerësuar si problem i dorës së dytë në kuadër të të drejtave të njeriut. Kjo qasje sa i përket minoriteteve si problem i dorës së dytë, erdhi në shprehje sidomos në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të miratuar në vitin 1948, ku, lidhur me këtë çështje pati diskutime të shumta nga të cilat pastaj dolën propozime të ndryshme ku njëra palë mbronte qëndrimin se problemi i minoriteteve ishte mjaft kompleks për shkak të dallimeve strukturore ndërmjet shteteve, kurse pala tjetër, mbronte qëndrimin se zbatimi i kësaj deklarate mund të rrezikonte seriozisht njësinë kombëtare të disa shteteve.

Situata pas rënies së regjimit komunist në vendet e Evropës Qendrore dhe asaj Lindore kërkohej ri-definim e të drejtave të minoriteteve. Në funksion të këtij qëllimi, u miratua Deklarata e Kopenhagës e vitit 1990, ku shtetet pjesëmarrëse të kësaj konference u pajtuan me listën e hartuar për të drejtat e minoriteteve. Vlen të theksohet se, për herë të parë në këtë konferencë, vendet pjesëmarrëse pranojnë që ndaj minoriteteve mund të merren masa pozitive, ani pse duhet theksuar se sikurse çdo dokument tjetër, edhe Deklarata e Kopenhagës nuk ka pasur asnjë dispozitë e cila do të paraqiste forcë detyruese për shtetet. Po ashtu, në nëntor të vitit 1990 nënshkruhet Karta e Parisit, e cila shpreh hapur vullnetin e shteteve për të inkurajuar kontributin e çmuar që sjellin minoritetet kombëtare në jetën e shoqërive.

Më vonë, Komiteti i Ministrave i Asamblesë Parlamentare të Evropës, me qëllim të hartimit të një Konvente Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, themeloi Komitetin Ad hoc, i cili i dha përparësi përpunimit të Konventës Kornizë. Konventa Kornize e miratuar nga Komiteti i Ministrave me 10 nëntor 1994 është traktati më i plotë ndërkombëtar lidhur me të drejtat e minoriteteve kombëtare. Palët nënshkruese të saj angazhohen të sigurojnë barazinë e plotë dhe reale në të gjitha aspektet. Kjo Konventë u jep mundësinë shteteve, që dispozitat e saj t'i përshtatin me dispozitat e vende të tyre. Këto dispozitat të Konventës mbulojnë një game të madhe problemesh, por ato nuk përmbajnë një përkufizim të prerë për konceptin minoritet kombëtar dhe kështu i lënë hapësirë vlerësimit të çdo palë nënshkruese për ta zbatuar sipas dëshirave dhe specifikave që kane shtetet.

2.3. Instrumentet ndërkombëtare për trajtimin e çështjes së minoriteteve

Mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtave dhe lirive të pjesëtarëve që u përkasin këtyre komuniteteve pakicë, janë pjesë e pandarë e konceptit, që lidhet me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Si e tillë kjo mbrojtje e minoriteteve është e një rëndësie të veçantë për stabilitetin, rendin demokratik dhe ruajtjen e paqes në Evropë dhe më gjerë, duke shërbyer kështu në drejtim të krijimit të një ambienti tolerant ndërmjet bashkësive etnike që jetojnë në kuadër të shteteve të përbashkëta gjithandej botës.

Kur flitet për problemin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve në vende ku ato jetojnë, padyshim kjo i përket një çështje shumë komplekse dhe shumë delikate, kuptimi i së cilës ka evoluar në mënyrë të përsheptuar për gjatë këtyre viteve të fundit nga ana e organizatave të ndryshme ndërkombëtare që merren me trajtimin e saj, siç janë OSBE, KE dhe BE, të cilat jo rrallë koordinohen në përpjekjet e tyre për të zhvilluar një sistem koherent dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave të tyre, që u njihen me akte të ndryshme ndërkombëtare.

Në botën moderne, kërkohet jo vetëm që shtetet të respektojnë identitetin e çdo pjesëtari që i përket një komuniteti pakicë, por është edhe obligim i shteteve që të krijojnë kushte të nevojshme që t'u japin mundësi atyre minoriteteve për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Mospajtimet e ndryshme që i kanë përcjellë shtetet lidhur me konceptet dhe natyrën e të drejtave që duhet t'u njihen minoriteteve, kanë qenë deri më sot, pengesë serioze për draftimin e dokumenteve të ndryshme me karakter ndërkombëtar që të rregullohej çështja e mbrojtjes së minoriteteve.

Për gjatë një periudhe prej më shumë se (40) vitesh, Këshilli i Evropës ka shqyrtuar situatën e pakicave kombëtare në disa raste. Mund të thuhet lirisht, se që në vitin e parë kur është themeluar Asambleja Parlamentare (1949), përmes një raporti të Komitetit mbi Çështjet Ligjore dhe Administrative, është vlerësuar roli dhe rëndësia e trajtimit të problemit që ndërlidhet me mbrojtjen më të gjerë të të drejtave të pakicave kombëtare. Në këtë drejtim, në vitin 1961, ky institucion ndërkombëtar rekomandoi përfshirjen e një neni në një protokoll të dytë shtesë për t'iu garantuar pakicave kombëtare një sërë të drejtash, që nuk përfshiheshin nga Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe e cila i referohet thjesht vetëm bashkimit me një pakicë kombëtare në dispozitën e mos-diskriminimit.

Ndërkaq, me rekomandimin e Asamblesë Parlamentare, propozohej që të formulohej një dispozitë e tillë mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare: personave që i përkasin një pakice kombëtare nuk do t'i mohohet e drejta, në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre etnik, dhe në masën që është në përputhje me rendin publik, të gëzojnë kulturën e tyre, të përdorin gjuhën e tyre, të krijojnë shkollat e tyre dhe të mësojnë në gjuhën e zgjedhur prej tyre apo të ushtrojnë e praktikojnë besimin e tyre fetar¹⁶.

¹⁶ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rekomandimi 285(1961) drejtuar Komitetit të Ministrave, 1961

Në vitin 1973, Komiteti i Ekspertëve që kishte autorizime për të shqyrtuar një propozim të këtillë, arriti në përfundimin se nga pikëpamja ligjore nuk ka ndonjë arsye të veçantë për t'i inkorporuar ndonjë nen shtesë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Pakicave, ani pse la mundësinë për miratimin e një protokolli të tillë, nëse do të kishte ndonjë arsye tjetër të veçantë për dallim nga ato të prezantuara në propozimin e Asamblesë Parlamentare.

Më vonë, përsëri Asambleja Parlamentare i rekomandoi Komitetit të Ministrave një numër masash politike dhe ligjore, në mënyrë të veçantë për të hartuar një protokoll apo konventë mbi të drejtat e pakicave kombëtare¹⁷, në të cilin përfshihet një listë parimesh, të cilat ajo i konsideronte të nevojshme në funksion të mbrojtjes më efektive të pakicave kombëtare.

Në këtë drejtim, në maj 1992, Komiteti i Ministrave udhëzoi një Komitet Drejtues për të Drejtat e Njeriut të shqyrtojë mundësinë e formulimit të disa standardeve ligjore lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Për këtë qëllim, ky komitet zgjodhi një grup ekspertësh (DH-MIN), të cilit, sipas mandatit të ri të dhënë në mars 1993, iu kërkua të propozonte standarde ligjore të veçanta në këtë fushë, gjithmonë duke pasur parasysh parimin e koordinimit dhe plotësimit të punës ndërmjet Këshillit të Evropës dhe OSBE-se.

Këto dy organe morën parasysh tekste të ndryshme, në veçanti: propozimin për një Konventë Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të hartuar nga Komisioni Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit i quajtur Komisioni i Venecias, propozimin

¹⁷ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rekomandimi 1134(1990), drejtuar Komitetit të Ministrave, 1990

austriak për një protokoll shtesë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, projekt protokollin shtesë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të përfshirë në Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare 1201 (1993) dhe propozime të tjera.

Megjithatë, njëri ndër hapat më vendimtar në lidhje me trajtimin e çështjes së minoriteteve, mund të konsiderohet momenti kur në vitin 1993, kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës u takuan në Vjenë, ku u pajtuan që minoritetet, të cilat ishin krijuar si rezultat i zhvillimeve historike në Evropë, duhet të mbroheshin dhe respektoheshin si një kontribut për paqen dhe stabilitetin në Evropë. Në funksion të këtij qëllimi, ata vendosën të marrin përsipër angazhime ligjore lidhur me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Deklarata e Vjenës, e miratuar me këtë rast, udhëzoi Komitetin e Ministrave, se ishte i nevojshëm hartimi i një Konvente Kuadër. Kjo konvente do të përcaktonte parimet ndaj të cilave shtetet anëtare angazhohen për ti respektuar këto parime që mbrojnë pakicat kombëtare, duke lënë mundësinë e hapur për nënshkrimin e saj edhe nga shtetet jo-anëtare. Njëkohësisht, kjo konvente hapte rrugë për përgatitjen dhe hartimin e një protokollit plotësues të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut në fushën kulturore, me dispozita që garantonin të drejtat individuale, në veçanti për personat që i përkasin pakicave kombëtare.

Për këtë qëllim, në nëntor 1993, Komiteti i Ministrave krijoi një Komitet Ad hoc për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (CAHMIN), mandati i të cilit pasqyronte vendimet e marra në Vjenë. Komiteti Ad hc që ishte i përbërë prej ekspertëve nga shtetet anëtare në Këshillin e Evropës dhe në bashkëpunim me përfaqësuesit e organizatave tjera që

merreshin me trajtimin e problemit të pakicave kombëtare, i propozoi Komitetit të Ministrave një raport të ndërmjetëm dhe me pas në tetor të vitit 1994, vendosi gjithashtu, të parashtrojë projekt Konventën Kuadër, Komitetit të Ministrave, që e miratoi tekstin e saj në sesionin ministror në muajin nëntor 1994.

Përpyekjet e bëra nga nivele të ndryshme ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, nisen pikërisht me Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së, neni 27, i të cilit përmban thjesht një formulim me të cilin reflekton detyrimin e shteteve për t'u treguar tolerante lidhur me këtë çështje. Një dokument tjetër shumë i rëndësishëm në këtë rrafsh është edhe Deklarata e të Drejtave të Personave që u Përkasin Minoriteteve kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore, e aprovuar me 14 dhjetor 1992. Në këtë deklaratë përcaktohet një listë e të drejtave të të gjithë atyre personave që u përkasin minoriteteve duke shprehur me atë rast, në mënyrë të qartë angazhimin e shteteve për të mbrojtur dhe përkrahur pa rezervë ruajtjen e identitetit kombëtar, etnik, fetar dhe gjuhësor të minoriteteve dhe për të mundësuar krijimin e kushteve të përshtatshme për të zhvilluar pa u penguar nga askush, këtë identitet.

Pavarësisht faktit, se kjo deklaratë nuk përbën një dokument juridik detyrimisht të zbatueshëm nga shtetet, por është thjesht një dokument me karakter politik, prapëseprapë, ajo edhe sot paraqet një nga tekstet e para bashkëkohore që përpiqet të bëjë një përshkrim të gjendjes së të drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të minoriteteve.

Sigurisht të gjithë pajtohem, se dokumentet ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve mbeten Deklarata e Kopenhagës së

qershorit të vitit 1990 si dhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e KE-së, e miratuar në shkurt 1995. Përkundër faktit se si të gjitha dokumentet e tjera të kësaj fushe e edhe Deklarata e Kopenhagës nuk kanë asnjë forcë detyruese për shtetet, por megjithatë ajo konsiderohet sot si Karta Evropiane e Minoriteteve, duke qenë se ajo ka formuluar një numër të caktuar parimesh mbrojtëse të minoriteteve për të cilat shtetet nënshkruese kanë arritur një konsensus politik.

Ndërkaq, Konventa Kuadër është relativisht një instrumenti i ri në të drejtën ndërkombëtare. Ajo shpall një numër të caktuar dispozitash si objektiva që duhet të arrihen nga shtetet dhe duke qenë se dispozitat e saj nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme, zbatimi i saj arrihet së pari, nga masat e marra në kuadrin kombëtar dhe së dyti, nga marrëveshjet dypalëshe. Ky dokument pasqyron një numër parimesh në lidhje me promovimin e identitetit të minoriteteve, duke respektuar gjithmonë përparësinë e ligjit, integritetin territorial dhe sovranitetin e shteteve. Edhe pse këto parime mund të duken si standarde juridike minimale, kjo bëhet me qëllim që shteteve tu ofroreshin modele që mund t'u përshtateshin karakteristikave të veçanta të minoriteteve të tyre dhe për t'u lënë atyre të zgjidhnin veprimet plotësuese që ato mund ti konsideronin të arsyeshme. Prandaj sot, Konventa Kuadër përfaqëson instrumentin ndërkombëtar me nivelin më të lartë të angazhimeve që duhet të marrin shtetet në lidhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, është njëra prej traktateve më gjithëpërfshirëse e përgatitur për të mbrojtur të drejtat e personave

që i përkasin minoriteteve kombëtare. Jo rastësisht, në kuadër të emërimit të konventës është lënë edhe shprehja “kuadër” e cila nënkupton mundësinë që secili shtet, në kuadër të vet, të përshtat dispozitat e kësaj Konvente duke u bazuar në situatën specifike, legjislacionin dhe politikat e vendeve të tyre.

Sipas Konventës Kuadër, çdo palë, i është lënë hapësirë për të vlerësuar se cilat grupe mund të përfshihen nga Konventa brenda territorit të shtetit të tyre, duke pasur gjithnjë për bazë parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe parimet bazë të përcaktuara në nenin 3, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Minoriteteve. Sipas të kësaj dispozite pra, shihet se çdo person që i përket një pakice kombëtare do të ketë të drejtën që të zgjedh lirisht për tu trajtuar apo jo si i tillë dhe nuk do të ketë asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që lidhen me këtë zgjedhje dhe se personat që u përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë që burojnë prej parimeve të parashikuara në këtë konventë kornizë në mënyrë individuale si dhe në bashkësi me të tjerët.¹⁸

Përfundimisht, mund të thuhet se Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është instrumenti i parë shumëpalësh e cila deri diku mund të konsiderohet me karakter të detyrueshëm ligjor, kushtuar mbrojtjes së pakicave kombëtare në përgjithësi dhe se ajo ka për qëllim të përcaktojë parimet ligjore ndaj të cilave shtetet angazhohen t'i respektojnë për të siguruar mbrojtjen e pakicave kombëtare.

¹⁸ Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995, Raport Shpjegues në formatin elektronik përgatitur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, 2003

KAPITULLI III

3. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI TË DREJTAT E MINORITETEVE QË JETOJNË NË KOSOVË

3.1. Pozita e minoriteteve në Kosovë në periudha të ndryshme kohore

Para se të flasim për gjendjen e minoriteteve në Kosovën e pas luftës së fundit, besoj se është e rëndësishme të kujtojmë me këtë rast gjendjen e rend të popullatës shqiptare që jetonte në Kosovën sidomos gjatë e viteve 1945-1998. Gjatë asaj periudhe shqiptarët e Kosovës dhe popullata tjetër shqiptare e cila jetonte në territoret e veta në ish Jugosllavi edhe pse për nga numri i banoreve në këtë shtet ishte e treta, padrejtësisht trajtohej si pakicë kombëtare. Një trajtim diskriminues ndaj popullatës shqiptare në ish Jugosllavi siç dihej botërisht është ushtruar kryesisht në dy faza: gjatë vitit 1945-1966 (deri në rënien e Aleksander Rankoviqit) dhe periudha e dytë gjatë viteve 1989-1998 kur Millosheviqi paralajmëroi dhe ushtroi pastrim etnik në Kosovë.

Të dhënat dhe faktet e sistemuara prej vitit 1989 nga KLDMNJ-së, tregojnë se agresioni i organeve dhe i institucioneve të pushtetit serb filloj të marrë përmasa të dëmtimit të qëllimshme të pjesëtarëve të bashkësisë shqiptare, e cila pas ndryshmeve të bëra në Kushtetutën e Serbisë u trajtua “pakicë kombëtare”. Nga ky vite, d.m.th prej fund vitit 1989 filluan të krijohen ligjërisht kushte dhe raporte, të cilat goditnin pjesëtarët të “pakicës shqiptare” duke ngushtuar vazhdimisht faktorët dhe raportet e jetës së lire në mjedisin e tyre.

Që nga viti 1990 fillojë shuarja graduale dhe sistematike e jetës institucionale dhe e aktivitetit institucional në arsim, shëndetësi, kulturë, mjete të informimit, shkencë , etj. Dëbimi i shqiptarëve nga puna, ndërprerja e veprimtarisë shëndetësore e sociale për familjet e të përndjekurve nga puna filloj ti japë karakter kolektiv viktimizimit të shqiptarëve. Shkeljet e këtyre të drejtave dhe lirive filluan të marrin përmasa të gjera për të gjithë shqiptarët e Kosovës si kolektivitet. Këto përmasa u vrenjtën posaçërisht me pezullimin e ligjeve të aprovuara për organizimin ekonomik, arsimor, kulturore, shëndetësor e informativë. Pasojë e aktivitetit ligjvënës të Parlamentit të Serbisë ishte rrënimi i sistemit të institucioneve dhe diskriminimi i punëtorëve të këtyre institucioneve, të cilat u përkisnin shqiptarëve. Përforcimi i organeve gjyqësore dhe i prokurorive me profesionist joshqiptarë, përforcimi i organeve të kontrollit të rrjedhave të përgjithshme në Kosovë etj, tregojë synimin e organeve dhe të institucioneve të pushtetit serb për shkeljen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve përmes shkeljes individuale të të drejtave dhe lirive të tyre.

Kosova ishte një krahinë e ish Jugosllavisë, e cila statusin e etnitetit autonom federal e kishte marrë në vitin 1974. Autonomia e Kosovës u shfuqizua në vitin 1989 nga Republika e Serbisë dhe kështu ajo edhe pse kishte shpallur pavarësinë e saj dhe kishte ndërtuar një sistem institucional paralel, për dhjetë vite rresht ju nënshtrua një regjimi represiv serb deri në shpërthimin e luftës në vitin 1998 dhe intervenimin e forcave të NATO-së në mars të vitit 1999.

Pas marrëveshjes të 10 qershor të vitit 1999 për tërheqjen e trupave serbe, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratojë rezolutën 1244, me anë të së cilës përcaktoi

edhe statusin e ardhshëm politik të Kosovës. Pra, me anë të asaj rezolute Kosova do të vendosej komplet nën protektoratin ndërkombëtar, ku administrimin civil të saj do ta ushtronin Kombet e Bashkuara, ndërsa NATO-ja do të përkujdesej për sigurinë e saj.

Vendosja e Kosovës nën protektoratin ndërkombëtar, popullit të Kosovës i mundësonte të gëzonte një autonomi përmbajtjesore në kuadër të RFJ-së me administrim kalimtar derisa të krijoheshin kushte për zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike dhe vetëqeverisëse. Më 15 maj të vitit 2001, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm miratoi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, me qëllim të krijimit të një vetëqeverisjeje kuptimplote në Kosovë. Kjo qeverisje do të funksiononte deri në zgjidhjen përfundimtare dhe krijimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në fushat legislative, ekzekutive dhe gjyqësore, përmes pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhjet e lira dhe të drejta. Në Kreun e katërt të Kornizës Kushtetuese janë të përcaktuara edhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre që jetojnë në Kosove. Pra, në dispozita të përgjithshme të këtij kreu është përcaktuar se kush mund të konsiderohet si komunitet, cilat janë të drejtat e këtij komuniteti dhe anëtarëve të tyre si dhe cili është roli i institucioneve të asaj kohe në mbrojtje të këtyre komuniteteve.

Historikisht si pakica kombëtare janë njohur ato pjesë të popullatës të cilat kanë një kombamë, me të cilin kanë karakteristika të përbashkëta si: gjuhën e përbashkët, konstitucionin psikologjik e shpirtëror, kulturën, zakonet, traditat, besimin fetar etj. Këto kombe amë zakonisht shtrihen përtej kufirit ku jetojnë minoriteti i tyre siç është rasti në Kosovë i minoritetit serb, i cili shtrihet në veri të vendit, ndërsa minoritetet e tjera që jetojnë në Kosovë janë grupe të popullatës që kanë jetuar në Kosovë, janë grupe të krijuar nga regjimi

monarkik Jugosllav ose grupe të tjera që historikisht në rrethana të ndryshme janë ngulitur në Kosovë. Pra si pakica të tilla konsiderohen, minoriteti serbe, boshnjake, kroate, malazeze, egjiptiane, rome, ashkali, turk dhe goran.

Tanimë nuk ka asnjë dilemë nga askush se nga raporti i marrëdhënieve që krijohen ndërmjet shumicës shqiptare dhe pakicës në Kosovë, në një masë të madhe varet edhe prestigji Kosovës në rrafshin ndërkombëtarë. Lidhur me komunitetet pakicë, historinë e shfaqjes së tyre, kushtet e standardit jetësorë të tyre dhe sidomos lidhur me pozitën kushtetuese dhe juridike të tyre, sot ekzistojnë dokumente të ndryshme dhe akte normative të cilat në mënyrë të theksuar dhe në korrelacion me aktet ndërkombëtare e trajtojnë problemin e minoriteteve.

Prandaj, në jetën e përditshme deri sot, në vende të ndryshme, me rregullime të ndryshme shtetërore kanë ekzistuar modele nga më të ndryshmet mbi mënyrën rregullimit të pozitës kushtetuese dhe juridike të komuniteteve që përfaqësojnë pakicën brenda një vendi. Nuk ka asnjë dilemë se në ato modele, është e përfshirë edhe Kosova, e cila me aktin juridik më të lartë Kushtetutën e saj, sot i tejkalon edhe standardet e së drejtës ndërkombëtare sidomos kur është fjala për minoritetin serb që jetojnë në Kosovë. Të drejta këtij minoritetit janë të përfshira përtej standardeve, madje edhe duke krijuar asimetri me të drejtat e shumicës nëpërmjet të Planit të Ahtisarit. Ky plan më vonë është bërë pjesë normative e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke e marrë madje, edhe primatin e të qenurit akt suprem juridik brenda shtetit. Kur jemi këtu, nuk mund të anashkalohet pa u përmendur fakti lidhur me mospërfilljen dhe injorimin e standardeve dhe akteve juridike të nxjerra nga

institucionet e Kosovës, veçanërisht nga minoritetit serb që jeton në Republikën e Kosovës i cili, nuk i njeh realitetet e reja të krijuara në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë së saj.

Injorimi i institucioneve të Kosovës nga ana e këtij minoriteti vazhdon edhe më tutje, sidomos pas shprehjes së Opinionit Ligjor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, sipas të cilit opinion, shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk bie ndesh me normat e të drejtës ndërkombëtare dhe madje as pas njohjeve të bëra nga më shumë se 100 vende të ndryshme të botës, duke përfshirë aty edhe fuqitë e mëdha ekonomike dhe politike të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në proceset politike ekonomike dhe sociale në bote.

Në të njëjtën kohë, në disa vende të rajonit si në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, ku krahas komuniteteve tjera etnike jetojnë edhe shqiptarët, nuk mund të fshihet fakti se ka një denigrim të pozitës kushtetuese e juridike të popullatës shqiptare që jeton në trojet e veta në këto shtete. Në këtë drejtim, politika e tolerancës, kur është fjala për shqiptarët etnik, duhet shfaqet si alternativë e mirë për tejkalimin e mundshëm të konflikteve nacionale dhe se më këtë rast, problemi i pakicave duhet të trajtohet si faktorë bashkëpunimi e stabiliteti dhe urë lidhëse në mes të popujve që jetojnë në këtë truall të Ballkanit.

Në Republikën e Kosovës kur bëhet fjalë, për minoritetet dhe pozitën e tyre, mund të themi se shumica e popullatës e ka përqafuar një filozofi të re lidhur me standardin e përfaqësimit të minoriteteve në institucione që nga institucionet lokale dhe deri te ato qendrore. Të gjitha standardet ndërkombëtare, që lidhen me pozitën e minoriteteve në Kosovë janë kuptuar si masa mbrojtëse dhe masa afirmative si nga aspekti njerëzor, po ashtu edhe nga aspekti kombëtar i trajtimit të pakicave.

Në këtë sens, standardet ndërkombëtare nuk duhet kuptuar si kategori statike, por si masa evolutive në proceset e zhvillimit të tyre të mëtejme në fushën e të drejtave njerëzore dhe kombëtare. Është e natyrshme që në mes të shumicës dhe pakicës paraqiten përplasje interesash, e që në të shumtën e rasteve, këto interesa janë të kundërta. Përderisa shumica në shtetin e vet synon të krijojë një etnitet të vetëm, pakica synon arritjen e autonomisë kulturore e territoriale dhe kur krijohen kushtet, përpiqet të dalë nga ajo bashkësi. Duke i marrë parasysh pikërisht këto kundërshti ndërmjet shumicës dhe pakicës, fokusi duhet të përqendrohet në angazhimin e të gjithëve për integrimin e komuniteteve pakicë në jetën politike dhe institucionale të vendit, duke u nisur nga fakti se mbrojtja e të drejtave të pakicave, duhet të bëhet në përputhje me respektimin e identitetit të tyre nacional dhe të drejtave të qytetarëve, e jo në ruajtjen e privilegjeve.

Institucionet shtetërore të Kosovës, po edhe përfaqësuesit e ndryshëm të shoqërisë civile që merren me çështjet e minoriteteve e kanë për detyrë morale po edhe ligjore që të kujdesen dhe të mbrojnë të drejtat e minoriteteve në Kosovë. Respektimin, mbrojtjen dhe integrimin e pakicave në Kosovë, institucionet kosovare e konsiderojnë si një detyrim që buron nga vetë Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e saj të cilat rrjedhin nga dokumenti gjithëpërfshirës i Pakos së Ahtisarit. Sipas Kushtetutës, Kosova është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.¹⁹

¹⁹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, 2008

Gjithashtu, në Kushtetutën e Kosovës parashihet edhe parimi i barazisë së plotë të të gjithë qytetarëve para ligjit, që nënkupton ushtrimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Duke u nisur nga fakti se kemi një mungesë të një sistemi koherent në mbrojtje të minoriteteve kombëtare në Evropë²⁰ e cila gjithashtu ka ndikuar edhe në mungesën e dispozitave (mekanizmave) të përgjithshme detyruese të së drejtës ndërkombëtare që do të ndikonin në respektimin e këtyre dispozitave nga të gjitha shtetet të cilat kanë probleme me çështjet e minoriteteve, çështja e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve në Kosovë, është në një shkallë të lartë të ndërtimit të këtij sistemi koherent dhe jo rrallë herë edhe nga faktorët ndërkombëtar është marrë edhe si shembull se si duhet trajtuar komunitetet minoritare.

Nisur nga kjo, Kosova dhe institucionet e saj, për sa i përket respektimit të drejtave të minoriteteve janë shembull për Evropën se si mund të ndërtohet një shtet shumë etnik²¹, ku serbët dhe pakicat tjera që jetojnë në Kosovë kanë pozitën më të mirë në Evropë²². Ky nivel i respektimit apo avancimit i të drejtave të komuniteteve të Kosovës në të ardhmen mund të shërbejë si një model jo vetëm për gjithë hapësirën ballkanike, po edhe për gjithë Evropën

²⁰ Florence Benoit-Rohmer, Çështja e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë, faqe 7 paragraf 1, Tiranë, 1996

²¹ <http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=296477&ks11>, Deklarata e ambasadores amerikane, Tracey Ann Jacobson

²² <http://www.telegrafi.com/lajme/pakicat-ne-kosove-kane-poziten-me-te-mire-ne-evrope-2-19322.html>, Deklarata e ish Presidentit Kroat Stipe Mesic ,2011

Pra, në këtë mënyrë mund themi se legjislacioni i brendshme i Kosovës mund të qojë drejt ndërtimit të një sistemi koherent²³ jo vetëm për rajonin po edhe për Evropën, kur është fjala për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë. Kosova lidhur me këtë çështje paraqet një test dhe sfidë për sistemin ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të të drejtave të pakicave, sepse respektimi i të drejtave të pakicave i avancon kushtet për stabilitet politik dhe shoqëror dhe për paqe jo vetëm në hapësirën e Kosovës por edhe në tërë rajonin.²⁴

Duke u nisur nga fakti se avancimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve paraqet një kusht stabiliteti për Kosovën dhe për rajonin, faktori ndërkombëtar duhet ta ketë parasysh që çështjen e mbrojtjes së minoriteteve e veçanërisht atë të minoritetit serb mos ta shoh si çështje të një minoriteti të privilegjuar karshi shumicës dhe minoriteteve të tjera që jetojnë në Kosovë, po si një komunitet pakicë me të drejta të barabarta me të gjitha komunitetet tjera.

Arritja e një stabiliteti politik të Kosovës dhe rajonit si dhe integrimi i tyre drejt BE-së është i mundur falë përpjekjeve që çështjet e minoriteteve në rajon t'i shohë nga i njëjti prizëm duke i trajtuar dhe përkrahur njëtrajtshëm të gjitha komunitetet pa e privilegjuar asnjërën nga ato.

²³ Florence Benoit-Rohmer, Çështja e të Drejtave të Minoriteteve në Evropë, faqe 7, paragrafi 5, Tiranë 1996

²⁴ Enver Hasani& Ivan Cukalovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës faqe 230 paragrafi 26, 2013

3.2. Struktura e popullatës sipas komuniteteve që jetojnë në Kosovë

Bazuar në përlogaritjet e bëra nga ana e Entit Statistikor të Kosovës para regjistrimit zyrtar të popullatës, është konsideruar se në Kosovë shqiptarët përbëjnë 92% të popullsisë së përgjithshme, serbët 5.3%, romët 1.1%, turqit 0.4%, të tjerë 1.2%.²⁵ Duke i marrë parasysh pikërisht këto të dhëna, institucionet relevante ndërkombëtare dhe ato vendore me rastin e hartimit të akteve të ndryshme juridike, mbi këtë bazë kanë zgjedhur formulën mbi përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e Kosovës. Pra në bazë të kësaj formule janë përcaktuar vendet e rezervuara për të gjitha komunitetet, fillimisht me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në vitin 2000, pastaj edhe me Pakon e Ahtisarit të vitit 2007, dhe së voni edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të vitit 2008.

Të dhënat e Agjencionit Statistikor të Kosovës të publikuara në shtator të vitit 2012, vënë në pah të metat esenciale të një politike të zhvilluar përgjatë këtyre viteve në Kosovë, për sa i përket mbrojtjes së parimit për vendet e rezervuara për komunitetet pakicë. Nëse analizohet më thellë çështja e vendeve të rezervuara për komunitete, atëherë nuk është vështirë për t'u konstatuar se vërtetë komuniteti serb është privilegjuar padrejtësisht më shumë se sa komunitetet tjera që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. Përderisa komuniteti serb, gjithnjë sipas të dhënave zyrtare, përbën 3.55% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës dhe se kjo përqindje nuk dallon shumë nga përqindja e komuniteteve tjera, mund të themi se komuniteti serb është privilegjuar më shumë në krahasim me komunitetet tjera

²⁵ Enti i Statistikave të Kosovës. Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës 1948-2006, Shkurt 2008.

jo vetëm sa i përket vendeve të rezervuara në Kuvend e Qeveri, po ashtu edhe institucione tjera të administratës shtetërore e publike.

Prandaj, si rrjedhojë kësaj konsiderojmë se, ndarja e vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë, asnjëherë nuk është ndërlidhur me përqindjen e popullsisë etnike që ato realisht përbëjnë përqindjen e popullatës në Kosovë.

Të dhënat e fundit zyrtare të regjistrimit të popullsisë në Republikën e Kosovës, komunitetin boshnjak e rendisin si komunitetin më të madh minoritar në Kosovë me 1.66%, pas tij vijnë serbët me 1.55%, turqit me 1.05%, komuniteti i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianeve me 2.06%, komuniteti goran 0.58%, dhe komunitetet tjera 0.13%. Por, nëse llogarisim se në tri komunat veriore jetojnë 41.000 serbë, atëherë së bashku me numrin e serbëve të regjistruar në pjesën tjetër të territorit, përbërja e komunitetit serb përbën 3.55% të popullsisë totale të Kosovës.²⁶

Tab 1: Rezultatet e regjistrimit të viti 2011 sipas strukturës etnike të popullsisë:

	Shqiptarë	serbë	boshnjak	turq	romë	ashkali	egjiptian	goran	tjerë
Shifrat	1.616.869	25.532	27.533	18.738	8.824	15.436	11.524	10.265	2.352
%	92.9%	1.5%	1.6%	1.05%	0.5%	0.9%	0.7%	0.6%	0.1%
%	92.9%	7%							
N. Total	1.739,825								

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Regjistrimit të Popullatës në Kosovë, të publikuara në shtator 2012

Nëse e analizojmë strukturën e popullatës në periudha të ndryshme kohore, mund të thuhet se numri i popullsisë dhe struktura etnike gjatë regjistrimeve ndryshon nga regjistrimi në

²⁶ Agjencioni Statistikor i Kosovës, Rezultate përfundimtare të regjistrimit të popullsisë, shtator 2012

regjistrim, duke u bazuar në shtimin natyral dhe lëvizjeve të popullsisë. Statistikat e popullsisë që kanë të bëjnë me minoritete paraqesin rendësi të veçantë në Kosovë, për arsye së determinojnë proceset e planifikimit jo vetëm në pjesëmarrjen e minoriteteve në institucione shtetërore e publike po, edhe në hartimin e politikave që kanë të bëjnë me ndarjen e buxhetit dhe në proceset tjera të planifikimit në kompleksitetin e jetës publike në Kosovë.²⁷

3.2.1. Komuniteti shqiptar

Edhe pse për nga numri shqiptarët përbëjnë shumicën absolute të popullatës në Kosovë, një numër i tyre jetojnë në komuna të administruara nga komunitete pakice të Kosovës siç është paraqitur në tabelë si më poshtë:

Tab 2: Komunat të administruara nga komuniteti pakice serbe, në të cilat jetojnë popullata shqiptare, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011:

Komunat	Përqindja	Numri i shqiptarëve
Mitrovicë e Veriut*	16.63%	4.900
Shtërpce	29.14%	3.757
Novobërdë	37.33%	3.542
Graçanicë	9.44%	2.474
Klllokot	27.72%	1.362
Zubin Potok	6.61%	1.000
Zveçan	2.06%	350
Leposaviç	1.59%	300
Mamushë	5.89%	327

²⁷ European Centre for minority issues Kosovo, Komunitetet minoritare në rezultatet e regjistrimit të popullsisë 2011 në Kosovë, dhjetor 2012

Ranillug	2.79%	164
Gjithsejtë në komunat e listuara	12.08%	18.176
Gjithsej:	86.63%	1.623.419

**Regjistrimi i popullsisë në Kosovë i vitit 2011 nuk ka përfshirë edhe pjesën veriore të Kosovës, andaj profilet e komunave të OSBE-së nga viti 2013 janë shfrytëzuar si burim i të dhënave për komunitetin shqiptar në komunat në pjesën veriore.*

Burimi: European Centre for minority issues Kosovo, Komunitetet në Kosovë: Udhëzues për profesionist që punojnë me komunitete në Kosovë, 2013

Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës të cilët jetojnë si pakicë në numër dhe komunitetit shumicë brenda një komune dallojnë varësisht nga realiteti gjeografik dhe politikë ku jeton ai komunitet. Për dallim nga rajonet e Gjilanit, Prishtinës dhe Prizrenit ku marrëdhëniet ndëretnike të shqiptarëve në këto komuna me komunitetin tjetër pakice janë të mira, në rajonin e Mitrovicës këto marrëdhënie ndëretnike janë akoma të tendosura.

Arsyet janë të ndryshme duke mos e përfshirë edhe faktin se kjo pjesë e popullatës shqiptare kryesisht jeton në zona të thella dhe të largëta malore, po, arsyeja kryesore qëndron në faktin se pjesa veriore e Mitrovicës edhe sot është duke u përballur me probleme të mëdha politike, si pasoj instrumentalizimit të pakicës serbe e malazeze nga Qeveria e Beogradit.

Sa i përket çështjes së punësimit të shqiptarëve të cilët jetojnë në komunat e udhëhequra nga komuniteti serb, ka qenë edhe është ende evidente çështja e papunësisë të kësaj popullate në këto institucione komunale. Një gjendje e rënd ekonomike dhe e papunësisë e popullatës shqiptare kryesisht ekziston në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës pastaj në Komunitet Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, të cilët pamundësi për krijimin e kapaciteteve të reja të punësimit nëpër institucionet komunale, janë mbështet kryesisht në ekonominë e vogla bujqësore dhe familjare të tyre. Një mbështetje të tillë në ekonomi

familjare të kësaj pjese të popullatës, është bërë e detyrueshme duke i pasur parasysh rrethanat e rënda ekonomike të jetesës në zona malore.

Një gjendje po ashtu e rëndë ekonomike dhe me një shkallë e lartë papunësi të kësaj popullate mund të vërehet në komunat tjera të udhëhequra nga komuniteti serb si në Shtërpçë, Novobërdë dhe Ranillug, ku popullata shqiptare me qëllim të mbijetesës ekonomike ka qene e detyruar të vetorganizohet në hapjen e bizneseve familjare. Popullata shqiptare në këto komuna e injoruar nga institucionet komunale të udhëhequra nga komuniteti serb të vetmen mundësi angazhimi në punë shtetërore e kanë sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë, por jo edhe në institucionet e administratës komunale.

3.2.2. Komuniteti serb

Pas aprovimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, tërheqjes së formacioneve të armatosura serbe nga Kosova dhe kontrollit të rendit dhe zhvillimit të Kosovës nga forcat ndërkombëtare, kanë ndryshuar gjithë jeta politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë. Së bashku me ndryshimet e tjera kanë ndryshuar edhe statusi politiko-juridike i shqiptarëve dhe i serbeve këtu. Serbet tani përbëjnë njërin nga pakicat e popullsisë së Kosovës të cilët kanë të drejta të barabarta me të tjerët që jetojnë dhe zhvillohen në Kosove.

Komuniteti serb në Kosovë, nëse i marrim parasysh edhe ata të cilët jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, përbën komunitetin e dytë më të madh për nga numri i qytetarëve që jetojnë në Kosovë, gjegjësisht, komunitetin më të madh pakicë në nivel të Kosovës. Duke marrë parasysh faktin se me regjistrimin e popullsisë në Kosovë në vitin 2011 nuk është

mbuluar edhe pjesa veriore e Kosovës dhe po ashtu edhe një pjesë e konsiderueshme e komunitetit serb në pjesën jugore që e bojkotoj procesin e regjistrimit në Kosovë, atëherë, kur flitet për numrin e përgjithshëm të komunitetit serbe në Kosovë, duhet të mbështetemi edhe në burime të tjera alternative e jo vetëm në rezultatet e regjistrimit të popullatës të vitit 2011.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë mund të themi se në dhjetë komuna të krijuara rishtazi në Kosovë, ky komunitet përbën shumicën numerike. Kjo gjendje numerike paraqitet në pjesën verore të Kosovës, si dhe në dy komuna të tjera jugore siç është ajo në Graçanicë në Shtërpce. Pasqyrat numerike komunitetin serb e paraqesin si më poshtë: në pjesën Verore të Mitrovicës me 74.48% , në Graçanicë me 82.15%, në Leposaviq me 96%, në Zveçan me 96.1%, në Zubin Potok me 93.29%, në Shtërpce me 70.58%, në Novobërdë me 61.46%, në Ranillug me 97.15%, në Partesh me 99.96% dhe në Kllokot me 71.23%.²⁸ Ndërkaq, të dhënat në të cilat serbët janë komunitet pakicë në komunat tjera në Kosovë janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tab 3: Komunat në të cilat serbët janë komunitet pakicë në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 si dhe raporteve të OSBE-së mbi profilet e komuniteteve nga viti 2010 dhe raportit mbi profilet e komuniteteve të vitit 2013:

Komunat	Përqindja	Numri i komunitetit pakicë serb
Gjilan	5.29%	5.000
Vushtrri	4.79%	3.500
Kamenicë	8.01%	3.019

²⁸ European Centre for minority issues Kosovo, Komunitetet minoritare në rezultatet e regjistrimit të popullsisë 2011 në Kosovë, dhjetor 2012

PËRFAQËSIMI I KOMUNITETEVE NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

Obiliq	12.37%	3.000
Lipjan	3.37 %	2.000
Prishtinë	1%	2.000
Istog	4.16%	1.700
Rahovec	1.76%	1.000
Pejë	1.03%	1.000
Fushë Kosovë	2.51%	900
Klinë	1.53%	600
Skenderaj	0.59 %	300
Viti	0.59%	280
Prizren	0.13%	237
Ferizaj	0.06%	60
Shtime	0.18%	49
Deçan	0.11%	46
Gjakovë	0.02%	17
Mitrovicë e Jugut	0.02%	14
Podujevë	0.01%	12
Dragash	0.02%	7
Suharekë	< 0.01%	2
Kaçanik	<0.01%	1
Gjithsejtë		24.744

Burimi: European Centre for minority issues Kosovo, Komunitetet në Kosove: Udhëzues për profesionist që punojnë me komunitete në Kosovë, 2013

Sa i përket shkallës së papunësisë sipas të dhënave të publikuara në raportin e zhvillimit njerëzor në Kosovë²⁹ nga viti 2012, vërehet se shkalla e papunësisë tek komuniteti serb që jeton në Kosovë është 38.35% ndërsa, shkalla e përgjithshme e papunësisë në nivel vendi, sillet në rreth 45%. Pjesëtarët e komunitetit serb janë të përfaqësuar relativisht mirë në shërbimin civil të Kosovës me rreth (973) shërbyes civilë serbë, shifër kjo që do të thotë se ata përbëjnë 5.5 % të të gjithë shërbyesve civilë në Kosovë.³⁰

Ndërkaq, kur flitet për pjesëmarrjen e komunitetit serb në institucionet publike të Kosovës, atëherë, na del se kjo pjesëmarrje dallon shumë ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit serbe që jetojnë në komunat me shumicë serbe dhe pjesëtarëve të komunitetit serb që jetojnë në komunat me shumicë të komunitetit shqiptar. Përderisa, ata që jetojnë në komunat me shumicë serbe mund të kenë qasje në shërbimet komunale pa ndonjë vështirësi, pjesa tjetër e këtij komuniteti që jeton në komunat me shumicë shqiptare i injoroi këto shërbime duke filluar nga shërbimet elementare siç është: certifikatat e lindjes, certifikata martesore, certifikata e vdekjes, karta e identitetit e deri të injorimi i shërbimeve dhe obligimeve tjera që kishin të bënin me institucionet qeverisë në Kosovë.

Pjesëmarrja e komunitetit serb në institucionet publike në komunat ku ky komunitet është pakicë, pjesëmarrja është e kufizuar jo vetëm për shkak të hezitimit po edhe për faktin se pjesëtarët e këtij komuniteti i injorojnë institucionet e Kosovës për shkak të presioneve të ushtruara nga ana e autoriteteve të Serbisë. Si pasojë e këtij presioni ende edhe pas kaq vitesh, komuniteti serb i bojkoton zgjedhjet e organizuara nga institucionet e Kosovës dhe

²⁹ Kosovo Human Development Report 2012: Privat Sector and Employment, Prishtina, 2012

³⁰ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të Komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

në këtë mënyrë ata nuk arrijnë të përfaqësohen natyrshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë.

3.2.3. Komuniteti boshnjak

Bazuar në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, i plotësuar edhe me të dhënat e përgatitura nga ana e OSBE-së për pjesën veriore të Kosovës, vlerësohet se komuniteti boshnjak në Kosovë përbën komunitetin e dytë më të madh nga radhët e komuniteteve pakicë në Kosovë me rreth 1.6 % të numrit të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës. Shtrirja gjeografike e tyre është e përqendruar kryesisht në komunën e Prizrenit me 9.4 % në nivel komune dhe në komunat si në Dragash me 12.11%, në Istog me pjesëmarrje prej 2.8%, në Mitrovicën e Veriut me 3.39%, në Pejë me 3.89% në nivel komune dhe në Leposaviq me 1.6 %.

Ndërkaq, komunat në të cilat komuniteti boshnjak merr pjesë me më pake se 1% në numrin e përgjithshëm në nivel të komunave në Kosovë, janë si në vijim: Mitrovica e Veriut me 0.57%, Prishtina me 0.2%, Gjlani me 0.13 %, Deçani me 0.15% , Hani i Elezit me 0.45%, etj.³¹

Për dallim nga komunitet e tjera që jetojnë në Kosovë, të cilat kanë një gjendje social-ekonomike të rëndë, komuniteti boshnjak e gëzon një gjendje më të mirë socio- ekonomike, për arsye se ky komunitet është i integruar mirë në jetën shoqërore dhe politike të vendit dhe faktorët që kanë ndikuar janë lidhshmëria gjuhësore me komunitetin serb dhe kroat dhe lidhja fetare me komunitetin shqiptar. Faktorë tjetër të rëndësishëm që kanë ndikuar në

³¹ Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 si dhe raporteve të OSBE-së mbi profilet e komuniteteve nga viti 2010 dhe raportit mbi profilet e komunave të vitit 2013

integrimin dhe punësimin e këtij komuniteti janë edhe martesat e përziera, të këtij komuniteti me komunitetet e tjera, kryesisht martesat e përziera me komunitetin shqiptar dhe atë serb. Megjithatë, ka dallime të mëdha të integritit dhe përfaqësimit të këtij komuniteti, varësisht nga rajoni i shtrirjes së tij gjeografike

Bazuar në të dhënat e publikuara në vitin 2012,³² niveli i papunësisë tek pjesëtarët e komunitetit boshnjak është 37.68%, e cila nëse krahasohet me normën e përgjithshme të papunësisë në shkallë vendi është më e ultë. Ndërkaq, nga të dhënat e Zyrës për Çështje të Komuniteteve³³ shkalla e pjesëmarrjes së komunitetit boshnjak në shërbimin civil të Kosovës prej 1.5% e pasqyron përafërsisht në mënyrë të drejtë përqindjen e tyre në numrin e përgjithshëm të popullatës së Kosovës. Kjo përqindje nuk e pasqyron në mënyrë të saktë nën përfaqësimin e këtij komuniteti, në nivel të institucioneve qendrore të Kosovës, ku pjesëmarrja e tyre është diku rreth 0.9 % të të gjithë shërbyesve civilë.

Lidhur me përfaqësimin e komunitetit boshnjak në institucionet publike, ky komunitet nuk ka ndonjë pengesë sa i përket qasjes në to. Shqetësimet që ata mund të kenë janë pothuajse të njëjta me shqetësimet e komuniteteve të tjera, duke përfshirë këtu edhe komunitetin shumicë shqiptar. Lidhur me shërbimet që atyre u ofrohen nga institucionet e Kosovës, mund të themi se nuk ka pasur diskriminim në baza etnike duke pasur parasysh përkatësinë etnike të tyre.

³² Kosovo Human Development Report 2012: Privat Sector and Employment

³³ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

Përfaqësimi i komunitetit boshnjak në nivelet komunale, praqet një rëndësi tjetër të veçantë, nëse merret parasysh çështja e përdorimit të gjuhës boshnjake si gjuhë zyrtare në komunat ku ky komunitet jeton me një numër me të madh, si në Pejë, Prizren, Istog dhe Dragash. Se mbrojtja e të drejtave të komuniteteve, është në nivel të lartë e dëshmon edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, kur vendosi në favor të kërkesës së deputetëve të komunitetit boshnjak dhe turk të komunës së Prizrenit në vitin 2008, të cilët ishin ankuar bashkërisht të gjitha komunitetet, me pretendimin se logoja e kësaj komune nuk i pasqyronte të gjitha komunitetet që jetonin në komunën e Prizrenit. Pra, sipas vendimit të gjykatës kushtetuese është konstatuar shkelje e të drejtave të komunitetit boshnjak në këtë drejtim, dhe me një vendim të veçantë të kësaj gjykate është urdhëruar administrata komunale e Prizrenit që të ndërrojë statutin dhe emblemën e komunës.

3.2.4. Komunitetit turk

Komuniteti turk sipas të dhënave të fundit të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, dhe burimeve të tjera të marra nga raportet e OSBE-së përbën rreth 1.01% të numrit të përgjithshëm të popullatës që jeton në Kosovë. Ndërkaq, vetëm në një komunë të Kosovës atë të Mamushës, ky komunitet është shumicë numerike me një përqindje prej 92.35%. Numri më i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti jeton në komunën e Prizrenit me shkallën e pjesëmarrjes prej 5.06% dhe në komunën e Prishtinës me 1.08%. Në komunat e tjera të Kosovës ky komunitet merr pjesë me nën 1% të pjesëmarrjes në kuadër të numrit të përgjithshëm të banorëve, si: në komunat Mitrovicë të Jugut me 0.72%, në Vushtrri me

0.38% dhe në komunën e Lipjanit me 0.22% të numrit të përgjithshëm të banorëve të atyre komunave.³⁴

Sa i përket shkallës së papunësisë së pjesëtarëve të këtij komuniteti, pothuajse është situatë përafërsisht e ngjashme, sikurse me komunitetin boshnjak. Ajo shkallë sillet rreth 37.98%, kurse kur bëhet fjalë për përfaqësimin e këtij komuniteti në shërbimin civil të Kosovës, ky komunitet merr pjesë me 1.2% të të gjithë shërbyesve civilë³⁵ në Kosovë. Ky fakt nënkupton se pjesëtarët e këtij komuniteti janë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale në shërbimin civil të Kosovës dhe është në korrelacion me numrin e përgjithshme të banorëve që jeton në Kosovë.

Komuniteti turk sikurse edhe komunitetet tjera është i pranishëm nëpër institucionet publike e administrative të Kosovës dhe në asnjë rast nuk ka hasur në pengesa serioze për t'u integruar në jetën shoqërore dhe politike të vendit si në nivelin lokal, ashtu edhe në nivelin qendror. Si faktor kryesor, i cili ka ndikuar në arritjen e përfaqësimit në nivel të kënaqshëm të këtij komuniteti është edhe afërsia fetare me komunitetin shumicë, të cilët për dekada zhvillojnë kulturë të përbashkët dhe jo rrallëherë kanë edhe martesë të përziera në mes veti.

3.2.5. Komuniteti rom

Sipas regjistrimit të popullsisë, në vitin 2011, si dhe raporteve të OSBE-së mbi profilet e komuniteteve nga viti 2010 dhe raportit mbi profilet e komunave të vitit 2013, është

³⁴ Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 si dhe raporteve të OSBE-së mbi profilet e komuniteteve nga viti 2010 dhe raportit mbi profilet e komunave të vitit 2013

³⁵ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

vlerësuar se komuniteti rom që jeton në Kosovë në përbërjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë merr pjesë me 0.84% dhe se pjesa dërmuese e pjesëtarëve të këtij komuniteti është e përqendruar në komunën e Prizrenit. Numri i pjesëtarëve të këtij komuniteti në nivele komune, i shprehur në përqindje duket si me poshtë: në Prizren me 2.95%, pastaj në komunën e Graçanicës me 7.63% , në komunën e Pejës me 1.34 %, në Mitrovicën e Jugut me 1.7%, në komunën e Fushë Kosovës me 2.19%, të Obiliqit me 2.82 %, të Mamushës me 1.53% dhe kështu me radhë³⁶, ndërsa në komunat tjera të Kosovës prania e kësaj popullate pothuaj është simbolik.

Në rrafshin e punësimit, komuniteti rom së bashku edhe me komunitetet e tjera si atë egjiptian dhe ashkali përballen me një situatë aspak të volitshme sa i përket gjenerimit të të hyrave edhe sa i përket punësimit. Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor në Kosovë të vitit 2012³⁷, pjesëtarët e komunitetit rom shënojnë pothuajse shkallën më të lartë të papunësisë, me rreth 60,22%. Ky tregues është rrjedhojë e niveleve të dobëta të arsimimit të tyre dhe mungesës së përgatitjes kualifikues dhe profesionale që do t'i bënin me konkurrues në tregun e punës. Vlerësimi i bërë në vitin 2013 nga Zyra për Çështje të Komuniteteve³⁸ bie në konkluzion se sa i përket përfaqësimit të komunitetit rom në sektorin publik, gjegjësisht, në shërbimin civil të Kosovës, ky komunitet nuk është i përfaqësuar në nivelin e duhur. Pjesëmarrja e tyre në shërbimin civilë e publike rezulton me 0.2% të gjithë shërbyesve civilë në Kosovë. Një pjesëmarrje e tillë në këtë shërbim

³⁶ Komunitetet minoritare në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, Analizë dhe rekomandime, ECMI Kosova, dhjetor 2012

³⁷ Kosovo Human Development Report 2012: Privat Sector and Employment, Pristina 2012

³⁸ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

është në disproporcion me numrin e popullatës së komunitetit rom, që në nivel të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës rezulton me rreth 0.84%. Kjo gjendje e përfaqësimit të komunitetit rom pasqyrohet ndjetë edhe si në nivelin qendrorë po ashtu edhe në nivelin e lokale.

Komuniteti rom jeton në një gjendje të rëndë social-ekonomike dhe qasja e tij në punësim, është sfida më e madhe për shkak se ky komunitet nuk i është përgjigjur regjistrimit civil, arsimimit dhe kualifikimet të duhur dhe si të tillë këta faktorë paraqesin pengesa serioze për të arritur shkallen e duhur të punësimit, integritit dhe përfaqësimit të tij në institucione shtetërore. Siç shihet pra, edhe më tutje, një pjesë e madhe e këtij komuniteti edhe për një kohe të gjatë do të jetë barrë e rëndë e skemave sociale të institucioneve të vendit.

Nga ana tjetër një gjendje e tillë e rëndë sociale do i lente hapësirë më të madhe këtij komuniteti që të kërkojë ndihmë dhe përkrahje financiare nga institucionet e Serbisë . Një qasje e tillë dy drejtimesh, nuk do të ishte e favorshme as për vet komunitetin rom që jeton në Kosovë, po as edhe për institucionet vendore. Ky qëndrim i dyanshëm i komunitetit rom paraqet pengesë reale në drejtim të integritit të këtij komuniteti në shoqërinë Kosovare.

3.2.6. Komuniteti ashkali

Komuniteti ashkali sipas të dhënave të fundit të regjistrimit të popullsisë në Kosovë dhe burimeve të tjera të marra nga raportet e OSBE-së, ky komunitet përbën rreth 0.83 % të numrit të përgjithshëm të popullatës që jeton në Kosovë. Numri më i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti jeton në pesë komuna të Kosovës. Në përqindjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë, ky komunitet paraqitet si vijon: në Ferizaj me 3.35 %, në Fushë Kosovë me

9.02%, në Lipjanit me 3.05%, në Prizren me 0.75%, në Obiliq me 2.28%, në Mitrovicë të Jugut me 0.89%, në Podujevë me 0.77% dhe Rahovec me 0.71%. Ndërsa, pjesa tjetër e komunitetit ashkali me shifra simbolike ka shtrirje gjeografike edhe në komunat tjera.

Edhe komuniteti ashkali, sikurse edhe pjesëtarët e komunitetit rom, sa i përket çështjes së punësimit janë në një situatë shumë të pavolitshme dhe si rezultat i mos punësimit të tyre ata janë në një gjendje të rënde sociale e ekonomike.

Duke i marrë për bazë, gjithnjë hulumtimet e kryera nga Zyra për Çështje të Komuniteteve rreth nivelit të punësimit të komuniteteve pakicë në Kosovë, vërehet qartë se komuniteti ashkali është një ndër komunitetet më të diskriminuara në kuptim të përfaqësimit në shërbimin civil të Kosovës, me vetëm 0.2 %, edhe tashme është e ditur se ky grup etnik, në numrin e përgjithshëm të popullatës civile në Kosovë përfaqësohet me 0.83%.³⁹ I vetmi përjashtim në rastin konkret është komuna e Ferizajt, ku numri i ashkalinjëve të cilët kanë themeluar marrëdhënie punë në shërbimin civil në nivel lokal është 4.15% e të gjitha pozitave të punës në shërbimin civil të kësaj komune, përderisa, në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullatës së komunës së Ferizajt marrin pjesë me 3.34% të qytetarëve.

Duke u nisur nga fakti se komuniteti ashkali i Kosovës jeton në gjendje të rëndë ekonomike, shumë nga komunat e Kosovës, këtë komunitet e kanë liruar nga pagesat e shërbimeve të ndryshme komunale. Ky veprim është bere me qëllim që atyre t’ju krijohen

³⁹ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

favore të ndryshme në funksion të tejkalimit të gjendjes së rëndë ekonomike dhe me qëllim të integrimit të tyre në jetën shoqërore dhe politike. Duke marrë parasysh faktin se ky komunitet komunikon në gjuhën shqipe, në gjuhën e popullatës shumice, i ka krijuar atij mundësi për integrim dhe përfaqësim më të lehtë të tyre në institucione publike dhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi.

3.2.7. Komuniteti egjiptian

Komuniteti egjiptian i cili jeton në Kosovë sipas vlerësimeve të regjistrimit të fundit në Kosovë, të plotësuar edhe me të dhëna alternative nga OSBE-ja, përbën rreth 0.61% të numrit të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës. Ky komunitet është i shtrirë kryesisht në pjesën perëndimore të vendit; në komunën e Gjakovës me 5.42%, në komunën e Pejës me 2.77%, komunën e Istogut me 3.78% dhe komunën e Klinës me 2.39% në nivel të numrit të përgjithshëm të banorëve të këtyre komunave.⁴⁰ Ndërkaq, pjesa tjetër e këtij komuniteti është e shtrirë në rajon tjera ku numri i tyre është mjaft i vogël.

Nga aspekti ekonomik edhe pjesëtarët e komunitetit egjiptian sikurse edhe ata të komunitetit rom dhe ashkalinjë, përballen me nivel të ultë të të ardhurave dhe mundësitë e tyre për punësim qoftë në sektorin publik por edhe në atë privat, janë shumë të kufizuara. Shkalla e papunësisë për pjesëtarët e këtij komuniteti në nivel vendi është diku rreth 80%. Ky nivel kaq i madh papunësisë, është si rrjedhojë nivelet e ulëta të arsimimit dhe mungesës se kualifikimeve profesionale të anëtarëve të këtij komuniteti. Të dhënat e nxjerra në vitin 2013 nga ana e Zyrës për Çështje të Komuniteteve vërtetojnë mungesën

⁴⁰ Komunitetet minoritare në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, analizë dhe rekomandime, ECMI Kosova, dhjetor 2012

pothuajse të plotë të këtij komuniteti në shërbimin civil të Kosovës, me vetëm 0.01% të të gjithë shërbyesve civilë⁴¹ në nivel të Kosovës.

Duke e parë një gjendje të tillë të këtij komuniteti, disa OJQ vendore dhe organizata ndërkombëtare, në bashkëpunim me zyrtarët komunal, në dhjetor të vitit 2009 dhe gjatë vitit 2010-të kanë ndërmarr një Plan Veprimi Lokal, për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Ky plan i veprimi prezantonte masa konkrete që kishin për qëllim përmirësimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së tyre në institucionet publike të Kosovës.

3.2.8. Komuniteti goran

Komuniteti goran i cili jeton në Kosovë, përfaqëson pothuajse komunitetin më të vogël për nga pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Nga të dhënat e publikuara me regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 të plotësuara nga të dhënat zyrtare të raporteve të OSBES-së lidhur me numrin e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, del se në kuadër të numrit të përgjithshëm, komuniteti goran përfaqësohet me 0.58% . Ky komunitet, është i përqendruar kryesisht në pjesën jugperëndimore të Kosovës, gjegjësisht në komunën e Dragashit me 26.46%, dhe në komunën e Mitrovicës së Veriut me rreth 1.97% të banorëve që jetojnë në këto komuna. Pjesa tjetër në shifra është e papërfillshme sepse është e shpërndarë në pjesë tjera të Kosovës.

Sikurse edhe tek komunitetet tjera pakice që jetojnë në Kosovë edhe këtë komunitet e përcjell e njëjta situatë lidhur me nivelin e punësimit të tyre në institucione publike të

⁴¹ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

Kosovës. Shkalla e punësimit të këtij komuniteti rezulton me vetëm 0.01% të numrit të i përgjithshëm të gjithë nëpunësve civilë të Kosovës.

Edhe ky komunitet sikurse komuniteti rom i shfrytëzon dy lloje shërbimesh komunale: ato që ofrohen nga institucionet e Kosovës dhe ato që ofrohen nga Republika e Serbisë. Kjo ndarje dhe qasje e tillë e këtij komuniteti karshi institucioneve zyrtare të Kosovës dhe ndaj institucioneve paralele serbe kanë ndikuar negativisht në integrimin dhe përfaqësimin e këtij komuniteti në institucione të Kosovës.

KAPITULLI IV

4. KONCEPTET DHE NOCIONET THEMELORE MBI PËRFAQËSIMIN

Duke u nisur nga fakti se në literaturë nuk ka një përkufizim të vetëm të këtij termi, sepse përfaqësimi si nocion është gjithëpërfshirës dhe se ai varet nga natyra e çështjes me të cilën merret. Ne do të mundohemi të japim disa mendime apo sqarime se çfarë në realitet paraqet nocioni përfaqësim në përgjithësi.

Pra, kur përmendim nocionin përfaqësim menjëherë nënkuptojmë që kemi të bëjmë me promovim, prezantim bindje, mbrojtje, tërheqje të vëmendjes, ndikim, ndryshim etj.⁴² Prandaj, kur flasim për përfaqësimin, domosdo që duhet të japim një përkufizim të përafërt se çka në esencë është përfaqësimi dhe cilat janë format apo elementet e tij.

Përfaqësimi është një akt ose proces i përkrahjes së synimit ose çështjes së caktuar, e cila kërkon zgjidhje. Për të arritur deri tek zgjidhjet e tilla, sigurisht duhen një mori aktivitete në drejtim të sigurimit dhe zgjidhjes së çështjeve të caktuara. Pra, në themelet e çdo aktiviteti, gjithmonë janë njerëzit, të cilët nëpërmes organizatave të ndryshme, të cilat ata përfaqësojnë, u mundësojnë individëve dhe grupeve, që jo rrallë herë janë të marginalizuara, të marrin pjesë në procesin e krijimit të politikave, realizimit të misioneve të caktuara, me anë të të cilave tejkalojnë dhe problemet me të cilat përballen qytetarët e ndryshëm apo grupe të caktuara. Për të ekzistuar të gjitha këto, tek një përfaqësim normalisht se duhet të ekzistojë besimi dhe përkushtimi nga ana e aktivistëve të caktuar, të cilët, gjithmonë kanë vlera dhe synim të drejtë.

⁴² Po aty

Gjatë përfaqësimit, organizatat e ndryshme varësisht nga fusha e veprimit, duhet ta identifikojnë nevojën që me ndryshimet e vendimeve ose procedurave ligjore të caktuara të ndryshojnë e përmirësojnë të drejtat e caktuara të individëve ose grupeve konkrete. Pra, përfaqësimi është një institucion nëpërmes të cilit, sigurojmë përkrahjen për çështjen e caktuar me anë të së cilës, duam të ndikojmë tek të tjerët, ose përpiqemi të ndryshojmë apo ndikojmë në ligjet përkatëse që kanë të bëjnë me çështjen që përfaqësojmë. Ndikimi duhet të bëhet jo vetëm ndaj bartësve të drejtpërdrejtë të vendimeve, por edhe ndaj të gjithë atyre që mund të ndihmojnë në realizimin e synimeve të përfaqësimit siç, janë p.sh. publiku, personat me autoritet, krijuesit e mendimit publik etj.

Përfaqësimi si proces, përfshinë një mori veprimesh politike të zbatuara nga grupe të organizuara të qytetarëve, me qëllim të ndryshimeve të caktuara në dobi të palëve të prekura, të cilat janë të përfshira në proces. Kur e themi nocionin n përfaqësim, normalisht mendja na shkon se kemi të bëjmë me bashkëpunimin nëpërmjet njerëzve nëpër organizata të ndryshme apo grupe të caktuara me qëllim të ndryshimeve të caktuara. Përfaqësim do të thotë të bisedosh dhe t'i tërheqësh vëmendjen e një komuniteti të caktuar për ndonjë çështje të rëndësishme dhe të caktohen bartësit e vendimeve për të bërë zgjidhjen e çështjes së caktuar. Për të arritur nivelin e përfaqësimit ashtu si duhet, ekzistojnë një mori strategjish, të cilat kanë si synim të ndikojnë në procesin e miratimit të vendimeve në nivel lokal, qendror, rajonal, kombëtar, ndërkombëtar etj.

Ndryshe, përfaqësimin shumë njerëz e quajnë edhe si ndryshimi i bilancit të baraspeshave të fuqive, të një lloji ku të pafuqishmit fitojnë fuqi të konsiderueshme që të ndikojnë mbi të fuqishmit. Përfaqësimi si institucion, përveç karakteristikave të lartë përmendura, ka të

bëjë edhe me politikën si një proces i krijimit të ndryshimeve të mëdha, nëpërmes të cilave mund të ndryshojmë ligje, rregulla dhe procedura të caktuara. Por, procesi i përfaqësimit nuk duhet të përfundojë vetëm me politikën, por aktivitetet duhet të drejtohen edhe në përfshirjen e palëve të prekura në procesin e përcjelljes së implementimit të vendimit të ri, i cili është në formë ligji, rregulli apo procedure.

Nëpërmes të përfaqësimit, mund të arrihet edhe ndryshimi i sistemeve të caktuara politike, ndryshime të mëdha demokratike si një nivel më i lartë ndaj të cilit duhet të përpiqet çdo përfaqësues. Kur arrihet ky nivel i rezultateve, qytetarët si palë të prekura, apo marginalizuara janë, të ndërgjegjshme për të drejtat dhe forcën e tyre dhe menjëherë fillojnë të marrin pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve në të gjitha nivelet.

Për të arritur këtë nivel të përfaqësimit, normalisht, nga faktori njeri kërkohen aktivitete të shumta, për një kohë të gjatë, ndoshta edhe për një gjeneratë të tërë njerëzish. Arritja e ndryshimit demokratik të përfaqësimit, është shumë e vështirë për arsye se me këtë rast duhet ndryshuar edhe bindjet kulturore, të cilat janë krijuar nga një proces i gjatë e sistematik i largimit të qytetarëve nga proceset e politikave në vendimmarrje.

Pra, çdo aktivitet i përfaqësimit për t'u treguar i denjë dhe i suksesshëm, duhet të arrijë tri nivele të rezultateve: atë të ndryshimit të politikave dhe praktikave; ndryshimit të sistemit dhe ndryshimit demokratik. Një shoqëri e fuqishme qytetare e cila nëpërmes përfaqësimit i arrin këto tri nivele të ndryshimit, mund të quhet si shoqëri e suksesshme, përmes së cilës qytetarët e saj, mund t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre dhe të arrijnë të organizohen, apo janë të aftë t'i zgjidhin problemet me të cilat ballafaqohen.

Kur flitet për përfaqësimin, nuk mundemi për pa i përmendur disa nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që janë marrë me trajtimin e kësaj teme, para se gjithash siç është Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,⁴³ e cila si e tillë vë në spikamë faktin se çdo qytetar do të ketë të drejtën dhe mundësinë, të shpreh botëkuptimet e veta lirshëm. Gjithashtu, çdo qytetarë ka të drejtë:

- a) Të merr pjesë në udhëheqjen e punëve publike, në mënyrë direkte ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm;
- b) Të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje e organizuara nga institucionet përkatëse;
- c) Të ketë të drejtë të barabartë në shërbimet publike në vendin e tij.

I njëjti dokument thekson se në ato shtete ku ekzistojnë minoritete etnike, fetare e linguistike, personave që u takojnë këtyre minoriteteve nuk do t'u mohohet e drejta, në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, të gëzojnë kulturën e tyre, të predikojnë dhe praktikojnë fenë e tyre, ose të përdorin gjuhën e tyre.⁴⁴

Një dokument tjetër i rëndësishëm është po ashtu, Deklarata për të Drejtat e Personave që u takojnë Minoriteteve Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore,⁴⁵ e cila me dispozitat e veta ka paraparë, përveç tjerash, që: shtetet do të mbrojnë ekzistencën e identitetit nacional ose etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor të minoriteteve brenda territoreve të tyre respektive dhe do të inkurajojnë kushte për promovim të atij identiteti. Po ashtu, personat që u takojnë

⁴³ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme përmes Rezolutës 2200 A(XXI), 1966, neni 25

⁴⁴ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme përmes Rezolutës 2200 A(XXI), 1966,, neni 27

⁴⁵ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 47/135 e 18 dhjetorit 1992

minoriteteve kanë të drejtë të participojnë në mënyrë efektive në jetën kulturore, fetare, sociale dhe publike.

Dokumenti i takimit të Kopenhagës⁴⁶ i vitit 1990, përkrah qëndrimin se shtetet participuese do të respektojnë të drejtën e personave që u takojnë minoriteteve nacionale për participim efektiv në punët publike, përfshirë këtu edhe participimin në punët lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të këtyre minoriteteve. Ato i dallojnë përpjekjet e ndërmarra për mbrojtjen dhe krijimin e kushteve për promovimin e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të minoriteteve të caktuara kombëtare.

Konventa Kornizë⁴⁷ e vitit 1995, përcakton, po ashtu obligimet për palët që i krijojnë kushtet e domosdoshme për participimin efektiv të personave që u takojnë minoriteteve kombëtare si në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike, e po ashtu edhe në punët publike, e veçanërisht ato që ndikojnë në komunitete. Gjithashtu, palët do të përmbahen nga masat, të cilat i ndryshojnë proporcionet e popullatës në regjione të banuara me persona minoritar që kanë për qëllim të reduktojnë të drejtat dhe liritë që rrjedhin nga parimet e Konventës e Kornizë.

Kur flasim për përfaqësimin, nuk mund të lëmë pa i përmendur edhe tri llojet më të përhapura të përfaqësimit:⁴⁸

⁴⁶ Dokumenti i takimit të Kopenhagës të Konferencës për Dimensionet Njerëzore të KSBE-së, neni 35 Kopenhagë, 29 qershor 1990

⁴⁷ Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, neni 15 dhe 16, 1995, neni 15 dhe 16

⁴⁸ Qendra për Përfaqësim, Asociacioni Qytetar MOST, Doracaku për përfaqësim, faqe 16, Shkup 2010

Vetë përfaqësimi: i cili nënkupton të folurit në emër të vet apo përfaqësimit të interesave të caktuara.

Përfaqësimi i rastit: i cili nënkupton të folurit në emër të personit tjetër apo mbrojtjes së interesave të të tjerëve, ose grupit të caktuar të cilët nuk janë në gjendje ta bëjnë vet, dhe

Përfaqësimi publik: i cili nënkupton të folurit në emër të grupit dhe mbrojtja e interesave apo të drejtave të këtij grupi më të gjerë ose një komuniteti në përgjithësi. Nëse duam ta konsiderojmë përfaqësimin publik si një përfaqësim të suksesshëm, atëherë duhet të kemi parasysh disa nga parimet kryesore të tij.⁴⁹

Legjitimiteti: si një parim kryesor dhe themelor i cili ka të bëjë me kompetencën dhe sjelljen e vendimeve në çështje kryesore. Legjitimiteti si parim kryesor i përfaqësimit ka kauzën për të cilën përfaqëson, e cila kauzë jo rrallëherë edhe nuk është e drejtë dhe e pranuar nga të gjithë njerëzit.

Besueshmëria: si parim i përfaqësimit publik do të thotë se, personat besojnë në atë që të tjerët e flasin, apo edhe ata që përfaqësojnë janë të kualifikuar në atë që punojnë dhe të tjerët besojnë në vendimet e tyre. Prandaj, besueshmëria është një element i rëndësishëm i përfaqësimit edhe pse ajo vështirë fitohet por lehtë humbet.

Transparenca: është element tjetër i përfaqësimit, që paraqet dhënien e saktë e të plotë dhe në kohë të informatave të caktuara, që kanë të bëjnë me grupin që përfaqësohet dhe,

Përgjegjësia: është element qenësor sidomos kur kemi të bëjmë me miratuesit e vendimeve të ndryshme. Tek qeverisjet e mira, përgjegjësia është elementi kryesor në procesin e sigurimit të një mekanizmi kontrollues, i cili garanton krijimin e politikave dhe praktikave kualitative.

⁴⁹ Qendra për Përfaqësim, Asociacioni Qytetar MOST, Doracaku për përfaqësim, faqe 17, Shkup 2010

Përfaqësimi i minoriteteve në punët publike është posaçërisht qenësor në lidhje me kuptimin e tyre për të përcaktuar dhe ruajtur identitetin e tyre, ngase kështu është shumë me rëndësi për ndjenjën e tyre për ta vlerësuar veten si pjesë e shtetit dhe si pjesë përbërëse e një komuniteti të caktuar. Përmes përfaqësimit, mundësohet mbrojtja më e mirë e interesave të tyre dhe nga ana tjetër përfaqësimi në punët publike ndihmon për të informuar me kohë organet vendimmarrëse për problemet dhe shqetësimet e tyre, gjë që mundëson zgjidhje dhe vendimmarrje më të mirë në favor të atyre që i përfaqësojnë.

Ekzistojnë qëndrime të ndryshme rreth asaj, se si duhet të ndihmohet dhe strukturohet përfaqësimi i minoriteteve në jetën publike. Një grup e mbrojnë qëndrimin se duhet të vendosen dispozita të ndara për përfaqësimin e minoriteteve, si në përfaqësimin në kuadër të organit legjislativ ashtu edhe në kuadër të pushtetit ekzekutiv dhe se duhet të ketë sa më shumë që është e mundur vetëqeverisje nga ana e vet minoriteteve. Ndërkaq, grupi tjetër mbrojnë qëndrimin tjetër se modalitetet për mënyrën e përfaqësimit të minoriteteve në jetën publike, duhet të dizajnohen në mënyrë që të inkurajojnë integrimin politik të atyre minoriteteve.

Zgjidhja që mund të gjendet si kompromis në mes të këtyre dy qëndrimeve mund të varet, në më shumë situata, në rrethanat dhe pengesat që mund të shfaqen e më pak në meritat e këtyre dy botëkuptimeve. Rrethanat objektive si dhe ambiciet që minoritetet mund të kenë, ndryshojnë shume nga njëri vend në tjetrin dhe nga një periudhë kohore në periudhën tjetër. Për shembull, madhësia e minoritetit në kuadër të një shteti dhe në kuadër të një bashkësie shumë etnike, mund të jetë një faktor i rëndësishëm. Pra, një minoritet me numër më të

madhe të pjesëtareve të tij në kuadër të shtetit, mund të mos ketë nevojë që të kërkojë rregulla speciale për përfaqësimin në legjislativ, por, nga ana tjetër, një minoritet i vogël në për nga numri dhe me fuqi të vogël ekonomike kërkon mundësi përfaqësimi. Prandaj, zgjidhja e modaliteteve varet nga qëllimet përfundimtare, të cilat ia kanë vënë vetes shteti në njërën anë, dhe minoritetet në anën tjetër.

4.1. Përfaqësimi i minoriteteve në Republikën e Kosovës në organet e nivelit qendror

Sa i përket çështjes së përfaqësimit të komuniteteve në punësim dhe institucionet publike, mund të themi se Republika e Kosovës ofron kushte të barabarta përfaqësimi për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim etnie. Ajo, me qëllim të realizimit të të drejtave të komuniteteve pakicë, çështjen e përfaqësimit të barabartë në punësim, në organet publike, në ndërmarrjet publike dhe në të gjitha nivelet (sidomos në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës), e ka të rregulluar edhe me Kushtetutën e saj, pikërisht me Nenin 61.⁵⁰

Pra, me qëllim të realizimit të të drejtave të komuniteteve pakicë, që jetojnë në Kosovë si dhe për pjesëtarët e tyre, ata sikurse edhe të gjithë qytetarët tjerë që jetojnë në Kosovë, në kushte të njëjta, kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e punëve publike dhe po ashtu edhe të emërohen në funksione të ndryshme publike. Prandaj, me rastin e punësimit në organet e administratës shtetërore, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin e pushtetit

⁵⁰ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 61, 2008

lokal, merret parasysh përbërja nacionale e popullatës dhe e përfaqësimit përkatës të këtyre komuniteteve pakicë nëpër këto institucione.

Pra, sipas dispozitave të cekura më lartë, komunitetet pakicë dhe pjesëtarët e tyre, kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë me rastin e punësimit në organet publike dhe në ndërmarrjet publike, në të gjitha nivelet. Po ashtu, me dispozita kushtetuese janë përcaktuar rregulla speciale, me të cilat sigurohet përfaqësimi i komuniteteve pakicë në institucionet publike. Për disa prej këtyre institucioneve, siç është ta zëmë sektori i sigurisë, është e nevojshme një natyrë me e theksuar shumë etnike e Republikës së Kosovës, kurse, për shumë institucione tjera, nevojat minimale për përfaqësim janë theksuar në mënyrë të veçantë.

4.1.1. Pjesëmarrja e minoriteteve në Zyrën e Presidencës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar në vitin 2008, ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim feje, kombi, ngjyre, race, etj. Përveç një mbrojtje të tillë të përgjithshme, ekzistojnë edhe një varg mbrojtjesh ekskluzive për komunitetet pakicë dhe pjesëtarët e tyre, që në fakt përbëjnë një sistem gjithëpërfshirës mbrojtjeje për minoritetet dhe pjesëtarët që u përkasin atyre dhe që jetojnë në Kosovë.

Në funksion të arritjes së një mbrojtje të plotë për të gjitha komunitetet pakicë, ndër instrumentet e tjera, Kushtetuta ka paraparë themelimin e një organi siç është Këshilli Konsultativ për Komunitete, i cili vepron drejtpërdrejtë në kuadër të zyrës së Presidentit të Kosovës. Në fakt, korniza legjislative për themelimin e këtij organi brenda zyrës së

Presidentit, është përfshirë së pari në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mandati i tij është definuar në Ligjin për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008.

Si rrjedhojë e kësaj, Presidenti i Kosovës, përmes dekretit presidencial, me datë 15 shtator 2008 ka themeluar Këshillin Konsultativ për Komunitete, i cili vepron në kuadër të zyrës së Presidentit. Përveç themelimit të këtij organi, po ashtu, në kuadër të zyrës së Presidentit të Kosovës është themeluar edhe i ashtuquajti Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Sa i përket strukturës organizative të Këshillit Konsultativ për Komunitete⁵¹, ai përbëhet prej përfaqësuesve të komuniteteve dhe të Qeverisë. Presidenti i Kosovës është personi përgjegjës për emërimin e dy të tretave të anëtarëve të këtij organi, me mandat prej dy vitesh, në pajtim me propozimet e marra nga ana e organizatave përfaqësuese të këtyre komuniteteve. Ndërkaq, pjesa tjetër e këtij organi plotësohet nga pjesëtarët e Qeverisë dhe Agjencionet tjera publike që janë të thirrura për adresimin e çështjeve që lidhen me komunitete pakicë, siç janë: Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Kryetarit të Kuvendit, Ministria për Komunitete dhe Kthim etj.

Sipas statutit mbi themelimin e këtij organi, përbërja e tij sa i përket pjesëmarrjes së komuniteteve duket kështu: komuniteti serb përfaqësohet me (5) anëtarë, komuniteti rom, egjiptian e ashkali secili nga (2) anëtarë, komuniteti boshnjak dhe ai turk secili nga (3)

⁵¹ Mekanizëm i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

anëtarë, komuniteti goran po ashtu përfaqëson me (2) anëtarë si dhe përfaqësues të komuniteteve tjera me (1) anëtarë.

Funksionet kryesore të këtij Këshilli përveç tjerash janë: të ndihmojë në organizimin dhe artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacion, politika publike dhe programet të ndryshme. Po ashtu, të shërbejë si formulë për koordinim dhe konsultime ndërmjet komuniteteve dhe të sigurojë njëkohësisht funksionimin e organizatave përfaqësuese të komuniteteve.

Gjithashtu, ka funksion të shërbejë si mekanizëm për: shkëmbimin e rregullt të pikëpamjeve në mes komuniteteve dhe institucioneve shtetërore, tu ofrojë komuniteteve mundësinë që të marrin pjesë në fazat e hershme, në iniciativat legjislative dhe të politikave, përmes këshillimit të Qeverisë dhe organeve e agjencioneve të tjera përkatëse si dhe t'u mundësojë komuniteteve pakicë, që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u dedikohen pjesëtarëve të tyre.

4.1.2. Pjesëmarrja e minoriteteve në Pushtetin Legjislativ

Fillimisht, menjëherë pas luftës, pozita dhe roli i Kuvendit të Kosovës si organ legjislativ ishte i definuar sipas Kreut të nëntë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me 15 maj të vitit 2001, përmes nënshkrimit të Rregullores Nr. 2001/9. Sipas këtij dokumenti, Kuvendi i Kosovës ishte institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vetëqeverisjes së përkohshme të Kosovës dhe se përbëhej prej (120) deputetëve të zgjedhur me votim të fshehtë.

Gjithnjë sipas Kornizës Kushtetuese, Kosova konsiderohej një zonë e vetme elektorale shumë anëtarëshe për qëllimet e zgjedhjes së Kuvendit. Në këtë kuadër, (100) prej (120) vendeve të Kuvendit shpërndareshin ndërmjet të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që i kanë fituar ata në zgjedhjet për Kuvend.

Ndërkaq, (20) prej (120) vendeve rezervoheshin për përfaqësim plotësues të komuniteteve pakicë të Kosovës. Gjendja e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në kuvend dukej si me poshtë:

- (i) dhjetë (10) vende u ndaheshin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që kanë deklaruar vetë se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës dhe se këto vende iu shpërndareshin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata merrnin në zgjedhjet për Kuvend ndërsa
- (ii) dhjetë (10), vende tjera u rezervoheshin komuniteteve tjera: romëve, ashkalinjëve dhe komunitetit egjiptian (4) vende, komunitetit boshnjak (3), komunitetit turk (2) dhe komunitetit goran (1) vend. Vendet për secilin komunitet iu ndaheshin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata merrnin në zgjedhjet për Kuvend.⁵²

Sipas kësaj Kornize, Kryesia e Kuvendit përbëhej prej (8) deputetëve të Kuvendit të cilët do të zgjidheshin sipas sistemit: (2) anëtarë emëroheshin nga partia ose koalicioni që ka

⁵² Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, e miratuar nga PSSP me Rregulloren Nr. 2001/9, 2001, kreu 9

fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare; (2) anëtarë emëroreshin nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e dytë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare; (1) anëtar emërohej nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e tretë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare; (1) anëtar emërohej nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e katërt me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare; (1) anëtar emërohej nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb dhe (1) anëtar emërohej nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin komunitet tjera, përveç komunitetit shqiptar dhe komunitetit serb.

Korniza Kushtetuese e Kosovës, përveç tjerash parashihte që në kuadër të Kuvendit të Kosovës, si organi më i lartë legjislativ, të funksionojë Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, i cili përbëhej prej (2) deputetëve nga secili komunitet i Kosovës i përfaqësuar në Kuvend.

Dispozitat e kësaj Kornize Kushtetuese, përcaktonin qartë se me kërkesën e cilit do anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, çdo projektligj mund t'i paraqitej Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, i cili komision me shumicën e votave të anëtarëve të tij vendoste se a duhet bërë rekomandime lidhur me ligjin e propozuar apo jo. Nëse komisioni në fjalë, vendoste për të dhënë rekomandime ato duhej t'i bënte brenda dy javësh nga dita e pranimi në komision të projektligjit dhe ato rekomandime shkonin në drejtim që të sigurohej se të drejtat dhe interesat e komuniteteve pakicë ishin trajtuar drejtë dhe në

mënyrë korrekte. Ky komision, kishte po ashtu të drejtë, që sipas nismës së tij, të propozonte projektligje dhe masa tjera të nevojshme në fushën e përgjegjësi të Kuvendit për të trajtuar të gjitha shqetësimet e komuniteteve pakicë.

Në frymën e Kornizës Kushtetuese dhe në përputhje me dispozitat e saj, ishte miratuar në muajin nëntor 2001 edhe Rregullorja për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës⁵³ e cila sa i përket përfaqësimit të komuniteteve pakicë, reflektonte në tërësi sa i përket ndarjes së vendeve në kuvend, ashtu siç ishte paraparë me Kornizën Kushtetuese.

Ndërkaq, me shpalljen e Deklaratës mbi Pavarësinë e Kosovës me 17 Shkurt të vitit 2008 dhe miratimin në të njëjtin vit të Kushtetutës⁵⁴, u hap rrugë për definimin me dispozita kushtetuese të çështjes së përfaqësimit të komuniteteve pakicë në përbërjen e Kuvendit të ri të Republikës së Kosovës dhe përfaqësimin e tyre në kuadër të komisioneve të themeluara brenda Kuvendit. Në këtë drejtim, kapitulli i katërt i Kushtetutës përcakton qartë Kuvendin si institucion më të lartë përfaqësues dhe organin më të lartë ligjvënës të Republikës së Kosovës.

Nëpërmjet këtij organi vjen në shprehje sovraniteti i plotë i popullit, që përbëhet prej (120) deputetëve të zgjedhur me votim të fshehtë duke u bazuar në listat e hapura dhe ku vendet për deputetë ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre.

Po ashtu edhe Kushtetuta parasheh që në kuadër të kësaj ndarjeje, (20) prej (120) vendeve

⁵³ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/33 për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, nëntor 2001

⁵⁴ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që janë pakicë në Kosovë dhe kjo sipas sistemit:

- (i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb dhe do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10) anëtarë;
- (ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom (1) vend; komuniteti ashkali (1) vend; komuniteti egjiptian (1) vend; dhe (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk (2) vende dhe komuniteti goran (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara⁵⁵.

Siç dihet, pavarësisht nga sistemi i pushtetit, kuvendet mundë të jenë organ përfaqësues njëdhomësh ose organ përfaqësues dy dhomësh. Nëse bëhet fjalë për kuvendin njëdhomësh, atëherë, themi se kemi të bëjmë me një kuvend unik, ndërsa në rastin tjetër, kemi të bëjmë me një kuvend ku përfaqësimi i popullit është i ndarë në dy pjesë të veçanta, të cilat jo gjithmonë mund të kenë kompetenca të barabarta.

Një ndarje e tillë, len të nënkuptohet se vetëm kuvendet njëdhomëshe janë në harmoni me parimin e sovranitetit popullor. Sipas këtij qëndrimi, mund të thuhet se populli nuk mund të

⁵⁵ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, 2008

përfaqësohet njëkohësisht në dy forma: në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthorët. Prandaj, ekzistimi i dy dhomave, nënkupton kundërvënie ndaj sovranitetit unik dhe të vetëm të popullit.

Duke u nisur nga ky parim, Kushtetuta e Kosovës, ka mbrojtur qëndrimin se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të jetë Kuvend njëdhomësh, kështu si i tillë në përbërje të vet ka (120) deputetë, në mesin e të cilëve, (20) vende janë të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në Kosovë. Kjo ka ndodhur duke u bazuar në strukturën demografike d.m.th duke pasur në konsideratë strukturën e popullatës minoritare që jeton aty.

Pra, Kushtetuta e Kosovës u'a mundëson të gjitha komuniteteve, pjesëmarrje proporcionale për numër të deputeteve në Kuvend, gjithnjë duke u nisur nga rezultati i zgjedhjeve. Ndërkaq, për shkak të pjesëmarrjes së tyre jo aq të kënaqshme në zgjedhje dhe të ndikimit të papërfillshëm në rezultatin e zgjedhjeve, me Kushtetutë u garantuar këtyre komuniteteve pjesëmarrje të domosdoshme në jetën parlamentare në Kosovës. Në këtë mënyrë Kushtetuta e Kosovës u ka mundësuar një e diku dy vende në Kuvend me qëllim që përfaqësuesit e tyre mund t'i përfaqësojnë interesat e bashkësive të tyre etnike, duke pasur parasysh faktin se askush tjetër nuk i përfaqëson me mire interesat e këtyre komuniteteve.

Për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre që janë pakicë në Kosovë, me Kushtetutën e Kosovës është përcaktuar që në kuadër të Kuvendit të Kosovës, krahas komisioneve tjera, të themelohet edhe një Komision i veçantë,

i përhershëm për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.⁵⁶ Qëllimi i këtij komisioni është që të respektojë të drejtat e komuniteteve dhe të ruajtjen e etnicitetit, pastaj ruajtjen dhe garantimin e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë. E veçanta e këtij Komisioni qëndron në faktin se 1/3 e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit serb në Kuvend; 1/3 e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve tjera dhe 1/3 e anëtarëve të Kuvendit që përfaqëson popullatën shumicë në Kuvend.

Qëllimi i themelimit të këtij komisioni, është pikërisht fakti për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, të jep rekomandime ndaj çdo projektligji të propozuar si dhe të propozon masa tjera brenda përgjegjësi të Kuvendit të cilat mund të konsiderohen se janë të nevojshme për t'i adresuar interesat e komuniteteve pakicë.

4.1.3. Pjesëmarrja e minoriteteve në përbërjen e Pushtetit Ekzekutiv

Pozita kushtetuese e pushtetit ekzekutiv dallon varësisht prej modelit të qeverisjes. Në këtë kuptim, kur është fjala për një shtet republikan, pozita e ekzekutivit dallon varësisht prej asaj se çfarë modeli të ndarjes së pushtetit kemi, cila është fuqia reale e parlamentit dhe varësisht nga roli i Presidentit të Republikës. Është fare e logjikshme se në sistemet presidenciale të qeverisjes, bartës i vetëm i pushtetit ekzekutiv është vet Presidenti i Shtetit dhe ai qeverise atë pushtet pa pasur asnjë kufizim brenda konturave të pushtetit ekzekutiv.

⁵⁶ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 78, 2008

Ndërkaq, në sisteme të qeverisjes parlamentare, ekziston një situatë tjetër, ani pse, edhe tek ky sistem ekziston një variacion që ndërlidhet me nëntipin e këtij sistemi qeverisës.

Pra tek sistemet parlamentare të shteteve, Qeveria është bartëse e funksionit ekzekutiv të shtetit dhe këtë pushtet e ushtron pothuajse e vetme.⁵⁷ Në këtë drejtim, Qeveria si instrument ekzekutiv i shtetit ka obligim ligjor zbatimin e së drejtës dhe këtë detyrim nuk është e lejueshme që të ndërlidh me diskrecionin politik ose përgjegjësinë politike që ajo bartë në vete. Prandaj, Qeveria në praktikë, zbaton politika publike në fushën e përgjegjësi të saj, duke i dhënë përgjegjësi politike Kuvendit tek sistemet parlamentare, apo Presidentit të Shtetit, tek sistemet e qeverisjes presidenciale.

Nga ana tjetër, një funksion shumë të rëndësishëm të Qeverisë, përveç tjerash, është edhe menaxhimi i administratës publike të shtetit. Koncepti Qeveri përfshin dy nivele: nivelin politik, i cili në fakt është në krye të Qeverisë, gjegjësisht resorëve përkatës të saj dhe përbëhet nga të zgjedhurit politik të shtetit dhe niveli administrativ civil, i cili përbëhet nga shërbyesit civilë, gjegjësisht nga administrata publike. Administrata publike që punon nën direktivat e nivelit të parë, atij politik, me qëllim të realizimit të funksionit ekzekutiv të Qeverisë.

Pavarësisht kësaj, menaxhimi i administratës publike dhe administratës shtetërore, nga ana e Qeverisë, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të shërbimit civil. Në këtë aspekt, në shërbimin civil është e ndaluar ndërhyrja e kontrollit politik për shkak të parimit

⁵⁷ Taylor, Hannis, The Outlook for Parliamentary Government. The North American Review, 1895, Vol, 160, No 461, faqe 479-491

profesional, meritokracisë, efikasitetit dhe paanshmërisë politike që duhet ta karakterizoj këtë shërbimi civil.

Kur flasim për Qeverinë si instrument i pushtetit ekzekutiv në Kosovë, që nga përfundimit të luftës e këndej, atëherë, konsiderojmë se ky instrument ishte i paraparë që nga Korniza Kushtetuese⁵⁸ e vitit 2001. Korniza Kushtetuese e ngarkonte Qeverinë me përgjegjësi ekzekutive duke i zbatuar ligjet e miratuara nga Kuvendi, brenda domenit të përgjegjësive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të parashtruara me këtë dokument.

Kur është fjala për pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në përbërjen e Qeverisë, Korniza Kushtetuese parashihte që në kuadër të saj, të paktën (2) ministra duhet të ishin nga komunitetet tjera përveç komunitetit që kishte shumicën në kuvend. Njeri nga këta dy ministra duhej të ishte nga komuniteti serb ndërsa tjetri duhej ti përkiste një komuniteti tjetër. Po ashtu, ishte lënë mundësia, që në rastet kur Qeveria vendos të emërojë me tepër se dymbëdhjetë (12) ministra, atëherë edhe një ministër i tretë duhej të emërohej nga një komunitet që nuk e përbënte shumicën në Kosovë. Ky ministër zgjidhej pas konsultimeve me partitë politike dhe grupet minoritare që përfaqësonin Kuvend.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me dispozitat e veta, ka përcaktuar parimet baze institucionale, funksionet, përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si instrument i pushtetit ekzekutiv, që të zbatojë ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu, kjo qeveri është ngarkuar edhe me ushtrimin e veprimtarive tjera brenda përgjegjësive saj të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj. Ndërsa, kur bëhet fjalë për

⁵⁸ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ,UNMIK, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosove, e miratuar nga PSSP me Rregulloren Nr. 2001/9, 2001, Pjesa 3

përfaqësimit të komuniteteve pakicë në Qeveri, Kushtetuta ka përcaktuar qartë formën e përfaqësimit të komuniteteve pakice në Qeveri përmes vendeve të rezervuara për pakica.

Me dispozita kushtetuese është përcaktuar përbërja shumë etnike e Qeverisë dhe mënyra e përfaqësimit të komunitetit serb në Qeveri. Qeveria duhet të ketë së paku, një ministër nga komuniteti serb dhe një ministër nga komunitet tjetra pakice që jeton në Kosovë. Po ashtu, sikurse Korniza Kushtetuese me herët edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të komuniteteve pakicë në përbërjen e Qeverisë, ka paraparë që në rastin kur Qeveria ka më shumë se (12) ministra, atëherë edhe (1) ministër i tretë duhet të emërohet nga një komunitet që nuk e përbënte shumicën në Kosovë.

Pra, rezervimi në ekzekutiv me dispozita kushtetuese i së paku dy (2) vendeve për ministrat të komuniteteve që e bëjnë pakicën, në Kosovë, paraqet një garancion të padiskutueshëm lidhur me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në përbërjen e Qeverisë. Një vendim i tillë nuk mund të haset në ndonjërin prej kushtetutave të vendeve të rajonit dhe edhe më gjerë. Përcaktimi për së paku dy ministra nga komunitetet pakicë, nuk e përjashton mundësinë që në kuadër të Qeverisë të ketë edhe më shumë ministra të tillë që vijnë nga komunitetet tjera, natyrisht, nëse për këtë ekziston vullneti i mandatarit të Qeverisë.

Përfaqësimi i tillë i rezervuar për komunitete pakicë në përbërjen e Qeverisë, reflekton të ashtuquajturin parim të “qeverisjes së gjerë” në kuptim të shumë etnicitetit dhe përbën ndoshta njërin ndër kushtet themelore të demokracisë.

Përveç kësaj që u tha më sipër, Kushtetuta ka përcaktuar, që në kuadër të përbërjes së Qeverisë së Kosovës, duhet të rezervohen së paku (2) vende për ministra nga përfaqësuesit e komunitetit serb dhe po ashtu, (2) ministra nga përfaqësues të komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë. Edhe kur bëhet fjalë për zëvendësministra, nëse Qeveria ka më tepër se (12) resorë ministror, atëherë, edhe me këtë rast rezervohen edhe (2) vende shtesë për zëvendësministra nga radhët e komuniteteve pakicë.

Pra, nga ajo që shihet, rezulton së Kushtetuta mundëson që përveç rezervimit të ulëseve në nivel ministror, komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë i kanë të garantuara edhe vendet të caktuara në nivele të zëvendësministrave.

Duke u nisur nga ky fakt, për trajtim sa më gjithëpërfshirës për pjesëmarrje të komuniteteve pakicë, jo vetëm në nivelin politik të pushtetit ekzekutiv, por edhe në atë të administratës publike, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nga viti 2008, u themelua edhe Zyra për Çështje të Komuniteteve, e cila udhëhiqet nga Këshilltari politik i emëruar nga Kryeministri. Kjo zyrë ka përgjegjësi për informim dhe këshillim të Kryeministrit në kohë dhe në mënyrë të duhur për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë, duke filluar që nga niveli lokal e deri në nivelin qendrorë.

Po ashtu, përmes kësaj zyre, koordinohen të gjitha çështjet e lidhura me komunitetet përfshirë: koordinimin e organeve qeveritare; agjencive të pavarura dhe institucioneve në nivel ministror dhe komunal; koordinimin e donatorëve dhe të organizatave ndërkombëtare, për të siguruar që problemet e komuniteteve të kenë marrë zgjidhje të efektshme në tërë Kosovën; sigurimin e barazisë në ndarjen e fondeve dhe shfrytëzimin efektiv të tyre, si dhe

monitorimin e këtyre organeve për të siguruar që janë duke i zbatuar në mënyrë efektive detyrat e caktuara.

Rol tjetër i Zyrës për Çështje të Komuniteteve ka të beje me organizimin e aktiviteteve, përmes të cilave analizon dhe jep këshilla të domosdoshme për sa i përket politikës qeveritare; zhvillon dhe monitoron zbatimin e strategjive të Qeverisë që kanë të bëjnë me komunitetet; monitoron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të komuniteteve dhe ndikimin e tyre në komunitetet. Përveç këtyre detyrave, kjo zyre adreson nevojat praktike të komuniteteve përmes: shfrytëzimit strategjik të fondeve në dispozicion; këshillon dhe ndihmon për zgjidhjen e rasteve që lidhen me komunitetet.

Zyra për çështje të komuniteteve, gjithashtu, zhvillon kanale efektive komunikimi me komunitetet; konsultohet me komunitetet dhe shoqërinë civile përmes vizitave dhe takimeve të rregullta në terren; promovon trajtim të barabartë të të gjitha komuniteteve duke kultivuar marrëdhënie të mira dhe koordinim me të gjitha palët e përfshira posaçërisht me MKK-në, MAQL-në, KKK-në, KDIKK-në, ZQM-në dhe Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në janar të vitit 2005, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/50 është themeluar Ministria për Komunitete dhe Kthim, ku të gjitha kompetencat dhe dokumentacioni i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, e cila funksiononte brenda zyrës së Kryeministrit u transferua tek kjo ministri.⁵⁹ Megjithatë, më vonë kjo ministri për çështje të komuniteteve ka vazhduar të ketë një bashkëpunim shumë të mirë me Zyrën për Çështje të Komuniteteve, e

⁵⁹ Ministria për Komunitete dhe Kthim, Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2009-2013) faqe 7, 2009

cila është themeluar gjatë vitit 2008, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe e cila kishte për qëllim të këshillonte kryeministrin mbi çështje specifike që u përkisnin komuniteteve. Qysh në fazën fillestare të themelimit të kësaj ministrie, por edhe tani këtë ministri e udhëheqin pjesëtarët e komuniteteve pakicë të cilat jetojnë në Kosovë, megjithëse brenda saj ka të punësuar edhe pjesëtarë të të gjitha komuniteteve të tjera të cilat gjenden brenda vendit.

Misioni i kësaj ministrie është, para se të gjithash, krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe zhvillim të komuniteteve në të gjitha aspektet e jetës ekonomike, shoqërore, institucionale etj. Kthimi i qëndrueshëm dhe zhvillimi, nënkupton përmbushjen e nevojave shoqëro-ekonomike, stabilizimin e komuniteteve dhe kthimin e qëndrueshëm të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Megjithatë, prioritet kryesor i kësaj ministrie mbetet përmirësimi i kapaciteteve për të zhvilluar dhe zbatuar ligjet, rregulloret dhe standardet në lidhje me sigurinë, arsimin, shërbimet shëndetësore, sociale dhe përdorimit të gjuhës. Gjithashtu kjo ministri ka për prioritet edhe rritjen e vetëdijes në mesin e anëtarëve të komuniteteve lidhur me vlerat e një shoqërie shumë etnike, demokratike dhe prosperuese, e cila siguron një përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve në jetën publike etj.

Për të përmbushur mandatin e vet, sipas legjislacionit që është në fuqi, kjo ministri ka disa kompetenca nga fushëveprimi i saj, të cilat janë si me poshtë;

- (i) zhvillon politikat, promovon dhe zbaton ligje për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

- (ii) promovon krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim dhe siguron një qasje ndaj kthimit, që bazohet në të drejta;
- (iii) siguron udhëheqjen në krijimin e besimit, në aktivitetet për dialog dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe mbështet zbatimin e këtyre aktiviteteve;
- (iv) zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e një strategjie qeveritare për ndihmë, që u drejtohet komuniteteve dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e këtyre strategjive në të gjitha komunat;
- (v) zhvillon e menaxhon programe dhe mekanizma për të ndihmuar integrimin në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe të refugjatëve;
- (vi) siguron se politika në nivel qendror dhe komunal përfshin dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë fushën e lirisë së lëvizjes, përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimit, punësimit dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe shërbime publike e komunale;
- (vii) bënë rekomandime dhe koordinon e mbikëqyr aktivitetet e ministrive, të komunave dhe të autoriteteve të tjera, që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, e sipas nevojës, rishikon veprimtaritë, dosjet dhe dokumentet e këtyre organeve, nëse jepet autorizimi i Kryeministrit për këtë gjë.

Po ashtu, Ministria për Komunitete dhe Kthim, krahas përgjegjësi të cekura më sipër, ka edhe përgjegjësi tjera siç janë:

- (i) mbikëqyrë dhe mbështet përpjekjet e komunave për trajtimin e çështjeve të komuniteteve dhe kthimeve, duke përfshirë punën e komisioneve për

ndërmjetësim, komisioneve për komunitete, zyrat komunale për komunitete dhe zhvillimin e zbatimin e strategjive komunale për kthim;

- (ii) rishikon dhe iu ofron ndihmë ministrive të tjera në lidhje me procedurat dhe aktivitetet ekzistuese, sikurse edhe politikat e propozuara dhe projektligjet, për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre si dhe përputhjen e akteve legislative të institucioneve të Republikës së Kosovës me standarde të rëndësishme ndërkombëtare dhe me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- (iii) koordinon punët (aktivitetet) me ministritë, komunat dhe autoritetet e tjera për gjetjen e zgjidhjes për shpërnguljet dhe nevojat humanitare të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre;
- (iv) koordinon po ashtu, me ministritë, komunat dhe autoritetet e tjera zbatimin e një strategjie për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, të të shpërngulurve dhe të kthyerve, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe grupeve të tjera të ndjeshme;
- (v) mbikëqyrë dhe mbështet kornizën operative për kthime, për të siguruar një qasje, që mbështetet apo bazohet në të drejta dhe që iu përgjigjet nevojave të personave të shpërngulur dhe bashkëpunimit me ministri të tjera, me agjencitë dhe OJQ-të e ndryshme gjatë këtij procesi; si dhe
- (vi) ndihmon në zhvillimin dhe në zbatimin e masave në fushën e informimit publik dhe të projekteve të tjera provuese për ngritjen e vetëdijes publike përkritazi me

të drejtat dhe interesat e komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për tu kthyer.

Falë punës dhe përkushtimit të kësaj ministrie që nga momenti i themelimit e deri më tani, duke mos lanë anash as angazhimin e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë vepruar me herët, që nga përfundimi i luftës deri në vitin 2013 në Kosovë, janë kthyer diku jo më pak se 20.000 persona nga komunitetet pakicë⁶⁰. Megjithatë, kjo ministri për të përmbushur mandatin dhe qëllimin e saj vazhdimisht është duke bërë përpjekje që të forcojë procesin e kthimit duke u përpjekur për të krijuar mekanizma më të përshtatshëm në mënyrë që të thjeshtësojë dhe lehtësojë edhe me tutje procesin e kthimit të komuniteteve pakicë.

4.1.4. Përfaqësimi në Shërbimin Civil të Kosovës

Shërbimi Civil është shtylla kryesore e një shteti funksional, themi kështu duke u nisur nga fakti se administrojnë politikat e qeverisjes dhe ofron shërbime publike për të gjithë qytetarët. Kosova si një shtet i ri gjithmonë, ka bërë përpjekje që të përmirësojë dhe të ngrit një shërbim civil sa më profesional. Gjatë gjithë kësaj kohe ajo ka bërë përpjekje që shërbimin civil të saj ta ngrit edhe në baza etnike.

Sipas regjistrimeve të fundit të popullsisë të mbajtur në vitin 2011, Kosova ka një popullatë të përgjithshme prej 1.73 milionë banorësh. Shqiptarët e Kosovës, siç u theksua edhe më herët, përbëjnë diku mbi 90% të popullatës së përgjithshme, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga pjesëtarët e komuniteteve tjera të cilat jetojnë si pakicë në territorin e Kosovës. Sipas regjistrimit të fundit të popullatës, serbët me 1.47% (rreth:5%), turqit me 1,08%,

⁶⁰ Raport i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

boshnjakët 1.58%, romët 0.51%, ashkalit 0.89%, egjiptianët 0.66%, goranët 0.59%, dhe të tjerët siç janë malazezët e kroatët⁶¹ me 0.14%. Pra, pjesëtarët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, përbëjnë përafërsisht 6.91% të popullatës së përgjithshme. Ne kuadër të këtyre të dhënave nuk janë përfshirë këtu banoret e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore, prandaj edhe këtu është përdorur shifra (5%) si referencë për popullatën serbe.⁶²

Duke u bazuar në parimet e përgjithshme të mos diskriminimit , mundësive të barabarta dhe të përfaqësimit të barabartë⁶³, Ligji mbi Shërbimin Civil në dispozitat e veta ka përcaktuar se komunitetet pakicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që të kenë përfaqësim të duhur dhe proporcional në shërbimin civil, duke u përfshirë sikurse organet e administratës publike në nivel qendror, po ashtu, edhe ato në nivel lokal. Për ta zbatuar më lehtë këtë ligj sa i përket çështjes së përfaqësimit të komuniteteve pakicë, është miratuar edhe një Rregullore e veçantë⁶⁴ përmes së cilës përcaktohet kuota prej 10% si obligative për pozitat në nivel qendror që të plotësohen nga stafi që i përket komuniteteve pakicë.

Ndërsa në nivelin lokal ky përfaqësim duhet të jetë në proporcion me përbërjen demografike të popullatës që jeton në ato komunave. Për më tepër kjo rregullore, përcakton dhe numrin e pozitave të larta për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, ku në nivelin qendror ky numër është prapë 10% nga numri total i pozitave të nivelit të lartë brenda institucionit,

⁶¹ Komuniteti Kroat dhe Malazez nuk janë përfshirë si grupe të veçanta etnike me regjistrimin e vitit 2011 të popullatës por janë të përfshira në dhjetor të po këtij viti me ligjin për komunitete.

⁶² Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo- shumicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike në Kosovë, maj 2013, faqe 12

⁶³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 5 dhe 11,2010

⁶⁴ Ministria e Administratës Publike, Rregullorja Nr. 04/2010 për Procedurat e Përfaqësimit të duhur dhe proporcional të komuniteteve që nuk janë shumicë në shërbimin civil të Kosovës, 2010

kurse në nivelin lokal, prapë numri i pozitive të larta që ju takojnë komuniteteve pakicë duhet të jetë proporcional me përbërjen demografike të komunës përkatëse.

Siç shihet, Ligji mbi Shërbimin Civil obligon të gjitha institucionet publike të Kosovës që të zbatojnë kuotat për punësimin e nëpunësve civilë të komuniteteve pakicë dhe në këtë mënyrë, kështu të përmbushin obligimin e marrë në aplikimin e masave të caktuara aktive për punësim.

Duke u nisur nga kjo, se rritja ekonomike dhe punësimi janë në mesin e faktorëve kryesorë për mbijetesën dhe integrimin e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, Zyra për Çështje të Komuniteteve, e cila ekziston në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, gjatë vitit 2013 mori vendim për fillimin e një nisme që kishte për qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e masave me anë të të cilave do të sigurohej zbatimi i plotë i ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese dhe përmes kësaj nisme të arrinin të krijonin një politikë më të mirë në punësimin e komuniteteve pakicë në Kosovë. Pra, Zyra për Çështje të Komuniteteve kishte vendosur që të kontribuojë në krijimin e politikave dhe strategjive afatgjate për rritjen e punësimit të komuniteteve pakicë, të cilat jetojnë brenda Kosovës.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth përfaqësimit të komunitetit pakicë në shërbimin civil të Kosovës, si në nivelin qendror dhe atë lokal, pastaj në ndërmarrje publike, kompani publike dhe agjencione të tjera, kjo zyre, gjatë vitit 2010 ka realizuar një studim rreth punësimit të tyre në këto institucione si dhe ka bërë një vlerësim të shkallës së zbatimit të dispozitave vendore lidhur me punësimin e këtyre komuniteteve pakicë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011 pas një nisme të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Qeveria e Kosovës, mori vendim për themelimin e një grupi punues, i cili do të kishte për qëllim të

hartonte si dhe të rekomandonte masa të caktuara me qëllim të rritjes së efikasitetit të mekanizmave dhe procedurave që kanë të bëjnë me punësimin e komuniteteve pakicë në Kosovë. Pra, siç thamë edhe më herët qëllimi i këtij studimi është evidentimi, dhënia e një pasqyre më të qartë, rreth nivelit të përfaqësimit të komunitetit pakicë në pushtetin qendror dhe lokal, shpërndarjen e komuniteteve pakicë në strukturën e hierarkisë së institucioneve të Kosovës, evidentimin e masave aktive të marra për punësim, trajnime dhe të tjera, si dhe dhënia e rekomandimeve të caktuara që do të kontribuonin në rritjen e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në institucionet publike.

Lidhur me përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në shërbimin civil të Kosovës, nga viti 2010 e këtej janë marrë shumë institucione vendore, por edhe ndërkombëtare si OSBE,⁶⁵ Ministra e Administratës Publike,⁶⁶ ECMI⁶⁷ etj. Të dhënat e këtyre institucioneve lidhur me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në shërbimin civil, janë të përafërta por nuk përputhën mes vete.

Prandaj, Zyra për Çështje të Komuniteteve, pranë Zyrës së Kryeministrit, ka analizuar bashkërisht të gjitha këto të dhëna të këtyre institucioneve duke i krahasuar ato me numrin e banorëve në Kosovë sipas regjistrimit të fundit të vitit 2011 të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prandaj, në mungesë të të dhënave të sakta, i referohemi përqindjeve të marra nga Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit

⁶⁵ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, Raporti I OSBE-së për Vlerësimin e Komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës (2013)

⁶⁶ Ministria e Administratës Publike, Raporti tre mujor mbi të punësuarit në Shërbimin Civil , dhjetor 2012

⁶⁷ European Centre for Minority Issues, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Prishtinë

edhe pse as këto përqindje nuk e pasqyrojnë realitetin e saktë të përfaqësimit të komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës, për arsye se kur është fjala për numrin e saktë të banorëve tek pjesëtarët e komunitetit serb kjo zyre e komuniteteve i referohet shifrës së marrë nga OSBE⁶⁸ duke e rrumbullakosur atë në 5% e që nga regjistrimet e fundit ajo del se është vetëm 1,47%, duke llogaritur këtu vetëm serbët në pjesën jugore të vendit, por jo edhe ata të tri komunave në veri të vendit, si dhe popullatën në pjesën veriore të komunës së Mitrovicës. Për të vërtetuar këtë, marrim si shembull vetëm përqindjen e vlerësuar nga ana e OSBE-së, e cila definon se në nivelin qendror mbahen përafërsisht 8% të pozitive nga ana e minoriteteve në shërbimin civil, ku serbët, boshnjakët dhe turqit kanë mbi përfaqësim të minoriteteve në proporcion me ashkalinjtë, egjiptianët, goranët dhe romët, të cilët janë dukshëm më pak të përfaqësuar.

Ndërkaq, kur i referohemi raportit vlerësues të Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, lidhur me arritjen e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në shërbimin civil (si atë të nivelit lokal dhe atij qendror) del se është arritur një shkallë prej 7.7%⁶⁹ të të punësuarve të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në shërbimin civil, duke mos llogaritur këtu të punësuarit në ndërmarrje private. Brenda kësaj shifre, më të nën përfaqësuarit janë pjesëtarët e komunitetit RAE dhe pjesëtarët e komunitetit goran, ndërsa

⁶⁸ Vlerësimet nga OSBE-se nuk mundën të merren të sakta sepse edhe ajo vet në raportet e saj i trajton si vlerësime të përafërta të bëra nga terreni.

⁶⁹ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike në Kosovë, maj 2013, faqe 9

pjesëtarët e komunitetit boshnjak, serb e turq janë të përfaqësuar proporcionalisht afër numrit të tyre përkatës të dalë me regjistrimet e popullatës.⁷⁰

Përgjithësisht, arsyeja pse është një gjendje e tillë e nën përfaqësimit në shërbimin civil të një pjese të komuniteteve pakicë, siç janë ata të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian varet nga shumë faktorë, por faktori kryesor është mungesa e kualifikimeve arsimore të kësaj pjese të komunitetit, ndërsa, kur është fjala për mosarritjen e kuotës përkatëse për plotësimin e pozitave në shërbimin civil të Kosovës nga ana e pjesëtarëve të komunitetit serb, përveç faktorëve të tjerë të rëndësishëm, pengesë ka qenë sidomos bojkotimi i institucioneve vendore nga ana e këtij komuniteti si pasojë e politikës së presioneve të udhëhequr nga autoritetet e Beogradit.

Faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ka ndikuar në mos përmbushjen e kuotës përkatëse në shërbimin civil të Kosovës, është edhe refuzimi i shkollimit të lartë të pjesëtarëve të këtij komuniteti në institucionet shkollore e universitare të Kosovës, për dallim nga orientimi i tyre për shkollim në institucionet shkollore në anën veriore të Mitrovicës. Këto institucione shkollore e universitare veprojnë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë dhe për pasojë diplomat e lëshuara nga këto institucione janë jo valide dhe të papranuara nga institucionet publike të Kosovës.

⁷⁰ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike në Kosovë, maj 2013, faqe 9

Për dallim prej institucioneve të tjera, agjencitë e pavarura dhe komunat janë mesatarisht në një shkallë më të lartë sa i përket përfaqësimit të komuniteteve pakicë. Agjencitë e pavarura arrijnë shkallën prej 8.9% të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të punësuar, ndërsa, komunat arrijnë shkallën prej 8.8% të të punësuarve në to.⁷¹ Kur flasim për ndërmarrjet publike ato arrijnë shkallën më të ulët të të punësuarve nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë në këto institucione me vetëm 2.2%.⁷² nga numri i përgjithshëm i të punësuarve.

Institucionet qeveritare (ministritë dhe institucionet tjera përfaqësuese) dhe agjencionet ekzekutive, kanë një shkallë relativisht më të ulët të përfaqësimit të komuniteteve pakicë. Institucionet qeveritare arrijnë një shkallë prej 6.6% të të punësuarve, ndërsa agjencionet ekzekutive arrijnë një shkallë të përfaqësimit të komuniteteve pakicë prej 6.2% të të punësuarve.⁷³

Sa i përket mbajtjes së vendeve sipas kategorizimeve të tyre në shërbimin civil, pjesëtarët e komuniteteve pakicë, mbajnë pozita të mira profesionale dhe administrative dhe mund të konsiderohet se janë të përfaqësuar mirë në këtë drejtim, ndërkaq, diçka më e dobët është niveli i përfaqësimit në pozitat menaxheriale. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë të cilët janë të punësuar në shërbimin civil dhe të cilët kryesisht mbajnë pozita tekniko administrative janë pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe goran, pikërisht për shkak të niveleve të ulëta të arsimimit të tyre.

⁷¹ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo- shumicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike në Kosovë, maj 2013, faqe 9

⁷² Po aty

⁷³ Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo- shumicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike në Kosovë, maj 2013, faqe 9

U theksua edhe më lartë se Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa aktive në arritjen e përmirësimit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Republika e Kosovës ka një kornizë ligjore të sofistikuar dhe shumë të mire për sa i përket, punësimit dhe përfaqësimit proporcional të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës. Këtë fushë ajo e ka të rregulluar edhe me aktin më të lartë juridik të vendit siç është Kushtetuta e Kosovës, e cila përcakton me saktësi përfaqësimin e komuniteteve në institucionet publike dhe ndërmarrjet publike.⁷⁴ Ajo thekson pos tjerash se komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë në përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike.

Për më tepër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton rregulla bazike të shërbimit civil të shtetit. Siç është thënë edhe më sipër, shërbimi civil përbën një mekanizëm profesional, neutral ndaj politikës, civil dhe meritore, i përhershëm, i cili nga aspekti institucional është në kuadër të Qeverisë dhe i cili shërbim ushtron në mënyrë profesionale dhe të përhershme funksionin e zbatimit të veprimtarisë administrative. Në këtë aspekt, është trajtuar edhe përbërja e shërbimit civil të Kosovës, e cila strukturë duhet të pasqyrojë shumë etnicitetin e popullatës, duke marrë për bazë, pra parimet e barazisë gjinore dhe standardet e tjera të njohura ndërkombëtarisht.

Në këtë sens, me Kushtetutë vendoset që komunitetet pakicë në Kosovë, duhet të kenë të drejtë të pjesëmarrjes në shërbimin civil të Kosovës në bazë të kuotave proporcionale, sipas pozitës së secilit komunitet në tërësinë e popullatës, gjë që do të garantojë që

⁷⁴ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 61, 2008

pjesëmarrja shumetnike në këtë shërbim do të rezultojë me zbatimin praktik të shumë etnicitetit në strukturën e administratës shtetërore.

Në frymën e Kushtetutës janë aprovuar më vonë edhe shumë ligje të tjera, të cilat me dispozitat e tyre merren me mbrojtjen dhe përfaqësimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Kosovë. Një ndër ato ligj është edhe ai i Shërbimit Civil⁷⁵ si një ligj special i cili përkufizon dhe përcakton statusin e nëpunëseve civilë si punonjës të ministrive, agjencive ekzekutive, institucioneve të tjera përfaqësuese (si administratën e zyrës së presidencës, zyrës së kryeministrit dhe kuvendeve komunale), agjencive të pavarura rregullative si dhe administratën e komunave.⁷⁶

Gjithashtu krahas këtyre shërbyeseve civilë, ekzistojnë edhe një numër i punonjësve shtetërorë të cilët punojnë në administratën shtetërore të cilët me Rregulloren e UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil⁷⁷ trajtoheshin si shërbyes civilë, ndërsa pas vitit 2010 me futjen në fuqi të Ligjit të ri për Shërbimin Civil të Kosovës, këta nëpunës shtetërorë nuk janë përfshirë në fushëveprimin e këtij ligji, për arsye se këta nuk konsiderohen më shërbyes civilë, por thjeshtë janë shërbyes publik. Aty bëjnë pjesë: punonjësit e institucioneve arsimore dhe shëndetësore, policore, zyrtarë të doganave dhe zyrtarë korrektues, pjesëtarë të sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik si dhe stafi i punësuar në të, ndërkaq, që statusi i tyre është rregulluar me Ligjin e Punës.

Pra, siç u theksua edhe më lartë, me anë të këtij ligji është përcaktuar që 10% e pozitave të nivelit qendror të jenë të rezervuara për personat që u përkasin komuniteteve që janë pakicë

⁷⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, 2010

⁷⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni 1, 2010

⁷⁷ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, 2001

në Kosovë, të cilët përmbushin kriteret specifike të punësimit, ndërsa në nivelin komunal përfaqësimi i këtyre komuniteteve të jetë proporcional me përbërjen demografike të komunës përkatëse.⁷⁸

Institucioni më i lartë shtetëror i cili merret me hartimin e akteve të ndryshme ligjore që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në shërbimin civil të Kosovës është Ministria e Administratës Publike (MAP) e cila krahas hartimit të rregullave të përgjithshme për shërbimin civil, përkujdeset që me anë të ligjeve dhe rregulloreve të vendit të sigurojë edhe kuotat e përfaqësimit për pjesëtarët e komunitetit pakicë, në pozitë të shërbimit civil. Kështu kjo ministri, pas gjashtë muaj të nxjerrjes së ligjit për shërbim civil nxori edhe rregulloren lidhur me procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve pakicë në shërbimin civil⁷⁹ me anë të së cilës obligon që institucionet publike të vendit si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal të aplikojnë, dizajnojnë dhe zbatojnë programe të veprimit pozitiv për të arritur përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve pakicë në Kosovë.

Pra, me nxjerrjen e kësaj rregulloreje, institucionet e vendit ju kanë bërë një tretman të veçantë komuniteteve pakicë që dëshirojnë të punësohen në shërbimin civil të Kosovës. Krahas miratimit të ligjeve dhe akteve të tjera juridike të cilat i rregullojnë çështjet e shërbimit civil, tani më ekziston edhe kjo rregullore e cila ekskluzivisht merret me arritjen e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në shërbimin civil të Kosovës.

⁷⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni 11, 2010

⁷⁹ Ministria e Administratës Publike, Rregullorja Nr. 04/2010 për Procedurat e Përfaqësimit të Drejtë dhe Proporcional të Komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 4, shtator 2010

Nëse i referohemi Raportit⁸⁰ të vitit 2014 të publikuar nga ana e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike dhe i cili është përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për një shërbim civil profesional, të paanshëm dhe përgjegjës, do vërejmë se përfaqësimi i komuniteteve pakicë në shërbimin civil, duke marrë si kriter përkatësinë etnike të tyre rezulton se në nivelin qendror të shërbimit civil janë të punësuar (26,395) shqiptarë apo 91.28%; pastaj (1,438) serbë apo 4.97%; (385) boshnjakë apo 1.33%; (343) turq apo 1.19%; (69)goranë apo 0.24%; (27) ashkali apo 0.09%; (20) egjiptian apo 0.07%; (45) romë apo 0.16%; dhe gjithsej të tjerë (193) ose 0.67%.

Tab 4: Numri i të punësuarve në nivelin qendror të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve

<i>Emërtimi</i>	<i>Numri i të punësuarve</i>	<i>Përqindja (%)</i>
Shqiptarë	26,395	91.28
Serbë	1,438	4.97
Boshnjakë	385	1.33
Turq	343	1.19
Goranë	69	0.24
Ashkali	27	0.09
Egjiptianë	20	0.07
Romë	45	0.16
Të tjerë	193	0.67
Gjithsej:	28,915	100

Burimi: MAP, DASHC: Struktura gjinore dhe etnike e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës (2014)

⁸⁰ Ministria e Administratës Publike, Departamenti I Administrimit të Shërbimit Civil: Raport sipas Strukturës Gjinore dhe Etnike të të Punësuarave në Shërbimin Civil , 2014

Ndërkaq, sipas të njëjtit raport, në nivelin lokal numri i të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës sipas përfaqësimit duke marrë për bazë kriterin e përkatësisë etnike është si në vijim: (36,839) shqiptarë ose 88.96%; (1,633) serbë ose 3.94%; (760) boshnjakë ose 1.84%; (342) turq ose 0.83%; (12) goranë ose 0.03%; (95) ashkali ose 0.23%; (22) egjiptian ose 0.05 %; (56) romë ose 0.14%; (86) të tjerë ose 0.21% dhe pjesëtarë, për të cilët nuk ka të dhëna për përkatësinë etnike, janë gjithsejtë (1,566) ose 3.78%.⁸¹

Tab 5: Numri i të punësuarve në nivelin lokal të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve:

<i>Emërtimi</i>	<i>Numri i të punësuarve</i>	<i>Përqindja (%)</i>
Shqiptarë	36.863	88.96
Serbë	1.633	3.94
Boshnjakë	760	1.84
Turq	342	0.83
Goran	12	0.03
Ashkali	95	0.23
Egjiptianë	22	0.05
Romë	56	0.14
Të tjerë	86	0.21
Të tjerë të papërcaktuar	1.566	3.78
Gjithsej:	41.411	100

Burimi: MAP, DASHC: Struktura gjinor edhe etnike e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës (2014)

Pra, sipas të dhënave të prezantuara në raportin e fundit të Ministrisë së Administratës Publike, mbi numrin e të punësuarve në shërbimin civil në nivel shteti (duke përfshirë të dy nivelet qendror dhe lokal) sipas përkatësisë etnike, struktura e të punësuarve duket

⁸¹ Ministria e Administratës Publike, Departamenti I Administrimit të Shërbimit Civil: Raport sipas Strukturës Gjinore dhe Etnike të të punësuarve në Shërbimin Civil , 2014

kështu: shqiptarë (63,234) ose 89.92%; serbë (3,071) ose 4.37%; boshnjakë (1,145) ose 1.63%; turq (685) ose 0,997%; goranë (81) ose 0,12%; ashkali janë (122) ose 0.17%; egjiptian (42) ose 0.06%, romë (101) ose 0.14%; të tjerë (279) ose 0.40 % dhe të papërcaktuar, sipas strukturës etnike janë (1,566) ose 2.23% në nivel të Republikës së Kosovës.

Tab 6: Numri i të punësuarve në nivel vendi të shërbimit civil sipas pjesëmarrjes së komuniteteve:

<i>Emërtimi</i>	<i>Numri i të punësuarve</i>	<i>Përqindja (%)</i>
Shqiptarë	63.234	89.92
Serbë	3.071	4.37
Boshnjakë	1.145	1.63
Turq	685	0.97
Goran	81	0.12
Ashkali	122	0.17
Egjiptianë	42	0.06
Romë	101	0.14
Të tjerë	279	0.40
Të papërcaktuar	1.566	2.23
Gjithsej:	70.326	100

Burimi: MAP, DASHC: Struktura gjinore dhe etnike e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës (2014), Faqe 7

Me qëllim të sigurohet se janë duke u respektuar parimet e përgjithshme dhe rregullat për funksionimin e shërbimit civil të Kosovës, Kushtetuta me dispozitat e veta ka parapare që të themelojë një organ përgjegjës që është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës i cili organ do të reflektojë gjithashtu sipas përbërjes së vet edhe diversitetin e popullit të Kosovës. Në këtë vështrim Kushtetuta e vendos Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në

funksionin e një organi të pavarur, që duhet të garantojë që parimet e meritës, profesionalizmit, paanshmërisë politike të gjejnë shprehje të plotë në punën e shërbimit civil të Kosovës, dhe se vendimet e këtij këshilli të jenë përfundimtare në procedura administrative dhe si të tilla të detyrueshme për ekzekutim nga ana e institucioneve publike në kuadër të shërbimit civil të Kosovës.

4.1.5. Përfaqësimi në Sektorin e Sigurisë

Pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, në vitin 1999 filloi konsolidimi i institucioneve të Kosovës dhe në këtë kuadër edhe konsolidimi i institucioneve të sigurisë në Kosovës. Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë në atë kohë ndërtoi një kornizë ligjore me anë të së cilës parashihte edhe përfaqësimin proporcional të grupeve etnike në këto institucione.

Në këtë kuadër kjo kornizë ligjore më vonë u përfshi edhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit final të Kosovës apo ndryshe i ashtuquajtur Plani i Ahtisarit, i cili gjatë vitit 2008 shërbeu si bazë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Plani i Ahtisarit gjithashtu, shërbeu edhe si një bazament për hartimin e Kushtetutës së Kosovës, e cila sikurse plani gjithëpërfshirës edhe ajo, parashihte përfshirjen e minoriteteve në sektorin publik të sigurisë në Kosovës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pjesëmarrja e minoriteteve ka arritur një nivel relativisht të kënaqshëm, sidomos kur flasim për përfaqësimin e minoritetit serb në këtë sektor, ndërkaq, një gjendje e mirë e përfaqësimit nuk është edhe për pjesëtarët e minoritetit

rom, ashkali dhe egjiptas, të cilët siç u tha edhe më sipër, i atribuohen nivelit të ulët të arsimimit dhe kualifikimit; varfërisë së theksuar dhe kushteve ekstreme në të cilat jetojnë këto komunitete. Megjithatë, çështja e përfaqësimit të minoriteteve në sektorin e sigurisë mbetet ende një çështje sfiduese për institucionet e vendit.

Sektori i sigurisë në Kosovë pavarësisht faktit se ende është në fazën e konsolidimit të tij, rëndësi të veçantë i kushton reformave strukturore, me qëllim të përmbushjes së aspiratave të vendit për integritet euro atlantike. Në këtë kuadër, edhe përfshirja e plotë e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë në sektorin e sigurisë ka qenë dhe ende vazhdon të mbetet sfida për institucionet vendore, po edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Integrimi i plotë i këtyre komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre, paraqet një nga prerogativat për krijimin e një sektori të qëndrueshëm për siguri në Republikën e Kosovës, çka nënkupton se të gjitha komunitetet në Kosovë, duhet të jenë në mënyrë proporcionale të integruara në strukturat e sigurisë.

Në këtë aspekt, korniza ligjore në Kosovë siguron dhe garanton përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve pakicë, në të gjitha institucionet publike, përfshirë këtu edhe sektorin e sigurisë, megjithatë, sa i përket zbatimit të tyre në praktikë, ende kërkohet punë dhe përkushtim i të gjithë atyre që janë përgjegjës për një gjë të tillë.

Pavarësisht përpjekjeve të institucioneve vendore dhe faktorit ndërkombëtar, përfshirja e komuniteteve pakicë në sektorin e sigurisë nuk është vetëm një proces i brendshëm, sepse jo rrallë ky proces është i ndikuar edhe nga faktorë të jashtëm. Kjo gjë është vërejtur sidomos kur bëhet fjalë për integrimin e plotë të komunitetit serb brenda sektorit të

sigurisë në Kosovë. Presionet e ndryshme politike, që i janë bërë komunitetit serb që jeton në Kosovë, nga qarqe të jashtme, sidomos nga autoritetet e Beogradit, kanë ndikuar dukshëm që rezistenca e pjesëtarëve të këtij komuniteti për tu kyçur në institucione publike të Kosovës të rritet vazhdimisht.

Siguria në të gjitha dimensionet e saj është fundamentale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupe etnike minoritare në Kosovë. Aspirata e Kosovës për integritet evropian ka qar drejt reformave të përgjithshme institucionale, prandaj, tek reformimi i sektorit të sigurisë, ndër të tjera, ka pasur për fokus të veçantë edhe integrimin e grupeve etnike, minoritare në sektorin e sigurisë.⁸²

Korniza ligjore e Kosovës përkufizon dy lloje të mbikëqyrjes demokratike, d.m.th. mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjen e jashtme. Kontrolli i brendshëm kryhet nga vetë institucionet përmes auditorëve, inspektorëve, apo hetuesve të brendshëm. Mbikëqyrja e jashtme i referohet mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë nga institucione të tilla si: parlamenti, institucionet e pavarura shtetërore, gjyqësori dhe shoqëria civile. Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë është e rregulluar kryesisht nëpërmjet dy komisioneve parlamentare: Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri dhe Mbikëqyrja e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

⁸² Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, mars 2014, faqe 8.

Sipas Planit të Ahtisarit, prania e BE-së është paraparë me themelimin e Misionit të Sundimit të Ligjit dhe mbulon fushën e sundimit të ligjit, me fokus në gjyqësor, polici, kontroll të kufijve, dogana dhe shërbime korrektuese. Kosova i ka dy lloje të institucioneve të sigurisë, që drejtpërdrejt janë përgjegjëse për sundimin e ligjit dhe sigurisë: strukturat vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë. Praktikisht, mandati i tyre rregullohet me dy lloje të aranzhimeve formale, kryesisht në kuadër të së drejtës ndërkombëtare dhe kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës dhe kjo është diçka që e bën Kosovën të dallohet nga vendet e rajonit.⁸³

Përfaqësimi i komuniteteve në sektorin e sigurisë në Kosovë është rregulluar edhe me Kushtetutën e Kosovës, e cila përmban një kapitull të veçantë lidhur me këtë institucion.⁸⁴

Kjo Kushtetutë si dhe aktet tjera juridike të cilat janë derivat i saj, garanton barazi në mes të të gjitha grupe etnike minoritare që jetojnë në Kosovë, si dhe promovon të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e saj, duke përfshirë këtu edhe ata që janë të uniformuar. Kushtetuta e përcakton Kosovën si një shtet shumë etnik dhe në këtë kuadër edhe aktet tjera nënligjore të saj, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë njerëzore, kanë paraparë përfaqësimin e drejtë, proporcional, institucional të komuniteteve dhe se kjo kornizë ligjore është në përputhje të plotë me të gjitha praktikatat më të mira ndërkombëtare sa i përket, pra, çështjes së përfaqësimit.

Përveç Kushtetutës së Kosovës si akti më i lartë juridik i vendit, ekzistojnë edhe akte të tjera të veçanta apo akte të rëndësishme ligjore të cilat rrjedhin nga Kushtetuta për sektorin e sigurisë të cilat merren me komunitetet në Kosovë dhe përfaqësimin e tyre në

⁸³ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Friedrich Ebert Stiftung, Progresi në Evropianizimin e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, nëntor 2013

⁸⁴ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 126 dhe 127, 2008

institucionet e saj. Të tilla janë: Ligji për Policinë, i cili pos tjerash vë në pah se përbërja etnike e zyrtarëve policor në kuadër të komunës, njësitë komunale të caktuara, për aq sa është e mundur, duhet të pasqyrojnë përbërjen etnike të popullsisë brenda territorit të asaj komune. Po ashtu edhe Ligji për Inspektoratin Policor⁸⁵, Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës⁸⁶ dhe Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës⁸⁷ janë ligje të aprovuara menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe që i përkasin sektorit të sigurisë në Kosovë, ndërkaq, më vonë, në të njëjtin vit është aprovuar edhe Ligji për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë,⁸⁸ si institucion përgjegjës për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë informata në mënyrë të shpejtë dhe të përgjegjshme.

Gjithashtu, përveç ligjeve të veçanta të cilat merren me avancimin e përfaqësimit të komuniteteve në sektorin e sigurisë, ekzistojnë edhe dispozita të ligjeve të tjera të cilat merren me këtë problematikë, siç është Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, i cili ka paraparë krijimin e njësive komunale me kompetenca të zgjeruara në ato rajone ku komuniteti pakicë në nivel lokal përbën shumicën. Në raste të tilla, ky ligj garanton se në komunat në të cilat komuniteti serb, ose cilido komunitet tjetër pakicë përbën shumicën në nivel lokal, përfaqësuesit e tyre të zgjedhur do të mund t'i ushtrojnë të drejtat e zgjeruara sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje për emërimin e komandantëve të stacioneve lokale të policisë në përputhje me Ligjin e Policisë⁸⁹

⁸⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor, 2008

⁸⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-45 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, 2008

⁸⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës

⁸⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-063 për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë, 2008

⁸⁹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 23, 2008

Legjislacioni për përfaqësimin e pakicave në Policinë e Kosovës- Policia e Kosovës është themeluar në vitin 1999 dhe deri në vitin 2008 ky institucion ka vepruar nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe nën autoritetin e misionit të UNMIK-ut dhe OSBE-së në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ky organ ka funksionuar me emrin Shërbimi Policor i Kosovës, dhe sa i përket zhvillimit dhe funksionalitetet të tij, Kuvendi i Kosovës apo edhe shoqëria civile ka pasur fare pak qasje.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe miratimin e Ligjit për Policinë në vitin 2008, Policia e Kosovës zgjeroi fushëveprimin duke krijuar struktura të reja si një agjencion i mirëfilltë për zbatimin e ligjit, nën mbikëqyrjen dhe autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Për herë të parë, përgjatë kësaj periudhe të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, Ligji për Policinë bëri dallimin mes personelit në uniforma dhe punonjësve civilë. Për më tepër, pikë kthyesë në tërë strukturën e Policisë së Kosovës konsiderohet zëvendësimi i postit të Komandantit të Policisë me atë të Drejtorit të Policisë, i cili është zyrtar i Republikës së Kosovës i pa uniformuar.⁹⁰

Po ashtu, Ligji për Policinë i kushton kujdes të duhur të drejtave të policëve dhe me këtë synon që të arrijë standardet përkatëse evropiane në këtë drejtim. Megjithatë, me qëllim të ndryshimit të rolit dhe funksionalitetit të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), i cili mbikëqyrë dhe monitoron zhvillimin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Ligji për Policinë u ndryshua me Ligjin e ri për Policinë, i cili hyri në fuqi në vitin 2011.

⁹⁰ Abit Hoxha (KCSS). Pesë vite të sektorit të sigurisë në Kosovë - Analizë kontekstuale 2008-2013, Prishtinë, 2013.

Kur flasim për përfshirjen e komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre që jetojnë në Kosovë, në kuadër të Policisë së Kosovës, nuk mund të anashkalojmë faktin se kjo çështje fillimisht është trajtuar me dispozitat⁹¹ e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat dispozita përcaktojnë organizimin dhe funksionimin e Policisë së Kosovës, duke vënë në pah se Policia e Kosovës është institucioni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Kosovës dhe se ajo duhet të pasqyrojë shumetnike të popullatës që jeton në Republikën e Kosovës, gjë që nënkupton se duhet kihet parasysh, parimi për përfaqësimin proporcional të komuniteteve etnike në këtë institucion.

Po ashtu, me Ligjin mbi Policinë, kur flitet për stacionet lokale të policisë, është përcaktuar se përbërja etnike e zyrtarëve policorë të caktuar në kuadër të komunave të caktuara, brenda mundësive të pasqyrojë përbërjen shumetnike brenda komunës përkatëse”.⁹² Gjithashtu, po me anë të këtij ligji, është përcaktuar që komandantët e stacioneve policore dhe nën stacioneve policore në komunat ku komuniteti më i madh është serb, zgjidhen apo miratohen nga Ministria e Punëve të Brendshme me Propozim të Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm.⁹³

Kur është fjala për përfaqësimin e minoriteteve në Policinë e Kosovës, tashmë lidhur me këtë temë ekziston garanci edhe me Marrëveshjen e Brukselit,⁹⁴ të datës 19 prill 2013 e lidhur në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku definohet shumë qartë përbërja e Policisë se

⁹¹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 128, 2008

⁹² Kuvendi i Kosovës Ligji 03/L-076 mbi Policinë , neni 35, 2008

⁹³ Kuvendi i Kosovës, Ligji 03/L-076 mbi Policinë neni 41 dhe 42, 2008

⁹⁴ Marrëveshja e Brukselit e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013, Bruksel

Kosovës, sidomos në pjesën veriore të saj. Këtë çështje, marrëveshja e Brukselit me detajisht e trajton në pikat 7-9, me ç'rast përcaktohen elementet që kanë të bëjnë me strukturat e policisë në atë pjesë. Decidivisht kjo marrëveshje në mënyrë të qartë thekson se strukturat paralele të cilat ndodhen në pjesën veriore të Kosovës duhet të integrohen në struktura kosovare të sigurisë, përfshirë këtu edhe strukturat policore, si dhe duke rikujtuar faktin se Policia e Kosovës duhet të jetë e vetmja forcë policore e cila duhet të operojë në tërë territorin e Kosovës. Megjithatë, bisedimet e nivelit të lartë mes Kosovës dhe Serbisë së paku deri më tani, nuk kanë dhënë efektin e duhur që do të ndikojë tek serbët e Kosovës, për tu integruar në këto forca të sigurisë në të ardhmen.

Për të arritur një integrim edhe më të plotë të komunitetit serb në pjesën veriore të Kosovës një pikë e veçantë e kësaj marrëveshje, i është rezervuar edhe pozitës për Komandantin Rajonal të Policisë në katër komunat e veriut me shumicë serbe.⁹⁵ Ky komandant rajonal parashihet të jetë nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit serb dhe do të zgjidhet nga Ministri i Punëve të Brendshme, pas propozimeve të bëra nga kryetarët e të katër komunave veriore në emër të asociacionit. Me anë të kësaj marrëveshje po ashtu, parashihet të propozohet edhe një tjetër komandat rajonal për komunat e pjesës veriore të Kosovës për komunat e Mitrovicës Jugore, Vushtrrisë dhe Skenderajt.

Policia e Kosovës, e cila vepron nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme përbëhet prej (7,527) zyrtarëve policorë dhe (1,143) të punësuarve nga stafi civil.⁹⁶ Policia e Kosovës që nga themelimi i saj në vazhdimësi është përpjekur që të arrijë përfaqësimin e

⁹⁵ Marrëveshja e Brukselit e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013, Bruksel, pika 9

⁹⁶ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, mars 2014, faqe 12.

komuniteteve sipas kuotave të përcaktuara me ligj. Deri më tani konsiderohet se është kryesuese apo të themi, e para e cila prinë në raport me institucionet tjera të sigurisë në përfaqësimin e minoriteteve, veçanërisht një gjendje të mire të tillë të përfaqësimit e ka arritur me pjesëtarët e komunitetit serb.

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, ky institucion ka një performancë, përgjithësisht të mirë kur është fjala për zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfshirjen e minoriteteve etnike brenda këtij institucioni.

Pra, sipas këtyre statistikave në fund të vitit 2013, vetëm rreth 84.22% të stafit të Policisë së Kosovës ka qenë shqiptarë, ndërsa 11.49% ishin serbë si dhe rreth 5% kanë qenë pjesëtarë të grupeve tjera etnike.⁹⁷

Tab 7: Struktura etnike brenda Policisë së Kosovës (stafi i uniformuar dhe civil):

Statistikat në bazë etnike	Totali	Totali në përqindje (%)
Shqiptarë	7.302	84.22%
Serbë	996	11.49%
Boshnjakë	205	2.36%
Turk	73	0.84%
Romë	15	0.17%
Egjiptian	7	0.08%
Ashkali	20	0.23%
Goranë	40	0.46%
Të tjerë	12	0.15%
Total	8.670	99.87%

Burimi: Kosovar Center for Security Studies, Minoritete në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e pas Pavarësisë, mars 2014

⁹⁷ Po aty

Tab 8: Struktura Etnike brenda Policisë së Kosovës(stafi i uniformuar, pa përfshirë stafin civil)

Statistikat në bazë etnike(i uniformuar)	Totali	Totali në përqindje (%)
Shqiptarë	6.280	83.43%
Serbë	904	12.01%
Boshnjakë	191	2.53%
Turk	67	0.89%
Romë	14	0.18%
Egjiptian	7	0.09%
Ashkali	19	0.25%
Goran	36	0.47%
Të tjerë	9	0.11%
Total	7.527	100%

Burimi: Kosovar Center for Security Studies, Minoritete në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e pas Pavarësisë, mars 2014

Pavarësisht faktit, se deri me sot janë arritur rezultate solide në përfaqësimin e komuniteteve pakicë në këtë institucion, është fare e kuptueshme se një proces i tillë nuk ka kaluar pa sfida dhe vështirësi të mëdha, për shkak të ndërhyrjeve dhe presioneve të ndryshme politike të bëra nga ana e zyrtarëve politikë të Beogradit ndaj përfaqësuesve të këtyre komuniteteve pakicë veçanërisht të pjesëtarëve të komunitetit serb. Si rezultat i një presioni të këtillë, erdhi deri tek bojkotimi nga ana e një numri të konsiderueshëm të zyrtarëve policorë të vendeve të tyre të punës si reagim ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

Megjithëkëtë, Qeveria e Republikës së Kosovës në koordinim me EULEX-in u mobilizuan për kthimin në pozita të mëhershme të pjesëtarëve të komunitetit serb, brenda një periudhe kohore jo më larg se deri në qershor të vitit 2009. Këto përpjekje kishin reflektuar me

rezultate pozitive, pasi që shumica e zyrtarëve policorë serbë u kthyen me të kuptuar se ata do të mund të humbasin vendet e punës së tyre dhe se Serbia nuk mund t'i mbështesë edhe më tutje financiarisht.⁹⁸

Për dallim nga pjesa jugore e Kosovës në të cilën përfaqësimi i komuniteteve e sidomos përfaqësimi i komunitetit serb në Policinë e Kosovës ishte për tu admiruar, përfshirja ose përfaqësimi i komunitetit serb në institucionet publike të Kosovës, e në këtë kuadër në Policinë e Kosovës të pjesës veriore të vendit, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mbeti një sfidë e pakalueshme përgjatë gjithë kohës deri në arritjen e Marrëveshjes së Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në prill të vitit 2013, sfidë për të cilën nuk mund të thuhet se është tejkaluar ende në tërësi, sepse ende ka probleme kur bëhet fjalë për pjesën veriore në drejtim të integritetit të atyre pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në institucionet publike të Kosovës.

Periudha nga viti 2008 deri në vitin 2013, sa i përket sektorit të sigurisë, gjegjësisht sa i përket funksionalitetit të Policisë së Kosovës, karakterizohet me ekzistimin e strukturave paralele në veri të vendit, të cilat struktura raportonin direkt tek autoritetet e Beogradit. Ekzistojnë disa raste, kur zyrtarët policorë të cilët vepronin në veri të vendit me ndërmjetësimin e EULEX-it i kanë raportuar zingjirit komandues në Prishtinë. Për të shmangur këtë sistem paralel i cili funksiononte në veri të vendit, Marrëveshja e parë e Brukselit kishte paraparë integrimin gradual të ish strukturave të MUP-it serb në strukturat

⁹⁸ Grupi Ndërkombëtar i Krizave (Grupi i Krizave) është organizatë e pavarur, jo profitabile dhe joqeveritare, me rreth 145 të punësuar në pesë kontinente, të cilët përmes analizave të gjendjes në terren dhe avokimit në nivelit të lartë punojnë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve të përgjakshme, Raporti Evropian, 2009

policore të Kosovës dhe stacionet policore që kanë vepruar në pjesën veriore tani janë mbyll dhe financimi për këto struktura nga Serbia tani është ndaluar.

Përderisa, përgjatë këtyre viteve vëmendje e madhe i është kushtuar integritetit të komunitetit serb në Policinë e Kosovës, përfshirja e komuniteteve të tjera në këtë institucion, sidomos e pjesëtarëve të komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali si dhe qasja e tyre në institucionet e sigurisë së vendit, mbetet mjaft shqetësuese. Faktori vendimtar i një gjendje të tillë, siç është thënë edhe më herët kur është trajtuar përfaqësimi i këtyre komuniteteve pakicë në institucione publike të vendit, është pikërisht, niveli i ulët i arsimimit të tyre dhe mungesa e shkathhtësive profesionale e kualifikuese. Një tjetër faktor i cili mendohet se ka ndikuar në një përfaqësim shumë të ulët të këtyre komuniteteve pakicë, është edhe mungesa e burimeve të informacionit, kryesisht për shkak të mungesës së gazetave lokale dhe mediave elektronike ose burimeve tjera në gjuhën e tyre amtare.

Legjislacioni për mbrojtjen dhe përfaqësimin e pakicave në FSK- Republika e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së saj themeloi Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK) së bashku me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK). Megjithatë, baza ligjore për krijimin e këtyre dy institucioneve ishte vendos në mënyrë shumë të qartë qysh me Planin e Ahtisarit, që më vonë u inkorporua edhe në Kushtetutë, ligje dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me këtë çështje. Dispozitat kushtetuese që lidhen me Forcën e Sigurisë së Kosovës,

përcaktojnë qartë se FSK-ja duhet të jetë një forcë profesioniste, e cila pasqyron diversitet etnike të popullit të Kosovës dhe e cila përbëhet nga shtetasit e saj.⁹⁹

Pra, siç shihet Kushtetuta e njeh këtë institucion si organizatë ushtarake profesioniste, e përbërë nga individë që ushtrojnë aktivitetin e tyre të përditshëm profesional, gjegjësisht që ushtrojnë funksionin e ushtarit në mënyrë të përhershme dhe pa shkëputje. Po ashtu, Kushtetuta përcakton se përbërja etnike e kësaj force të sigurisë duhet të jetë proporcionale, në atë formë që të reflektojë përbërjen etnike të popullit të Kosovës dhe së fundi, se ajo forcë duhet të përbëhet vetëm nga shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët gëzojnë të drejtat dhe obligimet sipas ligjeve të Kosovës.

Gjithashtu, përveç Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2008 miratoi edhe Ligjin për FSK-në,¹⁰⁰ i cili e definon si forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë pavarësisht përkatësisë etnike dhe fetare. Përfaqësimi i minoriteteve në FSK është e rregulluar edhe me Ligjin për Shërbimin e FSK-së, sipas të cilit çdo anëtarë i kësaj force, duhet të trajtohet në mënyrë të drejtë pa asnjë diskriminim në baza etnike apo edhe gjinore.¹⁰¹ Duke u nisur nga fakti se në dispozitat e këtij ligji është përcaktuar përfaqësimi etnik brenda forcës, po ashtu, është paraparë edhe përdorimi zyrtarë i të dy gjuhëve zyrtare që përdorën në institucionet e Kosovës; asaj shqipe dhe serbe, ndërkaq në komunikimet me organizata ndërkombëtare mund të përdorët edhe gjuha angleze.¹⁰² Në bazë të këtij ligji, si dhe strategjisë së burimeve njerëzore si dhe politikave të rekrutimit në

⁹⁹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 126/pika 2 dhe 4, 2008

¹⁰⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-046 për Forcat e Sigurisë, qershor 2008

¹⁰¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-082 mbi Shërbimin në FSK, neni 3, qershor 2008

¹⁰² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-046 për Shërbimin në FSK neni 9, qershor 2008

këtë forcë një kuotë prej 10% është plotësuar nga minoritetet etnike që jetojnë në Kosovë.

103

Kur flasim për forcat e sigurisë së Kosovës nuk mund të lëmë pa përmendur edhe Ligjin mbi themelimin e MFSK-së si organ qeverisës, i cili parashihet të përbëhet nga gjithsejtë 106 shërbyes civilë dhe 63 pjesëtarë të FSK-së.

Sipas statistikave në formë tabelare shihet se përfaqësimi i minoriteteve në kuadër të FSK-së është më i ulët krahasuar me përfaqësimin në Policinë e Kosovës. Sipas të dhënave që disponon FSK deri në vitin 2013, përfaqësimi i komunitetit serb ka arritur deri 1,83% të personelit të punësuar në nivel të përgjithshëm dhe të uniformuar. Mos arritja e përfaqësimit të komunitetit serb në nivel më të lartë në këtë institucion, ka qenë e varur kryesisht nga faktorët politikë të cilët kanë ndikuar edhe në uljen e motivimit të këtij komuniteti për të ju bashkangjitur forcës së sigurisë së Kosovës.

Ndërkaq, një përfaqësim më i mirë se sa komuniteti serb, vërehet tek komunitet e tjera si ai turk i cili arrin deri në shkallën prej 2.40% dhe ai boshnjak me 2.14% etj. Pra siç shihet edhe nga tabela e dhënë më poshtë komuniteti turk dhe boshnjak janë në një shkallë më të lartë të përfaqësimit se sa komuniteti serb, i cili është edhe komuniteti më i madh në numër në gjithë hapësirën kosovare.

¹⁰³ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, mars 2014 faqe 11

Gjithashtu, një përfaqësim të mirë në këtë institucion e kanë edhe pjesëtarët e komunitetit ashkali. Mund ta quajmë përfaqësim deri diku të mirë duke i pas parasysh rrethanat socio-ekonomike dhe të kualifikimeve profesionale që disponon ky komunitet.¹⁰⁴

Tab 9: Struktura Etnike brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës:

Statistikat në bazë etnike	Totali	Totali në përqindje (%)
Shqiptarë	2.091	91.15%
Serbë	42	1.83%
Turk	55	2.40%
Boshnjakë	49	2.14%
Ashkali	29	1.26%
Egjiptian	19	0.83%
Romë	3	0.13%
Goranë	2	0.09%
Të tjerë	3	0.26%
Total	2.290	99.83%

Burimi: Kosovar Center for Security Studies, Minoritete në sektorin e Sigurisë në Kosovën e pas Pavarësisë, mars 2014

Pra, siç u theksua edhe më lartë arsyeja e një numri kaq të vogël të përfaqësimit të komunitetit serb, është për faktin se ky komunitet që nga momenti i formimit të forcave të sigurisë ka pasur një qasje negative ndaj kësaj force, për arsye se ajo ka qenë derivat i dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës UÇK, e cila gjatë luftës së fundit në Kosovë në vitet 1998-1999 luftoi kundër forcave ushtarake dhe paramilitare serbe dhe se shumica e anëtarëve të UÇK u rekrutuan në Trupat Mbrojtëse të Kosovës TMK. Komuniteti serb i

¹⁰⁴ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, mars 2014

Kosovës i ndodhur para një presioni politik të ushtruar nga qarqet e Beogradit si dhe grupet radikale brenda Kosovës ka ndikuar në ngecjen e përfshirjen e këtij komuniteti në FSK.

Pra, siç është vërejtur deri më tani për pjesëtarët e komunitetit serb, FSK-ja ka qenë ngushtësisht e lidhur me statusin e Kosovës, prandaj edhe interesimi për të ju bashkëngjitur kësaj force ka qenë shumë i vogël. Megjithatë, fal sukseseve të FSK-se dhe fushatave të ndryshme të bëra nga institucionet e vendit, kryesisht në rajonet e banuara me minoritet serbe, ka sjellë deri diku një rezultat pozitiv në rritjen gjithnjë më të madhe të përfaqësimit të komunitetit serb, edhe përkundër presioneve nga qarqet radikale serbe dhe zyrtarëve të Beogradit, të cilat vazhdojnë pa ndërprerë edhe sot e kësaj dite të vendosin barriera në këtë drejtim.

4.1.6. Përfaqësimi në Agjencionet e Pavarura

Agjencionet e pavarura natyrisht pasqyrojnë një ndër elementet kryesore të funksionimit të demokracisë brenda një shteti. Prandaj, sikurse edhe pushteti ekzekutiv ashtu edhe organet e pavarura për punën e vet i përgjigjen Kuvendit të Kosovës, i cili njëherit është organ mbikëqyrës i tyre. Në këtë aspekt, themi se organet e pavarura, të cila funksionojnë në Kosovë, mund të kategorizohen në dy grupe: organet e pavarura të cilat kanë karakter mbikëqyrës ndaj disa institucioneve të Qeverisë sa i përket standardeve të qeverisjes së mirë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut e që janë: Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë, dhe Agjencionet e Pavarura apo rregullatorët me funksione rregullatorë, licencuese etj. siç

janë: Komisioni për Miniera dhe Minerale, Komisioni për Media, Zyra e Rregullatorit të Energjisë etj.

Nëse merren parasysh standardet ndërkombëtare, kur bëhet fjalë për agjencione të pavarura, atëherë themi se kriteret themelore të nevojshme për funksionimin e lirë dhe efektiv të këtyre organeve janë: pavarësia financiare, pavarësia në rekrutim të burimeve njerëzore si dhe pavarësia nga mosndërhyrjet politike.

Në Kosovë tani për tani funksionojnë rreth tridhjetë 30 institucione apo agjencione të pavarura të cilat për punën e vet i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Ato kryejnë punë të ndryshme që përfshijnë mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe këshillimin për qeverisje të mirë dhe për mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe rregullimin e standardeve profesionale në institucione të ndryshme. Në këtë aspekt, këto organe duhet të gëzojnë shkallë të lartë të pavarësisë dhe njëkohësisht të mbesin llogaridhënëse para publikut, të raportojnë rregullisht dhe të inspektohen nga Kuvendi i Kosovës si dhe të jenë transparente gjatë punës së tyre.

Ani pse në shumicën e institucioneve të pavarura, të themeluara me ligj nuk përmbahen dispozita mbi obligimet e atyre institucioneve për të siguruar pjesëmarrje të komuniteteve pakicë, prapëseprapë ka institucione të pavarura që me ligj e kanë paraparë me dispozita çështjen e përfaqësimit:

Avokati i Popullit: Autoriteti i këtij institucioni të pavarur në Kosovë është paraparë fillimisht me dispozitat e Kushtetutës,¹⁰⁵ kurse puna e këtij institucioni më pastaj është rregulluar me Ligjin për Avokatin e Popullit¹⁰⁶. Pavarësisht faktit, se ky institucion nuk ka fuqi ekzekutive, secili institucion publik në Kosovë është i obliguar me ligj që t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës të vëzhgojë, mbrojë dhe ruajë të drejtat dhe liritë e individëve.

Sa i përket përfaqësimit, me dispozita ligjore,¹⁰⁷ është përcaktuar se gjatë përzgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, duhet marrë për bazë dhe duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor, e që propozimin e Avokatit të Popullit e bënë Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili gjithashtu pasqyron përbërjen politike, etnike e gjinore të Kuvendit, në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, me dispozita ligjore është përcaktuar në mënyrë eksplicite se të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i komunitetit serb në Kosovë dhe së paku njëri duhet të jetë prej komuniteteve tjera pakicë në Kosovë.

Institucioni i Avokatit të Popullit është themeluar në vitin 2000 si një organ i pavarur, i cili ka për qëllim të shqyrtojë çdo shkelje eventuale e të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve publike. Pra, roli më i rëndësishëm i tij është të mbikëqyrë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e individit nga veprimet e paligjshme dhe abuzive të organeve publike. Për

¹⁰⁵ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132-135, 2008

¹⁰⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, gusht, 2010

¹⁰⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 8, gusht, 2010

punën e tij, ai i jep raport Kuvendit të Republikës së Kosovës, por ka të drejtë të japë rekomandime dhe të propozojë masa atëherë kur konstaton ndonjë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve shtetërore si dhe në disa raste ta filloj procedurën në Gjykatën Kushtetuese (neni 135 paragraf 4 i Kushtetutës së Kosovës) .

Zyra e Avokatit të Popullit është një institucion i pavarur nga organet e administratës publike dhe gjyqësore që financohet nga buxheti i shtetit. Pra, ky institucion është një mekanizëm shtetëror i cili merret me mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë personave kundër sjelljes jo të duhur të autoriteteve publike, veprimit dhe mosveprimit të tyre të paligjshëm. Detyrat kryesore të tij janë, dhënia e rekomandimeve ose bërja e kërkesave dhe propozimeve me qëllim të vënies në vend të së drejtës së shkelur nga ana e administratës publike.

Ky institucion shtetëror udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Ai i ka pesë zëvendës, ku dy prej tyre duhet të zgjidhen nga radha e komuniteteve pakicë, një prej përfaqësuesve të komunitetit serb dhe tjetri nga radhët e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosove. Ligji i ri i miratuar për Avokatin e Popullit për të arritur një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave themelore të njeriut, është harmonizuar me dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Avokati i Popullit si organ jo gjyqësor- kryesor i cili përveç që merret me shqyrtimin e ankesave për diskriminim, ai është i mandatuar për të bërë edhe menaxhimin e rasteve të natyrës gjinore së bashku me trajtimin e përgjithshëm të diskriminimit si dhe problemet e bashkësive etnike të cilat jetojnë në Kosovë.

Roli i këtij mekanizmi është jo vendimmarrës, pa fuqi ekzekutive dhe është i pavarur në ushtrimin e funksionit të tij. Kjo shihet më së miri gjatë aktivitetit të vet. Ai ka kompetencë të hetojë rastet e ankesave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilat janë të pranuar me kushtetutë, ligje dhe standarde ndërkombëtare, kur organet shtetërore kanë vepruar si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të tyre dhe njëkohësisht të jap rekomandime për raste të tilla.

Pra, siç shihet ky institucion ka të drejtë të veprojë në raste kur bëhet fjalë për keqpërdorime të autoritetit shtetëror. Gjithashtu, ky mekanizëm në raste të caktuara, ka të drejtë të veprojë edhe në procedurë të ndërmjetësimit dhe pajtimit, të cilat veprime i bënë falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallime gjinie race dhe etnie.

Për të arritur një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave të minoriteteve, ashtu siç e parasheh edhe legjislacioni i vendit, institucionet publike të Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë kanë bërë përpjekje që Institucioni i Avokatit të Popullit përveç në kryeqytet të shtrihet edhe në zyrat rajonale si në Gjilan, Pejë, Prizren, Graçanicë dhe Mitrovicë. Gjithashtu, një nën zyrë e këtij institucioni gjendet edhe në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës .

Instituti Gjyqësor i Kosovës - është organi pavarur përgjegjës për trajnimin dhe arsimin e vazhduar juridik të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në Kosovë. Organizimi i këtij institucioni të pavarur është përkufizuar me Ligjin për Themelimin e këtij organi,¹⁰⁸ i cili udhëhiqet nga një bord udhëheqës i përbërë nga trembëdhjetë (13) anëtarë. Me dispozitat e këtij ligji është përcaktuar se nga numri i përgjithshëm i anëtarëve

¹⁰⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, 2006

të këtij bordi udhëheqës, së paku (2) anëtarë duhet t'i takojnë komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës- është institucion i pavarur i paraparë me dispozitat kushtetuese¹⁰⁹ si dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor¹¹⁰ i themeluar me qëllim të sigurojë që gjykatat e Kosovës jone të pavarura, profesionale dhe të paanshme, duke pasqyruar në të njëjtën kohë diversitetin etnik dhe gjinor të shoqërisë kosovare. Edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është i përbërë prej (13) anëtarë, ku me dispozita kushtetuese është siguruar përfaqësimi i komuniteteve pakicë në këtë institucion të pavarur.

Për më tepër, me Kushtetutë është paraparë që nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këtij këshilli, (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar si dhe (2) anëtarë të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.

Komisioni i Pavarur për Media- është po ashtu institucion i pavarur i cili për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe se themelimi i tij është paraparë edhe me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës,¹¹¹ ndërsa mënyra e funksionimit të tij është rregulluar me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave,¹¹² sipas të cilit, ky komision trajtohet si organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e frekuencave transmetuese në

¹⁰⁹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108, 2008

¹¹⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nëntor 2010

¹¹¹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 141, 2008

¹¹² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, prill 2012

Kosovë dhe se bordi i këtij komisioni përbëhet nga (7) anëtarë, ku prej këtij numri së paku (2) anëtarë të Komisionit emërohen nga radhët e komuniteteve pakicë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve- si organ i përhershëm dhe i pavarur që përgatit, udhëheqë dhe verifikon të gjitha procedurat në lidhje me procesin e zgjedhjeve, i cili është paraparë po ashtu me dispozitat e Kushtetutës.¹¹³ Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve në përbërjen e vet ka (11) anëtarëve, prej të cilëve (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb dhe (3) anëtarë të tjerë emërohen nga radhët e deputetëve të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet tjera pakicë jo serbe.

Komisioni për Ndihmë Juridike- si institucion themelor i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera publike dhe pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, funksionon në bazë të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas.¹¹⁴ Është përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë për persona me pozitë të vështirë financiare duke siguruar në këtë mënyrë që secili të ketë qasje të nevojshme në ndihmën juridike. Ky komision është i përbërë prej (9) anëtarëve, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës sipas një listë të propozuar nga ministritë përkatëse, gjykata supreme dhe nga shoqëria civile. Sa i përket çështjes së përfaqësimit të komuniteteve pakicë me ligj i është lënë mundësia që Ministria për Kthim dhe Komunitete duhet t'i propozojë (3) kandidatë nga radhët e komuniteteve pakicë, ku Kuvendi pastaj do ta përzgjedh njërin prej tyre.

¹¹³ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139, 2008

¹¹⁴ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, shkurt t 2012

Radiotelevizioni i Kosovës- është institucion publik i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, dhe i cili për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ky institucion udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe nga Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës,¹¹⁵ i cili bord përbëhet nga (11) anëtarë, përbërja e të cilit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku (2) anëtarë të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe (1) anëtar emërohet nga komunitetet tjera pakicë që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit- është një organ i pavarur, përgjegjës e të cilit janë të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.¹¹⁶ Ky institucion është përgjegjës për administrimin e shitjes, transferit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore i cili udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë prej (5) anëtarëve të cilët zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës dhe në përbërje të tij përfshihet edhe (1) anëtar që i përket komunitetit jo shqiptar gjegjësisht komuniteteve pakicë.

Nga ajo që u shtjellua më lartë, shihet se jo të gjitha institucionet e pavarura të cilat janë të themeluara me ligje të veçanta për punën e tyre i përgjigjen Kuvendit të Kosovës. Institucionet e pavarura si të tilla kanë krijuar një model të njëtrajtshëm sa i përket aspektit të përfaqësimit të komuniteteve pakicë. Përderisa, disa prej këtyre organeve janë të financuara tërësisht nga buxheti i shtetit, ka edhe të tilla që financohen edhe nga tatimet dhe taksat e ndryshme që i vjelin vet. Prandaj, duke pasur parasysh mungesën e pagave të sigurta dhe atyre që janë konkurrencte në tregun e punës në Kosovë, që do të ndikonte në

¹¹⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, prill 2012

¹¹⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, shtator 2011

rekrutim të stafit profesional dhe të kualifikuar, shumica e këtyre institucioneve të pavarura ballafaqohen në vazhdimësi me mungesë të kapaciteteve të afta dhe të përgatitura profesionalisht për t'ju bërë ballë qëllimeve të vetë institucioneve.

4.2. Përfaqësimi i minoriteteve në Pushtetin Gjyqësor

Me anë të Rezolutës 1244 të nxjerrë nga OKB-ja, UNMIK-ut i'u besua një mandat i gjerë i kompetencave duke përfshirë këtu promovimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Ky mision përbëhej nga katër shtylla të udhëhequra nga Zëvendësit e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Rendi dhe Drejtësia ishte shtylla e parë e UNMIK-ut e cila u themelua në vitin 2001, krahas tri shtyllave të tjera dhe kishte për detyrë të ndërtonte kapacitete për sundimin e ligjit duke përfshirë këtu forcat policore, themelimin e gjyqësisë dhe shërbimin korrektues. Rindërtimi i sektorit të drejtësisë ishte një sfidë e madhe në atë kohë, duke pasur parasysh se serbët, që kishin punuar deri në kohën e luftës, ishin larguar bashkë me forcat ushtarake serbe, ndërsa shqiptarët për më tepër se një dekadë, ishin larguar nga objektet e gjyqësorit të Kosovës dhe ishe shumë e vështirë të rikyçeshin përsëri.

Nga periudha e pasluftës e deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës janë bërë shumë reforma në sektorin e drejtësisë; është bërë kalimi i kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët, duke themeluar kështu shumë entitete të rëndësishme gjyqësore si: Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Institutin Gjyqësor etj. Edhe pas shpalljes së pavarësisë kanë ekzistuar iniciativa për reforma substanciale dhe shumë dimensionale, të cilat janë lidhur shumë me sistemin e ndërtimit të gjyqësorit, ku Plani Gjithëpërfshirës i Marti

Ahtisarit ishte boshti kryesor i reformave dhe i cili me vonë u mëshirua në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pra, Kushtetuta e Kosovës dhe të gjitha aktet juridike të nxjerra më vonë duhet të ishin në harmoni me planin gjithëpërfshirës i cili kishte supremaci ndaj të gjitha akteve tjera juridike të cilat duhet të nxirreshin më vonë. Është me rëndësi të theksohet se një pjesë e kompetencave me elemente shtetformuese edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kanë vazhduar edhe për një kohë të mbesin në duar të institucioneve ndërkombëtare, duke përfshirë këtu UNMIK-un, të cilit i kishin mbetur kompetenca *sidomos* në raste të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje penale, Interpoli etj.

Një vend të veçantë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, gjithashtu e ka të rezervuar edhe EULEX-i, i cili mbanë disa pozita të rëndësishme për ndjekje dhe gjykim të rasteve të caktuara. Në kuadër të këtij misioni, madje edhe në Kodin Penal të Kosovës janë saktësuar kompetencat e Prokurorisë Speciale të Kosovës, e cila udhëhiqet dhe mbahet nga EULEX.

Pra, mbi bazën juridike të Raportit Gjithëpërfshirës më vonë u bë edhe themelimi i Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktua që emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të bëhet nga ana e Presidentit të Kosovës, u themelua Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të sigurimit të një gjyqësori të pavarur, të drejtë dhe funksional, i cili do të reflektojë natyrën shumë etnike të Kosovës dhe gjithashtu u formua Këshilli Prokurorial i Kosovës, i cili po ashtu reflektonte natyrën shumë etnike të minoriteteve të cilat jetonin dhe vazhdojnë të jetojnë në Kosovë.

Sipas Planit Gjithëpërfshirës, Këshilli Gjyqësor përbëhet nga (13) anëtarë, ku (5) nga këta do të ishin gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit, (4) anëtarë i zgjidhnin deputetët e Kuvendit të cilët i mbajnë vendet e fituar gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, (2) nga ta duhet të jenë gjyqtarë dhe një tjetër të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, (2) anëtarë të tjerë i zgjedhin deputet e Kuvendit të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosove (ku njëri nga këta duhet të jetë gjyqtar) si dhe (2) anëtarët e fundit i zgjedhin deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera (ku njëri nga këta duhet të jetë gjyqtar).¹¹⁷

Më vonë, gjatë mandatit të Prezencës Ndërkombëtare Civile, Këshilli Gjyqësor nga gjithsejtë (13) anëtarët e përgjithshëm, (2) prej tyre që janë zgjedhur me votat e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të ishin ndërkombëtarë. Në fillim të zgjedhur sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ndërsa më vonë ligji për përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i shpallur në vitin 2009, këtë kompetencë ia jep Presidentit të Kosovës që të emërojë të gjithë anëtarët e KPGJP-së pa asnjë dallim.¹¹⁸

Sistemi gjyqësor, bazuar në Ligjin mbi Gjykatat në vete përfshin Gjykatat Themelore si shkallë të parë , Gjykatën e Apelit, e cila është e vendosur në Prishtinë dhe ka për detyrë të gjykojë rastet në shkallë të dytë dhe Gjykata Supreme si instanca më e lartë juridike në

¹¹⁷ Kosova Center for Security Studies, Ri-themelimi dhe reformimi I sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, maj 2011, faqe 24

¹¹⁸ Kosova Center for Security Studies, Ri-themelimi dhe reformimi I sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, maj 2011, faqe 25

Kosovë. Pjesë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës siç është thënë edhe më lartë janë edhe gjyqtarët e EULEX-it, funksioni dhe kompetenca e të cilëve është përcaktuar sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë, sikurse para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës u organizua në atë mënyrë që obligonte marrjen e masave për të rekrutuar sa më shumë gjyqtarë dhe prokurorë nga komunitete pakicë, me qëllim të rritjes së përfaqësimit të të gjitha komuniteteve në drejtësi.

Kjo në fakt, i'u përkushtua zonave të banuara me shumicë nga ana e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës. Për të arritur një përfaqësim sa më të mirë u dizajnuar një prag prej 15% të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cili duhet të jenë nga komuniteti jo- shqiptarë i Kosovës, ndërsa (8%) nga të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët kërkohet t'i përkasin komunitetit serb të Kosovës.¹¹⁹

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka për detyrë të ndërmarrë masa të atilla për të rritur numrin e gjyqtarëve që nuk janë shumicë në Kosovë.¹²⁰ Duke u mbështetur në Kushtetutën e Kosovës,¹²¹ si dhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit,¹²² Këshilli Gjyqësor i Kosovës u jep përparësi aplikuesve nga radha e komuniteteve pakicë të cilët janë me kualifikime të barabarta me komunitetin shumicë që jeton në Kosovë.¹²³

Për të arritur një nivel më të lartë të përfaqësimit të komuniteteve pakicë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, në të ardhmen parashohin që të

¹¹⁹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 17

¹²⁰ Kuvendi i Kosovës Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 4 dhe 17

¹²¹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108, 2008

¹²² Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, Shtojca IV, neni 2

¹²³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 17

hartojnë rregullore të veçanta¹²⁴ për të përshkruar procesin e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve nga ana e komuniteteve pakicë në Kosovë.

Sipas legjislacionit të deritashëm të aplikuar në Kosovë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në rastet kur me kërkesë të komunës së re nuk ka mundësi të themelojë gjykatën e re themelore në atë komunë, autoritetet kompetente të asaj komune të mëparshme, sipas ligjit, kanë për obligim që të ndërmarrin masa të nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale të cilat jetojnë të izoluarra gjeografikisht ose në mungesë të sigurisë ose për shkaqe të faktorëve të tjerë relevant.¹²⁵ Pra, këto masa nënkuptojnë krijimin e një departamenti të gjykatës themelore nga komuna ekzistuese në komunën e re, apo gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave të caktuara në territorin e komunës së re.

Legjislacioni në fuqi pasqyron përfaqësimin e komuniteteve edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës në të cilën 15% të gjyqtarëve të kësaj gjykate, por asnjëherë më pak se (3) gjyqtarë duhet të përfaqësohen nga ana e komuniteteve të cilat janë pakicë në Kosovë.¹²⁶ Ndërkaq, në Gjykatën e Apelit si organ i shkallës së dytë, 15% të ulëseve të përgjithshme në këtë gjykatë dhe asnjë rast me pak se 10% janë të garantuara për gjyqtarët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.¹²⁷ Sipas të dhënave zyrtare deri, më tani, në sistemin gjyqësor të Kosovë aktualisht janë të punësuar (22) gjyqtarë që në përqindje i bie

¹²⁴ Kuvendi I Kosovës, Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës , neni 7 pika 6 dhe neni 12 pika 4

¹²⁵ Kuvendi I Kosovës, Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës , neni 10 pika 11.3

¹²⁶ Kuvendi I Kosovës , Ligji Nr.03/L-199 Ligji për Gjykatat, neni 21

¹²⁷ Kuvendi I Kosovës , Ligji Nr.03/L-199 Ligji për Gjykatat neni 17

6,27% të komuniteteve të cilat vijnë nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.¹²⁸

Institucion tjetër i rëndësishëm i cili është paraparë po ashtu me Kushtetutën e Kosovës është edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, i cili funksionon si një institucion i pavarur profesional dhe i paanshëm, i cili reflekton natyrën shumë etnike brenda tij. Këshilli Prokurorial i Kosovës përbëhet (10) prokurorë publik të Kosovës ku (5) nga këta deri në kohëzgjatjen e misionit ndërkombëtar në Kosovë, do të përfaqësojnë EULEX-in.

Krahas funksionit, detyrave dhe përgjegjësi të Këshillit Prokurorial në këtë institucion janë të parapara edhe rekrutimi, emërimi dhe rrimërimi i kandidatëve nga pjesëtarët që janë pakicë në Kosovë. Pra, ky këshill përkujdeset që anëtarët e komuniteteve që janë pakicë në Kosovë të emërohen në role udhëheqëse në prokurorinë e shtetit.¹²⁹ Legjislacioni mbi prokuroritë ka paraparë që në Këshillin fillestar prokurorial të zgjidhet një kandidat nga ana e komuniteteve që janë pakicë në Kosovë¹³⁰.

Gjithashtu, krahas detyrave dhe përgjegjësi të tjera, këshilli duhet të përkujdeset për sigurimin e strukturës së tillë, që prokurorët të pasqyrojnë përbërjen shumë etnike të zonës së tyre të juridiksionit,¹³¹ si dhe të ndërmarrin masa të tilla që së paku çdo (5) vjet, ky Këshill të studiojë përbërjen shumë etnike të prokurorëve dhe sipas nevojës të kërkojë financim shtesë për të rritur numrin e prokurorëve nga radhët e komuniteteve që janë

¹²⁸ Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian, Tryeza Tematike për Drejtësi, Liri dhe Siguri Kosova 2020, Raport i majit 2013.

¹²⁹ Kuvendi i Kosovës Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 20

¹³⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 42

¹³¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 17 pika 3

pakicë dhe se këtyre të fundit do të u jepet përparësi në rast të kualifikimeve të njëjta me pjesëtarët e shumicës.¹³²

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, institucionet e vendit u përpoqën që sistemin e drejtësisë ta shtrijnë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës duke përfshirë këtu edhe veriun e vendit. Një shtrirje e tillë gjithëpërfshirëse nuk u mbështet edhe nga serbët e Kosovës të kësaj pjese të cilët ishin të mbështetur nga politika e Beogradit të cilët dhe në këtë mënyrë bojkotuan institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës duke mos përjashtuar këtu edhe sistemin e drejtësisë. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës u shoqërua me një dhunë të ushtruar nga pjesëtarët e komunitetit serb në veri të vendit, çka rezultojë me mbylljen e gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës.

Më vonë, pra, në tetor 2008, kjo gjykatë u rihapë me kushtin që vetëm gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë do të punonin në lokalet e kësaj gjykate të cilët do të jenë të detyruar të aplikojnë vetëm legjislacionin e UNMIK-ut i nxjerrë në bazë të Rezolutës 1244.

Roli dhe ndikimi i komuniteteve në sistemin e drejtësisë, përveç fushave të përmendura më lartë shtrihet edhe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ku në komisionin për zgjedhjen e gjyqtarëve të kësaj gjykate, është edhe një përfaqësues i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve si dhe njëri nga zëvendës kryesuesit e këtij komisioni është nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.¹³³

¹³² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 18

¹³³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 6

Krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, është një element thelbësor për krijimin e sundimit të së drejtës dhe ligjit si dhe zgjidhjes së problemeve të ndryshme në sistemin e drejtësisë. Në rastin e Kosovës, është paraqitur një nevojë e domosdoshme për të garantuar një sistem gjyqësor, i cili u shërben në mënyrë korrekte të gjithë sektorëve të shoqërisë, një sistem juridik, i cili do të reflektojë bazat e një sistemi jo diskriminues për të gjithë qytetarët e Kosovës .

Avancimi i të drejtave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë shihet edhe në Marrëveshjen e arritur në mes të dy kryeministrave; të Kosovës dhe atij të Serbisë, të nënshkruar me datë 19 prill të vitit 2013. Në këtë marrëveshje parashihet themelimi i një paneli me shumicë serbe për të shqyrtuar të gjitha rastet në komunat me shumicë serbe të cilat gjenden në Kosovë. Gjithashtu parashihet që Gjykata e Apelit të Prishtinës të themelojë një divizion i cili do të përbëhet me staf administrativ dhe gjyqtarë nga radhët e komuniteteve i cili do të vendosej në mënyrë të përhershme në veri në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është shuarja e strukturave paralele të përqendruara në veri të vendit. Kjo marrëveshje ka shumë mangësi dhe paqartësi dhe si e tillë ajo me shumë krijon probleme se sa që zgjidhë ato. Së pari, me anë të kësaj marrëveshje nuk është rregulluar gjykimi i rasteve në shkallë të parë, të cilat raste duhet të gjykohen në gjykatën themelore. Së dyti, kjo marrëveshje bie ndesh me ligjin mbi gjykatat, i cili parasheh se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë të drejtë të shtrijnë juridiksionin e tyre në tërë territorin e vendit, dhe e treta, me këtë marrëveshje nuk është specifikuar dhe nuk është qartësuar edhe

15% i vendeve të rezervuara për komunitete brenda këtyre gjykatave, ashtu siç është paraparë me ligjin mbi gjykatat.

Pra, si përfundim j shihet se krijimi i një sistemi efektiv të drejtësisë në Kosovë mbetet akoma një sfidë për institucionet e vendit edhe pas një periudhe prej (15) vitesh nga koha e fillimit të ndërtimit dhe krijimit të shtetësisë së Kosovës. Megjithatë, kjo sfidë si e tillë, më tepër është politike dhe se vendosja e një sistemi të drejtësisë gjithëpërfshirës në tërë territorin e Republikës së Kosovës paraqet një detyrim madhor për faktorin vendor po edhe atë ndërkombëtar.

Vendosja në një ombrellë e gjithë sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të autoriteteve kosovare, sepse sistemi i drejtësisë si çdo sistem tjetër në botë duhet të ketë një hierarki institucionale dhe jo institucione paralele, sepse për ndryshe nuk mund të ketë sistem të rregullave dhe përgjegjësisë dhe nuk mund të themi se ekziston një sistem juridik unik dhe në përputhshmëri me Kushtetutën e vendit. Botërisht dihet në asnjë vend të botes sistemi, i drejtësisë nuk është i organizuar në vije horizontale, po në të gjitha vendet e botes dhe në të gjitha kohet sistemi i drejtësisë ka qenë dhe është i organizuar në vij vertikale ose mbi bazën e hierarkisë.

Pra është Republika e Kosovës si e vetme edhe pse në hapat e pare të shtet ndërtimit bënë përjashtim në këtë rast duke ndërtuar një sitëm gjyqësor sa vertikal po aq edhe horizontal me gjykatën e apelit në veri të vendit, e cila ka dal si rezultat i bisedimeve Kosovë-Serbi.

4.3. Përfaqësimi i minoriteteve në Republikën e Kosovës në organet e nivelit lokal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është themeluar me një Rregullore të UNMIK-ut në vitin 2004 si pasardhëse nga ish Departamenti për Pushtetin Lokal, i cili ka ekzistuar në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike në atë kohë. Misioni i kësaj ministrie është ngritja kualitative e qeverisjes lokale në bashkëpunim me strukturat e zgjedhura dhe zyrtarët komunalë për të siguruar shërbime të përgjegjshme dhe efikase për të gjithë qytetarët. Pra, detyra kryesore është që të mbështesë dhe të avancojë qeverisjen lokale dhe në bashkëpunim me komunat të punojë, në atë mënyrë që të ofrojë shërbime të plota dhe të përgjegjshme për popullatën në gjithë rajonin.

Themelimi i kësaj ministre ishte shumë i vonshëm, qëllimi i themelimit të së cilës ishte reformimi i pushtetit lokal si dhe arritja e decentralizimit të vendit si një nga përgjegjësitë speciale e saj dhe ka zgjatur me vite. Pra, kjo ministri ka pasur një fushëveprim shumë të ngushtë me një program special të fokusuar në përmbushjen e reformës specifike, që ndërlidhet me qeverisjen e pushtetit lokal. Përgjegjësitë e tjera të zakonshme, të cilat kanë dalë nga strategjia afatmesme e punës së kësaj ministrie ishin edhe koordinimi me komunat dhe ministritë tjera që marrin pjesë në procesin e decentralizimit, si dhe përgjegjësitë tjera të ndërlidhura me procesin e integritetit në BE nga spektri i çështjeve që lidhen me pushtetin lokal dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga Plani i Ahtisarit.

Duke llogaritur se Kosova është një shtet “sui generis” për nga mënyra e themelimit të shtet ndërtimit, për dallim nga të gjitha shtetet tjera, ajo ka themeluar këtë ministri të veçantë me qëllim që t’i japë një shtytje procesit të decentralizimit dhe e cila për nga roli i saj lirisht mund të krahasohet në një linjë me ministrinë më të fuqishme të vendit apo edhe me zyrën e kryeministrit. Gjithashtu kjo ministri, krahas institucioneve tjera, të cilat merren me mbrojtjen dhe integrimin e komuniteteve në Kosovë, në kompetencat e saj, e ka të detyruar që gjatë shërbimeve të ndryshme komunale, të mbikëqyrë respektimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhës si gjuhë zyrtare në ato komuna, ku jetojnë komunitetet, përkujdesjen në ofrimin e mundësive të barabarta në nivelin lokal duke përfshirë këtu edhe të drejtën e përfaqësimit në nivel lokal etj.

Siç u theksua edhe më sipër kjo ministri fillimisht është themeluar me qëllim të arritjes së suksesit gjatë procesit të decentralizimit të vendit dhe se pas përfundimit të këtij misioni, në një të ardhme të afërt mund të pritet një ndryshim i misionit të saj, ku nga roli parësor në procesin e decentralizimit dhe integritimeve në BE, të kthehet në monitorimin dhe mbështetjen e komunave dhe administratës publike në nivelin komunal të decentralizuar.

Pra, tanimë misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është që në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante të arrijë përparimin dhe avancimin e qeverisjes lokale si dhe të sigurojë shërbime efikase në nivelin lokal, pa diskriminim për të gjithë qytetarët e vendit. Kjo ministri ka mandatin që në vazhdimësi të mbështes dhe të mbikëqyrë aktivitetet e komunave gjithnjë duke u mbështetur në legjislacionin, i cili është në fuqi.

Misioni i kësaj ministrie, është pra, avancimi i qeverisjes lokale me qëllim të sigurimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarë, ofrimin e mbështetjes për komuna, në realizimin e projekteve të ndryshme investive, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve komunale. Kjo ministri, në vazhdimësi i mbikëqyrë komunat, në mënyrë që aktivitetit i tyre të jetë në harmoni të plotë me kuadrin ligjor dhe kushtetues të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të kësaj ministrie, ekziston edhe një Divizion për të Drejtat e Njeriut, si një mekanizëm përgjegjës dhe efikas për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha komunat e Kosovës. Njësitë e tilla për të Drejtat e Njeriut janë themeluar në të gjitha komunat duke u mbështetur në një Udhëzimin Administrativ të nxjerrë nga MAPL¹³⁴ sipas të cilit akt juridik, këto njësi kanë funksionuar në (30) komuna, ndërsa më vonë me plotësim ndryshimet e bëra me Udhëzimin e ri Administrativ¹³⁵ janë themeluar edhe katër (4) njësi të tjera në komunat e reja të sapo formuara të Graçanicës, Parteshit, Klllokotit dhe Ranillugut. Tanimë funksionojnë (34) njësi të cilat veprojnë si mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal dhe të cilat kanë një bashkëpunim shumë të mirë me Institucionin e Avokatit të Popullit me rastin e adresimit të ankesave të ndryshme të qytetarëve.

Institucionet shtetërore, por edhe ato ndërkombëtare, të cilat u instaluan në Kosovë pas përfundimit të luftës së fundit, në vazhdimësi, kanë paraparë një gamë të gjerë mekanizmash institucionale të cilët merren me çështjen e mbrojtjes dhe promovimit të të

¹³⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ Nr. 2008/2 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, 2008

¹³⁵ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ Nr. 2011/4 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, 2008

drejtave të njeriut në nivel qendror dhe komunal. Për të arritur një mbrojtje, promovim dhe përfaqësim sa më të mirë të komuniteteve në Kosovë, duhet të ekzistojë një koordinim, bashkëpunim dhe shkëmbim i informatave në mes të nivelit lokal dhe atij qendror.

Për të arritur një nivel sa më të lartë të përfaqësimit të komuniteteve në nivelin e pushtetit lokal, në vitin 2007 Ministri i Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, në zbatim të rregullores që ishte në fuqi, në atë kohë, nxori Udhëzimin Administrativ nr.2007/08 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, si një mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal. Këto njësi kanë një mori kompetencash dhe përgjegjësisish si ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, këshillimin në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe akteve tjera ligjore e nënligjore të nxjerra nga kuvendet komunale në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit vendor.

Po ashtu, këto njësi kanë pasur rol monitorues për aktivitetet e komunës dhe, po ashtu, rol këshillues për kryeshefin ekzekutiv dhe bordin e drejtorëve në kohe. Lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut si dhe me qëllim të përmbushjes së objektivave të veta në sferën e të drejtave të njeriut, këto njësi kanë bashkëpunuar me institucione qeveritare dhe joqeveritare si dhe me agjencione të ndryshme.

Të drejtat e komuniteteve, që jetojnë në Kosovë, siç është theksuar disa herë, janë të garantuara me Kushtetutë, ligje, rregullore si dhe më të gjitha politikat shtetërore, që u sigurojnë të gjithë pjesëtarëve e komuniteteve të drejtat themelore, duke ndërmarrë masa të

veçanta me qëllim të përmirësimit në çdo situatë, për çdo komunitet të drejtat dhe liritë e njeriut.¹³⁶ Pra, Kushtetuta e Kosovës garanton pjesëmarrje efektive në vendimmarrje politike dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes përmes përfaqësimit të të gjithëve në organet shtetërore.

Komunat si institucione shtetërore, ofrojnë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët e vet pa dallime në baza etnike. Sipas hulumtimeve të kryera, gjatë proceseve të rekrutimit të stafit nëpër administrata komunale vërehet nuk janë evidentuar shkelje të të drejtave të aplikuesve, përkundrazi, komunat kanë bërë thirrje në vazhdimësi për aplikim të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe se pikërisht për këtë qëllim, konkurset mbi aplikim për vende të punës, enkas për pjesëtarë të komuniteteve pakicë përsëriten dhe zgjaten afatet madje edhe deri nga tri herë.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i një komune, i cili është përgjegjës për miratimin e akteve, rregulloreve komunale, miratimit të buxhetit komunal dhe planeve të ndryshme të investimeve etj. Në kuadër të kuvendeve nëpër komuna funksionon edhe një komitet i përhershëm, i cili përbëhet nga anëtarë të kuvendit prej të gjitha komuniteteve të pranishme në komunë. Komiteti është kompetent për të shqyrtuar projekt-rekomandimet e komuniteteve dhe në përputhje me praktikat komunale synon sigurimin e mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave dhe lirive të komuniteteve.

¹³⁶ Ministria e Administrimi të Pushtetit Lokal, Raport përmbljedhës për Promovimin e të Drejtave të Njeriut në Komunitet e Republikës së Kosovës , 2012, faqe 10

Kur bëhet fjalë për nivelin e përgjithshëm të komuniteteve, janë të shtrira gjithandej nëpër Kosovë është thënë se ekzistojnë këto lloje të komuniteteve: komuniteti serb, boshnjak, malazez, kroat, turk, rom, egjiptian, ashkali dhe goran. Ndërsa, kur flitet për nivelin komunal të përfaqësimit duhet të kihet parasysh, se krahas këtyre komuniteteve të cekura më sipër, kemi edhe komunitetin shqiptar, i cili jeton dhe përfaqësohet si pakicë në ato komuna të cilat administrohen nga komunitetet e tjera që në ato komuna janë shumicë.

Përfaqësimi i komuniteteve në nivel lokal është i rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,¹³⁷ i cili potencohet se, nëse në një komunë jetojnë të paktën 10% të komuniteteve pakicë, atëherë, ai komunitet përfaqësohet në të gjitha strukturat komunale. Dispozitat e këtij ligji janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila gjithashtu, vë në pah se në komunat në të cilat së paku 10% të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilët në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të Kuvendit të Komunës, do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve¹³⁸.

Me këtë rast, Kushtetuta e Kosovës vendin e nënkryetarit të komunës e ka rezervuar për komunitet që jetojnë në atë komunë dhe të cilat nuk e përbëjnë shumicën. Natyrisht këtë pozicion nga radhët e komunitetit e zë kandidati, i cili ka marrë më së shumti vota në zgjedhjet e kuvendit komunal. Detyrat dhe roli kryesor i tij është, jashtëzakonisht, i rëndësishëm, duke pasur parasysh faktin, që ai në mbledhjet e kuvendeve komunale është kompetent për promovimin e dialogut në mes të komuniteteve, zgjidhjen të problemeve të

¹³⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 54 dhe 61

¹³⁸ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 62, 2008

shumta dhe mbrojtjes së interesave të komuniteteve që janë pakicë. Gjatë mandatit të tij, zëvendëskryetari për komunitete i Kuvendit të Komunës ka përgjegjësi të shqyrtojë të gjitha ankesat që parashtrihen nga radhët e komuniteteve dhe nëse ato nuk marrin zgjidhje të drejtë me vendim të kuvendit të komunës, ka të drejtë që ankesat e tilla t'i adresojë direkt në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, në mënyrë që të drejtat e tyre të realizohen ashtu siç edhe janë paraparë edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Kur flasim për të drejtat e komuniteteve dhe përfaqësimin e tyre, një gjë është me rëndësi, që duhet theksuar dhe që është zbatuar shumë mirë edhe në praktikë, e që lidhet me përfaqësimin e komuniteteve. Kjo zgjidhje, shumë herë, është praktikuar në praktiken e kushtetutshmërisë krahasimore të vendeve të tjera të cilat kanë karakter shumë etnik dhe shumë gjuhësor.¹³⁹

Ndërkaq, kur flitet për përfaqësimin e komuniteteve pakicë vetëm në nivelin lokal të përfaqësimit, atëherë mund të thuhet se ka disa komuna të cilat tregojnë një përfaqësim më të lartë të ndonjë komuniteti të caktuar, derisa të tjerat kanë përfaqësim në numër më të vogël të komunitetit, varësisht prej koncentrimit të komuniteteve në komunë.

Një gjë, që është karakteristike për komunat e Kosovës, e që ja vlen të përmendet është fakti se disa komuna me shumicë shqiptare dhe në të cilat nuk jetojnë fare komunitete pakicë, duke dashur që ta plotësojnë kuadrin ligjor për vetëqeverisje lokale, edhe ato i kanë themeluar zyrat për komunitete si mekanizma për mbrojtjen e tyre. Një shembull i tillë i

¹³⁹Enver Hasani & Ivan Cukalovic, Komentar i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2013, faqe254

themelimit të zyrës për komunitete, mund të gjendet në Komunën e Junikut, ku ani pse nuk ka komunitete pakicë është themeluar kjo zyre për komunitete.

Sipas të dhënave zyrtare nga vitit 2012, përfaqësimi i komuniteteve në strukturat e nivelit lokal është si në vijim: numri total i pjesëmarrjes në nivel lokal është (6.440), ku nga të gjithë këta, shqiptarët marrin pjesë me (5.343) pjesëtarë, apo 82%) serbët me (434) pjesëtarë, apo 6.73%); boshnjakët me (113) pjesëtarë, apo 1.75%; turqit me (79) pjesëtarë, apo 1.22%; goranet me (5) pjesëtarë, apo 0.07%; ashkalinjët me (22) pjesëtarë, apo 0.34%; egjiptianët me (11) pjesëtarë, apo 0.17%; romët me (18) pjesëtarë, apo 0.28%; dhe të tjerë me (7) pjesëtarë, apo 0.10%; Ndërkaq, si të papërcaktuar janë (408) persona, apo 6.38%.¹⁴⁰

¹⁴⁰ Raporti përmbledhës për promovimin e të Drejtave të Njeriut në Komunitatet e Kosovës, 2012, faqe 10

KAPITULLI V

5. SISTEMI ZGJEDHOR NË KOSOVË

5.1. Sistemi zgjedhor në Kosovë nga aspekti i pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë

Është e kuptueshme se zgjedhjet, qofshin ato zgjedhje të përgjithshme ose komunale, paraqesin një prej komponentëve më të fuqishme të nivelit të demokracisë së sotme, sidomos në ato shtete ku demokracia është e ndërtuar me themele të forta dhe ku zgjedhjet shihen si një mundësi për të zgjedhur ata më meritoret për të cilët mendohet se do të përfaqësojnë denjësisht vlerat dhe interesat e qytetarëve të cilët i votojnë. Bazuar në këtë, themi se sistemi zgjedhor brenda një shteti mund të jetë ose shtytës ose pengesë për zhvillimin sa më demokratik të një shoqërie që ka aspirata për t'ju bashkuar bashkësisë evropiane.

Pas mbarimit të luftës së Kosovës me Serbinë në vitin 1999, Kosova filloi organizimin dhe funksionalizimin e institucioneve të saj nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Pra, u krijua një lloj shteti i cili funksiononte nën një lloj protektorati ndërkombëtar të shumë organizmave ndërkombëtarë. Gjatë gjithë kësaj kohe u themeluan shumë institucione vendore si dhe u nxorën edhe shumë dokumente të rëndësishme, të cilat çdo ditë e më tepër e qojnë Kosovën drejt shtetësisë së saj: si Rezoluta 1244, Korniza Ligjore, Standardet para Statusit etj. Mirëpo, mbi të gjitha, mund të themi se Kosova si një shtet shumë etnik u krijua mbi bazën e një marrëveshje ndërkombëtare e cila njihet si Pakoja e Ahtisarit dhe e cila parashihte vendet e rezervuara për minoritetet edhe për dy mandate radhazi pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Kështu pra, fillimisht pas shpalljes së pavarësisë, duke u nisur nga fakti se Kosova ishte shtet i ri dhe shumetnik, grupeve minoritare në Kosovë iu dhanë disa të drejta të avancuara, të cilat parashiheshin edhe me Pakon e Ahtisarit. Dhënia e këtyre të drejtave nuk përbënte ndonjë problem të madh, përkundrazi shfaqte dëshirën nga ana e shumicës shqiptare dhe institucioneve të Kosovës, për tolerancë ndëretnike dhe ndër fetare, por problemi me minoritetet nuk u zgjidh me kaq. Ata kërkonin gjithnjë e më shumë të drejta dhe Qeveria e Kosovës duke dashur të tregojë përkushtimin e saj para bashkësisë ndërkombëtare nuk hezitonte t'i jepte të drejta minoriteteve në Kosovë shpeshherë edhe duke bërë diskriminim pozitiv.

Arsyeja pse po e përmend bashkësinë ndërkombëtare në këtë temë është se ata janë përfshirë direkt çështjen e minoriteteve duke u munduar t'ua rregullojnë një herë e përgjithmonë këtë problematikë. Kështu, shumë ambasadorë, gjatë qëndrimit në Kosovë i këshilluan gjithnjë qeveritaret tanë që të kishin të kujdes të veçantë, kur ishte fjala për çështjet të minoriteteve. Ata morën për shembull modelin e Francës dhe të Gjermanisë për pajtimin e tyre historik, të bëra nga to pas një luftë të përgjakshme, duke anashkaluar kështu, rrethanat dhe situatën reale që në atë kohe mbretëronte në Kosovë. Tërheqja e një paraleleje të tillë ishte e padrejtë, sepse me vdekjen e Hitlerit mori fund lufta e dytë botërore, por dhe mori fund edhe urrejtja mes popujve (Gjermanisë dhe Francës në këtë rast). Gjermania e detyruar nga fuqitë e mëdha pagoi dëmet e shkaktuara gjatë luftës, dhe mori dënimin e ndarjes së vendit në dy shtete me rregullime të ndryshme shtetërore e ideologjike. Ndërsa, urrejtja e brumosur me shekuj në mes të serbeve dhe shqiptarëve, si pasojë e gjenocidit serb mbi shqiptarët, nuk arriti të fashitet asnjëherë. Nuk mori fund

sepse, Serbia jo vetëm që nuk, u distanca nga politika e gjenocidale e Millosheviqit dhe jo vetëm që nuk i pagoi dëmet e shkaktuara gjatë luftës, po madje nuk pati kurajon civilizuese t'i kërkonte falje popullit të Kosovës për të gjitha dëmet dhe të këqijat e bëra gjatë luftës.

Megjithatë, populli i Kosovës dhe institucionet e tij, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana i pranuan këshillat e miqve ndërkombëtarë dhe u dhanë edhe më shumë të drejta minoriteteve, që në shumë vende të rajonit as që mund të imagjinohet një veprim i tillë.

Kur flasim për sistemin zgjedhor në Kosovë nga aspekti i pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë, mund të konstatohet se ligjvënësi i ka kushtuar një vëmendje të posaçme këtij aspekti, përmes nxjerrjes, fillimisht të rregulloreve të UNMIK-ut, e më vonë edhe të ligjeve nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në këtë drejtim, në maj të vitit 2001 nga ana e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së u miratua Korniza Kushtetuese.¹⁴¹ Në bazë të këtij dokumenti Kuvendi i Kosovës në përbërje të vetë pati (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, ndërsa prej numrit të përgjithshëm të tyre (20) vende ishin rezervuar për përfaqësim plotësues nga ana e komuniteteve jo shqiptare të Kosovës. Kjo u bë sipas formulës: (10) vende u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që kanë deklaruar vetë se përfaqësojnë komunitetin serb, ndërsa (10), vende tjera u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: romëve, ashkalinjëve dhe komunitetit egjiptian (4), komunitetit boshnjak (3), komunitetit turk (2) dhe komunitetit goran (1). Këto vende për secilin komunitet u ndahen partive, koalicioneve, nismave

¹⁴¹ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, maj 2001

qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata marrin në zgjedhjet për Kuvend.

Po ashtu, Korniza Kushtetuese kishte përcaktuar që në kuadër të përbërjes së kryesisë së Kuvendit të Kosovës, krahas anëtarëve të kryesisë që do të zgjesheshin sipas renditjes së partive politike që kishin fituar më së shumti vota, një anëtar do të emërohej nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb dhe një anëtar do të emërohej nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin jo shqiptar dhe jo serb. Metoda për emërimin e këtij anëtari të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta.

Korniza Kushtetuese kishte paraparë gjithashtu, që në kuadër të Kuvendit të Kosovës, krahas komisioneve të tjera të themelohej edhe një komision për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, i cili në përbërje të vet do të kishte nga dy deputetë të secilit komunitet të Kosovës që përfaqësohet në kuvend, edhe në këtë komision do të përfaqësohen me të njëjtin deputet.

Në përputhje me dispozitat e Kornizës Kushtetuese, në nëntor të vitit 2001, Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-se miratoi Rregulloren¹⁴² mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, me të cilën u hap rruga për organizimin e zgjedhjeve të para të përgjithshme të pasluftës për deputetë të Kuvendit të Kosovës. Me këtë rregullore u definua qartë se vendet në kuvend do të ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të përcaktuar me Kornizën

¹⁴² Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullore Nr. 2001/33 mbi Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, nëntor 2001

Kushtetuese ku (20) vende do të rezervoheshin për komunitetet jo shqiptare që jetojnë në Kosovë dhe kjo sipas sistemit: komunitetit serb të Kosovës dhjetë (10) vende, komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian (4) vende, komunitetit boshnjak (3) vende, komunitetit turk (2) vende dhe komunitetit goran (1) vend.

Ndërkaq, në vitin 2004 u miratua Rregullorja¹⁴³ për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organ i përhershëm dhe i pavarur për zhvillimin e politikave dhe mbikëqyrjen menaxhuese të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjeve për kuvendet komunale. Me këtë Rregullore parashihej që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të përbëhej nga (1) kryesues dhe nga (11) anëtarë që emëroheshin nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Këta anëtarë, përveç kryesuesit, kishin edhe nga një zëvendës të tyre i cili do t'i zëvendësonte në rast të mungesës të ndonjërit prej anëtareve të komisionit. Edhe me këtë rast, ligjvënësi ka pasur parasysh aspektin e pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë në këtë komision. Me kërkesë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së u veprua si me poshtë: tri subjektet e para që kishin fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës, kishin të drejtë të propozonin nga një anëtar të komisionit dhe zëvendësit e tyre, sipas kësaj formule:

- subjekti politik që kishte fituar numrin më të madh të votave në mesin e atyre subjekteve që janë përpjekur t'i fitojnë vendet e rezervuara për bashkësinë serbe të Kosovës,

¹⁴³ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2004/9 mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, 2004

- subjekti politik që kishte fituar numrin më të madh të votave në mesin e atyre subjekteve që janë përpjekur t'i fitojnë vendet e rezervuara për bashkësinë rome, ashkali dhe egjiptiane,
- subjekti politik që ka fituar numrin më të madh të votave në mesin e atyre subjekteve që janë përpjekur t'i fitojnë vendet e rezervuara për bashkësinë turke, dhe
- subjekti politik që ka fituar numrin më të madh të votave në mesin e atyre subjekteve që janë përpjekur t'i fitojnë vendet e rezervuara për bashkësinë boshnjake dhe goranë.¹⁴⁴

E drejta e komuniteteve pakicë në Kosovë, për (20) vendet e rezervuara për Kuvendin e Kosovës u konfirmua edhe njëherë me Rregulloren mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës¹⁴⁵ e miratuar në maj 2004 dhe po ashtu edhe me ndryshim Rregulloren¹⁴⁶ e miratuar në gusht të vitit 2007 sipas të cilave edhe me këto dokumente komuniteteve pakicë u njëhej e drejta për ato (20) vende siç ishte e përcaktuar edhe me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.

Ndryshimet që ndodhen në vitin 2007 në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, sollën edhe deri tek ndryshimet në aspektin e pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë për Kuvendin e Kosovës. Përderisa me Kornizën Kushtetuese, pos të tjerash (10), vende iu ndaheshin komuniteteve të tjera si vijim: romëve, ashkalinjëve dhe

¹⁴⁴ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2004/9 mbi Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, neni 3

¹⁴⁵ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2004/12 mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, maj 2004

¹⁴⁶ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2007/26 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2004/12 mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, gusht 2007

komunitetit egjiptian (4), komunitetit boshnjak (3), komunitetit turk (2), dhe komunitetit goran (1). Ndërkaq me këto ndryshime të Kornizës Kushtetuese, pos tjerash (10) vende ndahen për komunitetet e tjera si në vijim: komuniteti rom (1) vend; komuniteti ashkali (1) vend; komuniteti egjiptian (1) vend dhe një vend ndahet qoftë për komunitetin rom, ashkali apo atë egjiptian, bazuar në atë se cili komunitet ka marrë më shumë vota të vlefshme; komuniteti boshnjak (3) vende; komuniteti turk (2) vende dhe komunitetit goran (1) vend.¹⁴⁷

Me Shpalljen e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës iu përkushtuan ligjërisht dhe politikisht jetësimit të Planit të Ahtisarit (Propozimi Gjithëpërfshirës për Statusin). Duke u mbështetur në dispozitat e Planit të Ahtisarit, Kuvendi i Kosovës aprovoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta i parasheh standardet më të larta për mbrojtje të komuniteteve pakicë. Edhe përkundrejt faktit që Kosova nuk ka ratifikuar ndonjë traktat lidhur me mbrojtjen e të drejtave njerëzore, apo të të drejtave sociale, politike dhe të pakicave, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh vetë zbatimin e konventave, kartave dhe të instrumenteve të tjera ligjore më të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat ofrojnë mbrojtje ligjore të komuniteteve pakicë sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane. Aktualisht në Republikën e Kosovës janë tri dokumente juridike përmes të cilave rregullohet sistemi zgjedhor në vend: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale. Që të tri këto akte juridike janë si derivat i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, mbi bazën e të

¹⁴⁷ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullore Nr. 2007/29 mbi Ndryshimet në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, tetor 2007

cilit edhe ishte shpallur Pavarësia e Kosovës në shkurt 2008. Në këtë kuadër , Kushtetuta i përcakton parimet bazë të zgjedhjeve, të drejtën e votës dhe pjesëmarrjen në zgjedhje.¹⁴⁸

Siç është e ditur deri në zgjedhjet e vitit 2007, përgjegjësinë për përgatitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në Kosovë e kishte Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, e cila gradualisht këto përgjegjësi i barti tek institucionet vendore. Që nga kjo periudhë, zgjedhjet në Kosovë organizohen dhe monitorohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ i pavarur dhe i përhershëm që menaxhon me të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me procesin zgjedhor, duke përfshirë edhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Po ashtu, në atë kohë u vendos që votimet të bëhen me lista të hapura që nënkupton që subjektet politike vendosin përbërjen dhe renditjen e kandidatëve të tyre që propozohen për kandidatë për deputetë në Kuvendin e Kosovës.

Nga ana tjetër, Republika e Kosovës me qellim të promovimit dhe avancimit të të drejtave të veçanta për komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë, me dispozita kushtetuese ka përcaktuar që nga numri i përgjithshëm prej (120) vendeve për deputetë të Kuvendit të Kosovës, (20) vende të jenë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që janë pakicë në Kosovë dhe kjo sipas ndarjeve në vijim:

- i. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituara në zgjedhjet e hapura, me minimumin (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se (10); dhe

¹⁴⁸ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45, 2008

- ii. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali (1) vend; komuniteti egjiptian (1) vend; dhe (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak (3) vende, komuniteti turk (2) vende dhe komuniteti goran (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.¹⁴⁹ Kjo do të thotë se, partitë e përmendura, koalicionet, iniciativat e ndryshme qytetare por edhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se i përkasin komunitetit serb e kanë numrin e përgjithshëm të vendeve në Kuvendin e Kosovës aq sa e kanë marrë në zgjedhje të hapura. Mirëpo, nëse numri i vendeve të fituara është më i vogël se (10) atëherë, ata i kanë më së paku (10) vende të garantuara. E njëjta vlen edhe për pjesëmarrësit e përmendur në zgjedhje që janë deklaruar se i përkasin komuniteteve tjera pakicë në Kuvend. Pra, edhe për ata pjesëtarë vlejnë të njëjtat rregulla, ku ata do ta kenë numrin e përgjithshëm të vendeve të fituara në zgjedhje, por nëse numri i këtyre votave të fituara të çdo komuniteti pakicë është më i vogël se numri i vendeve të garantuara, atëherë, ata do të kenë numrin minimal të vendeve të garantuara sipas renditjes së përcaktuar me kushtetutë. Së këndejmi, romët, ashkëtinjtë dhe egjiptianët do të kenë nga (1) vend, por që një vend shtesë do t'i ndahet komunitetit pakicë që do të marrë më së shumti vota,

¹⁴⁹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 64

ndërsa komunitetit goran, po ashtu do t'i ndahet një vend. Pesë vendet e mbetura në kuvend do tu ndahen komunitetit të boshnjakëve dhe turk (3+2).¹⁵⁰

Me dispozita kushtetuese është paraparë që në kuadër të Kuvendit të Kosovës të themelohet edhe një organ i veçantë i përhershëm, i ashtuquajtur Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, i cili përbëhet nga 1/3 e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara e të garantuara për komunitetin serb, 1/3 e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara e të garantuara për komunitetet e tjera që janë pakicë, dhe 1/3 e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.

Edhe Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë,¹⁵¹ i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2008 dhe i cili është në fuqi, në kuadër të dispozitave të veta specifikon qartë, se vendet për Kuvendin e Kosovës ndahen në pajtueshmëri të plotë me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku (20) vende nga numri i përgjithshëm janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve pakicë që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Ndërkaq, sot kur flasim për zgjedhjet në rrafshin lokal në Kosovë, mund të themi se nënshkrimi i marrëveshjes së Brukselit, në muajin prill 2013, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë ndikoi në krijimin e raporteve të reja jo vetëm ndërmjet këtyre dy vendeve, po edhe në raportin ndërmjet Prishtinës dhe qytetarëve të Kosovës në pjesën veriore të saj, nga fakti se pas kësaj marrëveshje në zgjedhjet e fundit të mbajtura për pushtetin lokal është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së komunitetit serb në zgjedhje në

¹⁵⁰ Enver Hasani & Ivan Cukalovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2013

¹⁵¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, qershor 2008

nivel Kosove. Me këtë rast lista Sërpska fitoi pushtetin në nëntë (9) komuna nga gjithsej dhjetë prej tyre me shumicë serbe, përfshirë këtu edhe katër (4) komunat në veri të Kosovës.

Përfundimisht, kur flasim për sistemin zgjedhor në Kosovë nga aspekti i përfaqësimit të komuniteteve pakicë, mund të rikujtojmë edhe një herë se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, u vendos që me sistemin e vendeve të rezervuara të ndryshohet sistemi i vendeve të garantuara, pas zhvillimit të dy cikleve zgjedhore dhe se kjo dispozitë me automatizëm do të hynte në fuqi pas këtyre dy cikleve zgjedhore. Çka do të thotë me të mbaruar dy cikle zgjedhore, pushonin së vepruari vendet e rezervuara dhe sistemi zgjedhor vazhdon me vendet e garantuara për komunitete pakicë.

Me sistem të vendeve të rezervuara, subjektet politike që i përkisnin komuniteteve pakicë garonin për (100) vende për Kuvendin e Kosovës dhe nuk i nënshtroheshin pragut prej 5% që zbatohet për subjektet politike të shumicës. Përveç kësaj, subjektet politike që i përkisnin komuniteteve pakicë në Kosovë, fitonin (20) vende përveç vendeve të fituara përmes garës së rregullt për (100) vendet tjera. Për ilustrim, në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në vitin 2010, subjektet politike të komuniteteve pakicë kishin fituar gjithsejtë (25) vende, nga të cilat (5) vende përmes garës së rregullt. Ndërkaq, me sistemin e vendeve të garantuara ka një dallim esencial në aspektin e asaj se si bëhet llogaritja e votave. Ky sistem ka për qëllim sigurimin e një përfaqësimi minimal të komuniteteve pakicë në Kuvendin e Kosovës, prandaj për dallim nga sistemi i vendeve të rezervuara, sistemi i vendeve të garantuara nuk ka për synim rritjen e numrit të vendeve në Kuvendin e Kosovës mbi peshën elektorale të komuniteteve pakicë. Vendet e garantuara mund të vijnë

në shprehje vetëm nëse subjektet politike që përfaqësojnë një komunitet pakicë fitojnë me pak se numri i vendeve të garantuara të ndara për ta.

Nga gjithë kjo që u tha me sipër, mund të konkludohet se sistemi zgjedhor në Kosovë, gjegjësisht legjislacioni mbi zgjedhjet në Republikën e Kosovës, ka për qëllim, që duke pasur parasysh situatën demografike në vend dhe strukturën e popullsisë që jeton në këtë territor, t'u mundësojë të gjitha komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre, pjesëmarrje proporcionale në popullatën e përgjithshme të marrjes së vendeve për deputet të Kuvendit të Kosovës, sipas rezultateve të fituara në zgjedhje. Kurse, për shkak të pjesëmarrjes së tyre jo edhe aq të madhe në rundin zgjedhor, e që në disa raste mund të thuhet me një pjesëmarrje të papërfillshme në zgjedhje, ligjvënësi ka paraparë mundësinë dhe ka garantuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve pakicë në jetën parlamentare të Kosovës, duke ju mundësuar atyre një ose me shumë vende për deputetë. Ky veprim është bërë nga fakti se përfaqësuesit e këtyre komuniteteve të vogla, të kenë mundësinë që t'i përfaqësojnë interesat e bashkëkombëseve të tyre, pra interesat e këtyre komuniteteve minoritare, sepse ata do ta bëjnë këtë më së miri në Kuvendin e Kosovës, duke pasur parasysh, gjithnjë faktin më mirë se kushdo tjetër, janë ata të cilët i përfaqësojnë dhe i delegojnë aspiratat e tyre në kuvend.

KAPITULLI VI

6. ANALIZA E KORNIZËS LEGJISLATIVE PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE PAKICË QË JETOJNË NË KOSOVË

Sipas Kushtetutës, në Republikës e Kosovës jeton një numër i caktuar i njerëzve në pozitë të pakicës, i cili dallohet për nga pjesa e shumicës si për nga gjuha, kultura, nacionaliteti, besimi fetar, etj. Me dispozita të veçanta kushtetuese, Kosova e ka rregulluar çështjen e përfaqësimit të pakicave në vend; që nga niveli më i ulët i përfaqësimit e deri në nivelin e përfaqësimit në presidencë. Çështja e rregullimit të të drejtave të pakicave në pjesën më të madhe bazohet në Planin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur si Plani i Ahtisarit, i cili paraqet një kornizë bazë ligjdhënëse për zgjidhjen dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Kur flasim për pakicat që jetojnë në Kosovë dhe përmendim termin komunitet pakicë është mirë të përcaktojmë se çfarë në esencë nënkuptohet me këtë term apo cilat kategori të njerëzve mund të përfshihen brenda këtij termi. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre jep definicionin e saktë se çfarë në të vërtetë kuptohet me komunitete pakicë. Sipas këtij ligji, me komunitete nënkuptohen grupe nacionale, etnike, kulturore, gjuhësore, apo fetare të cilat jetojnë në Kosovë dhe që nuk janë në grupin e shumicës. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali,

egjiptian, goran dhe komunitete tjera¹⁵². Po ashtu brenda këtij termi hyjnë edhe pjesëtarët e popullatës shumicë të cilët si tërësi në komunën ku jetojnë nuk janë shumicë.

Kushtetuta e Kosovës sikur edhe shumë dokumente të tjera të rëndësishme për Kosovën kanë dalë nga e ashtuquajtura Pakoja e Ahtisarit e përpiluar nga autori i saj Marti Ahtisari. Sipas Kushtetutës së Kosovës, por edhe me Pakon e Ahtisarit është e paraparë që nga gjithsejtë (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të listave zgjedhore, (20) vende në Kuvendin e Kosovës u janë garantuar pjesëtarëve të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë. Pra, nga ky numër të gjitha subjektet politike të cilat e përfaqësojnë interesin e komunitetit serb apo komuniteteve të tjera, kanë aq vende sa kanë fituar në zgjedhje, por më së paku (10) vende të garantuara, nëse numri i vendeve të fituara është më i vogël se (10) nga njëri komunitet apo grupi tjetër i komuniteteve.

Në dispozitat e përgjithshme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila pra siç thamë edhe me herët, është derivat i Pakos së Ahtisarit, është përcaktuar se Republika e Kosovës është një shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila, qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.¹⁵³ Pastaj në vazhdimësi të këtyre dispozitave kushtetuese, përcaktohet se ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar nga ndërkombëtarët, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të

¹⁵² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1 paragraf 1.4, 2008

¹⁵³ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3 paragraf 1, 2008

tyre.¹⁵⁴ Nga kjo mund të konkludohet shumë lehtë se Kosova është një shtet demokratik dhe shumetnik e cila pushtetin e saj do ta shtrijë në tërë territorin e saj dhe se të gjithë qytetarët e saj parimisht do të jenë të barabartë. Pra, parimi i barazisë¹⁵⁵ është parim bazë i rendit shtetëror- juridik, është themeli në të cilin bazohet dhe ndërtohet ai, si dhe në të drejtën themelore të qytetarëve të garantuar me Kushtetutë.¹⁵⁶

Kjo lenë të kuptohet se kemi një barazi të qytetarëve e cila, barazi manifestohet në kuptimin formal-juridik si barazi para ligjit, para gjykatave, pra, si parim i mos diskriminimit ose ndalim i diskriminimit në mes njerëzve.¹⁵⁷ Për më tepër, askush nuk mund të diskriminohet në kuptimin e gëzimit të të drejtave e lirive dhe secili duhet të gëzojë mbrojtje të njëjtë gjyqësore me kushte të njëjta, pa marrë parasysh dallimet në mes njerëzve,¹⁵⁸ dhe se ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë qoftë për t'i mbrojtur apo për t'i dënuar, qëndrim ky që ishte proklamuar edhe në Deklaratën Franceze të të Drejtave të Njeriut që nga viti 1789, parasegjithash, duke u bazuar në se të faktin se të gjithë qytetarët kanë dinjitet të barabartë shoqëror dhe se çfarëdo dallimi i palejueshëm në mes njerëzve ose grupeve paraqet arbitraritetin e pushtetit.¹⁵⁹

¹⁵⁴ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3 paragraf 2, 2008

¹⁵⁵ Enver Hasani /Ivan Cukolovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Dhjetor 2013, faqe 21

¹⁵⁶ Po aty, faqe 21

¹⁵⁷ Po aty, faqe 21

¹⁵⁸ Po aty, faqe 21

¹⁵⁹ Po aty, faqe 22

Në Komentarin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës theksohet se megjithatë, *“diskriminimi pozitiv sidomos për pakica dhe gjininë e bukur, nuk përbën dallim të palejueshëm dhe gjithashtu nuk është shkelje e parimit të barazisë”*.¹⁶⁰

Parimi mbi barazinë para ligjit i proklamuar në Kushtetutë, Kosovën e trajton si një shoqëri shumë etnike e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, ku të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit pa diskriminim, gjë që, nënkupton që nuk ka grupe të pabarabarta dhe se ligji do të vlejë për të gjithë njësoj.

Në këtë drejtim, Kosova e përcaktuar si shtet demokratik dhe shumë etnik, e dëshmon këtë fakt edhe kur bëhet fjalë për mënyrën e rregullimit të përdorimit të gjuhëve në Kosovë, ku dispozitat kushtetuese shprehimisht dhe shumë qartë e kanë përcaktuar se dy gjuhët zyrtare shqipe dhe ajo serbe do të jenë ato që do të fliten dhe shkruhen në Kosovë, ndërsa, gjuhët e komuniteteve të tjera turke, boshnjake dhe ajo rome si gjuhë zyrtare përdoren në ato komuna ku edhe jetojnë me shumicë komunitetet.

Pra, në këtë drejtim, ajo çfarë është karakteristike për Kosovën kur flitet për përdorimin e gjuhëve, është edhe zgjidhja e problemit të gjuhës së komuniteteve në komunat me përqindje të vogël të popullsisë në raport me popullatën e përgjithshme të komunës. Për ta rregulluar këtë problematike institucionet e Kosovës kanë nxjerr edhe ligjin mbi gjuhët i cili përcakton se cilat janë gjuhët zyrtare në institucionet e Kosovës, si ato në nivel qendror, po edhe ato në nivel komunal.

¹⁶⁰ Enver Hasani /Ivan Cukolovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Dhjetor 2013, faqe 22

Sipas Kushtetutës së Kosovës në komunat e banuara me komunitete pakicë, ku gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, gjuha këtyre komuniteteve do ta ketë statusin e gjuhës zyrtare,¹⁶¹ mjafton që të përbëje të kenë së paku 3% të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit do të ketë status të gjuhës zyrtare në komunë dhe do të përdoret e barabartë me gjuhët zyrtare.¹⁶²

Karakterit shumë etnik i Kosovës mund të vërehet edhe tek përdorimi i simboleve shtetërore, ku flamuri, stema dhe himni e pasqyrojnë karakterin shumë etnik të saj. Flamuri i Republikës së Kosovës është miratuar me ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, i cili ka një sfond të kaltër që i përngjan flamurit të Bashkimit Evropian, ku në mes ka hartën e Kosovës mbi të cilën janë vendosur (6) yje të bardhë, të cilët paraqesin gjashtë bashkësitë më të mëdha etnike që jetojnë në Kosovë.

Pra, me këtë nënkuptojmë se statusi i minoriteteve në Kosovë është i përfaqësuar në institucione të Kosovës, duke u nisur nga bashkësitë lokale, në të cilat jetojnë komunitetet pakicë, e deri tek institucionet më të larta të shtetit si në nivelin lokal edhe atë qendror, por edhe deri tek simbolet të cilat i kanë institucionet e Kosovës, duke përfshirë këtu stemën dhe flamurin e Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i përfshin të gjitha garancionet e nevojshme për komunitete pakicë që jetojnë në Kosovë. Po ashtu, edhe të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës që janë miratuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me fushën e integritetit dhe përfaqësimit të komuniteteve pakicë kanë marrë për bazë

¹⁶¹ Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5 pika 2, 2008

¹⁶² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-037 Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve, neni 2 pika 2.4 dhe neni 8, 2008

praktikat dhe modelet më të mira në fushën e të drejtave të njeriut. Kështu për shembull Korniza Ligjore e Kosovës ka marrë dhe miratuar dispozita nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,¹⁶³ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,¹⁶⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,¹⁶⁵ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore¹⁶⁶, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare¹⁶⁷ etj.

Pra, nëse i referohemi dokumenteve ndërkombëtare të cilat u përmenden më lartë dhe që ndërlidhen me të drejtat e komuniteteve, atëherë themi se këto të drejta mund të jenë drejta të përgjithshme politike dhe të drejta të veçanta dhe së këndejmi, komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë i gëzojnë këto të drejta lirshëm dhe në mënyrë të plotë, sepse ato janë të rregulluara shprehimisht dhe shumë qartë, sikurse me vet Kushtetutën e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe me aktet e tjera juridike të cilat kanë rrjedhur nga Kushtetuta.

Komuniteteve të cilat jetojnë në Kosove u është dhënë mundësi të jenë të përfshira në institucionet e Republikës së Kosovës në të gjitha nivelet ashtu siç ishte paraparë edhe me Planin e Ahtisarit por edhe me Kushtetutën e Kosovës, e që një mundësi e tillë për

¹⁶³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 2, 1948

¹⁶⁴ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 2200A (XXI), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 26 dhe 27, 1966

¹⁶⁵ Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e nënshkruar më 4 Nëntor 1950, Romë, neni 1 dhe 24

¹⁶⁶ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, 1992

¹⁶⁷ Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995

pjesëmarrje është po ashtu në frymën e Dokumentit të Kopenhagës.¹⁶⁸ Në këtë drejtim, faktorë të rëndësishëm, të cilët mund të ndikojnë në realizimin e të drejtave të pjesëtareve të komuniteteve pakicë për të marrë pjesë në institucionet shtetërore numërohen sidomos: numri i pjesëtarëve të çdo bashkësie pakicë, numri i bashkësive pakicë që jetojnë në shtetin e caktuar dhe shtrirja apo përqendrimi i këtyre bashkësive në hapësirën e caktuar si dhe faktorë të tjerë.¹⁶⁹

Kur flasim për pakicat, apo grupet e caktuara etnike që jetojnë në Kosovë, është më rëndësi të theksohet se Kushtetuta e Kosovës, ligjet dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike që janë derivat i saj kanë arritur shumë mirë zbatimin e tyre në Institucionet e Kosovës e sidomos në krijimin e mundësisë së përfaqësimit të minoriteteve në të gjitha nivelet e saj e po ashtu në Parlamentin e Kosovës.

Në këtë aspekt, të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë në njëfarë mënyre, janë edhe si të drejta plotësuese në raport me të drejtat e pjesëtarëve të tjerë që janë shumicë. Këto të drejta, pastaj mund të jenë edhe si të drejta individuale që realizohen individualisht dhe si të drejta kolektive që realizohen kolektivisht, apo në bashkësi me të tjerët. Pra, komunitetet pakicë, që jetojnë në bashkësi me të tjerët në Kosovë, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet të përfaqësuesve të zgjedhur marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes kur ka të bëjë me çështje që direkt i atakon interesat e tyre, apo edhe në kulturë, arsim, informimin e tyre etj.

¹⁶⁸Dokumenti i Kopenhagës për pjesëtarët e pakicave kombëtare garantohet e drejta për “pjesëmarrje në punët shtetërore duke përfshirë këtu edhe punët që kanë të bëjnë me mbrojtje dhe promovimin e identitetit të atyre pakicave, paragraf 35

¹⁶⁹Enver Hasani dhe Ivan Culakovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I, Dhjetor 2013 faqe. 220

Lidhur me përfaqësimin e komuniteteve pakicë të gjitha institucionet e Kosovës është përcaktuar një kornizë e gjerë ligjore nga aktet më të larta juridike e deri tek ato me të ulëtat dhe ato përfshijnë, siç u tha edhe më herët edhe organet e nivelit lokal ashtu edhe ato të nivelit qendror.

Pjesëmarrja e komuniteteve në jetën publike dhe vendimmarrëse trajtohet si element shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe shumë etnike, e një shoqërie për integritet, e cila çdo ditë e më tepër do të arrijë të krijojë një identitet të qëndrueshëm dhe konsistent. E drejta për pjesëmarrje të komuniteteve pakicë është e ndërlidhur ngushtë me standarde të tjera ndërkombëtare dhe të drejta tjera themelore, siç janë: barazia efektive, ruajtja dhe zhvillimi i kulturës së pakicave.¹⁷⁰

Pjesëmarrja efektive është parim i pranuar gjerësisht nga shumë standarde ndërkombëtare ligjore dhe politike, deklarata dhe rekomandime.¹⁷¹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, njeh të drejtën për pjesëmarrje të drejtë për drejtë apo të tërthortë në ushtrimin e punëve publike.¹⁷² Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave që i përkasin Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, njeh të drejtën për pjesëmarrje efektive në jetën publike¹⁷³ dhe Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e cila specifikon në mënyrë të qartë nevojën

¹⁷⁰ Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentet e Këshillit të Këshillëdhënës mbi Pjesëmarrjen efektive, paragrafi 13 i Konventës.

¹⁷¹ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë, 2009, faqe 3

¹⁷² Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Pakti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25

¹⁷³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata për të Drejtat e Personave që i përkasin Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, neni, 2.2

për pjesëmarrje efektive të pakicave në punë publike, e veçanërisht që ndikojnë drejtpërdrejtë tek ato.¹⁷⁴

Në kuadër të legjislacionit kosovar ekzistojnë një mori ligjesh të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë trajtojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Kosovë. Për shembull Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë,¹⁷⁵ i cili shprehimisht vendos dispozitat e përgjithshme mbi mbrojtjen e komuniteteve pakicë, me qëllim të sigurimit të barazisë së plotë dhe efektive për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre që jetojnë në Kosovë. Me dispozitat e këtij ligji po ashtu, sigurohet dhe garantohet mbrojtja e identitetit, kulturës, fesë, kujdesit shëndetësor, qasjes në sistemin arsimor si dhe pjesëmarrjes politike dhe asaj publike të këtyre komuniteteve pakicë në institucionet publike të vendit. Ky ligj, trajton po ashtu pjesëmarrjen politike të komuniteteve pakicë, në të dy nivelet e pushtetit: atij qendror dhe atij lokal.

Përveç këtij ligji, në kornizën ligjorë për trajtimin e komuniteteve pakicë përfshihet edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve¹⁷⁶ i cili vendos për përdorimin e barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe në gjithë territorin e Kosovës, si dhe parasheh po ashtu edhe kushtet dhe rrethanat në bazë të të cilave edhe gjuhët tjera të komuniteteve mund të përdorën në mënyrë zyrtare, qoftë në nivelin komunal apo edhe në atë nacional.

¹⁷⁴ Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtje të Pakicave Kombëtare, neni 15, 1995

¹⁷⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë, 2008

¹⁷⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, korrik 2006

Po ashtu, edhe Ligji Kundër Diskriminimit¹⁷⁷ si instrument ligjor për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, nga çdo lloj diskriminimi, posaçërisht kur bëhet fjalë për zhvillimin e karrierës së tyre dhe qasjes në vendin e punës. Së fundi, edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale¹⁷⁸ paraqet ligjin, përmes të cilit synohet të arrihet qëllimi në radhë të parë në avancimin e pozitës së komuniteteve pakicë në nivelin lokal, duke ju dhënë posaçërisht kompetenca shtesë atyre komunave, në të cilat jeton komuniteti serb si shumicë.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale i shpallur nga Presidenti i Kosovës, më 16 qershor 2008, nga aspekti i trajtimit të komuniteteve pakicë dhe pjesëmarrjes së tyre në qeverisjen lokale specifikon instrumentet vijuese institucionale të cilat përfshihen në kuadër të komunave të Kosovës, qoftë si mekanizma të detyrueshëm qoftë si mekanizma jo të detyrueshëm të pushtetit lokal e që janë:

a. Komiteti për Komunitete- është i mandatuar me status të komitetit të përhershëm. Kuvendet Komunale krahas komiteteve të tjera të përhershme janë të detyrueshme të themelojnë edhe Komitetin për Komunitete si një mekanizëm i përhershëm i kuvendeve komunale. Komiteti i Komuniteteve është paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/30 si një organ i përhershëm në kuadër të kuvendeve komunale. Pjesëmarrja e këtyre komuniteteve pakicë në mekanizmat e tillë të niveleve lokale është e ndikuar me ndryshimet politike, kryesisht me ndryshimet dhe miratimet e legjislacionit të ri në vitin 2008. Të gjitha komitetet që veprojnë në kuadër të kuvendeve komunale, përfshirë edhe Komitetin për Komunitete, sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë janë të obliguara

¹⁷⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit, 2004

¹⁷⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, 2008

që të përkujdesen, krahas tjerash edhe për baraspeshën gjinore. Komiteti për Komunitete si organ i obligueshëm brenda kuvendeve komunale, pothuajse është themeluar në mbarë Kosovën me përjashtim të tri komunave veriore të rajonit të Mitrovicës dhe në disa komuna të tjera, i cili organ de jure është themeluar por de facto deri në vitin 2009 nuk ka qenë funksional.¹⁷⁹

Këto komitete për komunitete kryesisht janë të themeluara nga këshilltarë të Kuvendeve Komunale mirëpo ka raste kur në përbërje të tyre mund të caktohen edhe individë që nuk janë këshilltarë të kuvendit, që realisht nënkupton përfaqësuesin e komuniteteve. Një gjë e cila duhet të jetë e sigurt për këto komitete për komunitete është përbërja shumë etnike e tyre, ku çdo komunitet i cili jeton në një komunë, përfaqësohet së paku me nga një anëtar të tij. Për dallim nga komiteti për ndërmjetësim, i cili nuk ishte paraparë më herët me legjislacionin për Vetëqeverisje Lokale, Komiteti për Komunitete funksionon si një organ i detyrueshëm i paraparë me ligj. Komiteti për Komunitete duke u mbështetur në legjislacionin e vendit, ka të drejtë të ju rekomandojë kuvendeve komunale masa të caktuara për të zbatuar dispozitat që lidhen me nevojat që i përkasin vet komuniteteve.

Masa të tilla të cilat u rekomandohen kuvendeve komunale zakonisht kanë të bëjnë me të drejtën e komuniteteve për të ruajtur, kultivuar dhe shprehur identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar e gjuhësor.¹⁸⁰ Pra, komuniteti shumicë që jeton në komunë duhet të ketë më

¹⁷⁹ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009 , faqe 1

¹⁸⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 53, 2008

pak se sa gjysmën e anëtarësisë së komitetit ndërsa pjesa tjetër e mbetur duhet të përfaqësohet nga komunitetet e tjera pakicë të cilat jetojnë brenda një komune.¹⁸¹

Përgjithësisht, komitetet për komunitete si mekanizma të përfaqësimit të komuniteteve mbetën njëri ndër organet kryesore të obligueshme për pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në nivelin lokal dhe se të gjitha komunat ku ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve po përpiqen të sigurojnë përfaqësime të barabarta për të gjitha komunitetet brenda komunës. Megjithatë, rezultati i përfaqësimit nuk është gjithëherë i kënaqshëm, posaçërisht, për ato komunitete të cilat numerikisht janë më të vogla dhe atyre komuniteteve ku niveli i shkollimit dhe vetëdijesimit të tyre për pjesëmarrje politike nuk është në nivelin e duhur, që në rastin konkret, kryesisht bëhet fjalë për komunitetin rom, egjiptian dhe ashkali i cili në proporcion me të tjerët është më pak i përfaqësuar.

Arsyet e një pengese të tillë siç u thanë edhe më lartë janë të ndryshme duke mos i përjashtuar në këtë rast mungesën e funksionalizimit të vet këtyre mekanizmave e deri tek mungesa e qartësisë së funksionit të këtij mekanizmi nga vet anëtarët e tij, që jo rrallëherë në këto organe nuk dinë të adresojnë as problemet me të cilat ballafaqohen vetë ata dhe kështu duke futur në agjendat e tyre probleme të cilat nuk janë në kompetencën e tyre, apo ndonjëherë këto organe merren edhe me probleme të ndikuara politikisht.

b. Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete- është post që zbatohet në komunat me strukturë të përzier etnike. Kuvendi Komunal nga mesi i anëtarëve të vet e zgjedh Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin. Formimin e pozitës së zëvendës kryesuesit të

¹⁸¹ Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNMIK, Rregullorja Nr. 2007/30 për Qeverisjen e Komunave në Kosove, neni 23 pika 2, 2007

kuvendit komunal për komunitete, ligji e ka paraparë si të obligueshëm vetëm në ato komuna ku komuniteti përbën së paku 10% të popullatës së përgjithshme të komunës.¹⁸²

Në rastet kur nuk arrihet ky prag, komunat kanë liri të veprimit që të vendosin vet zëvendës kryesuesin, nëse kjo konsiderohet e dobishme për mbrojtjen e komunitetit pakicë.¹⁸³ Pra, ky post i rezervohet përfaqësuesve të komuniteteve pakicë, kryesisht atij komuniteti i cili ka marrë më shumë vota në listën e kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës. Postet e zëvendës kryesuesit komunal për komunitete janë themeluar në (12) komuna të Kosovës, ndërkaq, themelimi i këtij mekanizmi me statutet e tyre është paraparë (14) prej tyre, ku (2) nga këto komuna kanë vendosur të shkojnë përtej autorizimeve ligjore duke krijuar kështu pozitën e zëvendës kryesuesit përkundër supozimeve që pragu prej (10%) në ato komuna nuk është arritur.¹⁸⁴ Këtë përqindje të pragut prej (10%), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, e konsideron si shumë të lartë, për të arritur që të sigurohet përfaqësim dhe pjesëmarrje efektive e komuniteteve pakicë.

Duke u nisur nga fakti se të gjitha komunitetet pakicë që jetojnë bashkërisht në Kosovë nuk përbëjnë as (10%) të popullatës së përgjithshme, pragu prej (10%) për minoritete¹⁸⁵ brenda një komune është shumë i favorshëm, mirëpo problemi i mungesës së mos arritjes së këtij pragu, sidomos tek komuniteti serb është ndarja dhe krijimi i komunave të reja me popullatë dhe vendbanime serbe duke krijuar kështu që një pjesë e popullatës që është shumicë në vend (siç është popullata shqiptare) të shndërrohet në pakicë brenda komunave

¹⁸² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 54 dhe 61, 2008

¹⁸³ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009 faqe 9

¹⁸⁴ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009, faqe 10

¹⁸⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale neni 54.1, 2008

të reja serbe të krijuara, si dhe copëtimin dhe shpërndarjen e numrit të banorëve dhe vendbanimeve të të gjitha komuniteteve brenda këtyre komunave duke mos e përjashtuar këtu as edhe komunitetin serb.

Pra, krijimi i komunave të reja në baza etnike, kur flasim për përfaqësimin e komuniteteve në përgjithësi e sidomos për komunitetin serb ka qenë e favorshme, ndërsa sa i përket përfaqësimit të këtyre komuniteteve në mekanizmat e komuniteteve në organet e pushtetit lokal, i ka dëmtuar ata deri diku, duke ulur numrin e popullatës me më pak se (10%) si një përqindje mjaft e favorshme për komunitetet në Kosovë, e cila është edhe e përcaktuar me ligje kur dihet se tanimë është shumë i vogël numri i komuniteteve pakicë që jetojnë brenda komunave.

Mekanizmi i zëvendës kryesuesit për komunitete përpiket të promovojë dialogun në mes të komuniteteve dhe është pika qendrore zyrtare themi më adekuate për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve pakicë në takimet e ndryshme të Kuvendit. Ai gjatë punës së vet zakonisht merret dhe është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të ndryshme të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet dhe vendimet e kuvendeve komunale mos t'i shkelin të drejtat e këtyre komuniteteve të garantuara edhe me Kushtetutë.

Të gjitha këto akte dhe vendime të cilat i merr zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës është i obliguar t'ia paraqes kuvendit komunal për rishqyrtim. Në rastet kur pjesëtarët e komunitetit nuk janë të kënaqur me vendimet e kuvendit komunal, dhe nga ana tjetër zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës, konsideron se rezultatet pas rishqyrtimit

paraqesin shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai ka të drejtë dhe mund të parashtrojë çështjen për zgjidhje në Gjykatën Kushtetuese.¹⁸⁶

Përgjithësisht, mund të themi se për mos krijimin e këtyre mekanizmave në shumë nivele komunale kanë ndikuar shumë faktorë, por, faktori kryesor është bojkotimi i vazhdueshëm i institucioneve të Kosovës nga ana e komunitetit serb për vite të tëra. Një gjendje jo e kënaqshme rreth përfaqësimit të komuniteteve në këtë mekanizëm, vërehet sidomos tek komunitetet e tjera siç janë romët, egjiptianët dhe ashkalinjtë që ekonomikisht janë më të marginalizuar në vend, ku dhe niveli i arsimimit dhe vetëdijesimit të tyre për tu integruar dhe për të arritur nivel më të lartë të përfaqësimit akoma është shumë i ulët.

c. Nënkryetari i Komunës për Komunitete- siç është thënë edhe në fillim me rastin e trajtimit të pozitës së zëvendëskryetarit të kuvendit të komunës për komunitete edhe nënkryetari i komunës për komunitete është një nga mekanizmat e tjerë të detyrueshëm i paraparë me legjislacionin në fuqi, i cili po ashtu parasheh ekzistimin e së paku (10%) të popullatës brenda një komune si komunitet i pakicës për të ekzistuar pozita e nënkryetarit të komunës për komunitete.¹⁸⁷ Sipas ligjit në fuqi, nënkryetari i komunës për komunitete, emërohet me mandat të njëjtë si të kryetarit të komunës. Roli kyç i nënkryetarit të komunës për komunitete është ofrimi i këshillave dhe udhëzime për kryetarin kur ka të bëjë me komunitete pakicë.

Në rastet kur nuk plotësohet ky kriter prej (10%) të popullatës pakicë atëherë çështja e themelimit të këtij mekanizmi kalon komplet në mundësinë e kuvendeve komunale dhe në

¹⁸⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 55,2008

¹⁸⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 61, 2008

nevojën dhe gjykimin e tyre që të vendosin vetë se a ka apo jo nevojë për themelimin e këtij mekanizmi.¹⁸⁸

Për më tepër, lidhur me procedurat e emërimit, përgjegjësi dhe shkarkimit të nënkryetarëve të komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vitin 2014 ka nxjerr një Udhëzim Administrativ¹⁸⁹ me të cilin përveç tjerash parashihen edhe procedurat për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete dhe përveç kushteve të përmendur më lartë, është përcaktuar se nënkryetari i komunës për komunitete, nga radhët e komuniteteve pakicë propozohet nga kryetari i komunës dhe emërohet me vendim të kuvendit të komunës, nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, si dhe shumica e anëtarëve të kuvendit të komunës që janë të pranishëm dhe votojnë dhe të cilët i përkasin komuniteteve pakicë.¹⁹⁰

Një gjë e cila është e rëndësishme të themi lidhur me këtë mekanizëm është se për shkak të paqartësisë së vetë këtij pozicioni dhe përshkrimit të detyrave të tij, këta nënkryetarë të komunave nuk veprojnë në mënyrë unike në lidhje me minoritetet në Kosovë dhe se edhe ndikimi i këtij posti është edhe më i vogël dhe me pak funksional se sa ajo çfarë duhet të jetë në realitet.¹⁹¹ Roli kryesor dhe i vetëm për nga mekanizmat e tjerë që merret me çështjen e komuniteteve është posti i nënkryetarit të komunës për komunitete sepse

¹⁸⁸ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009 faqe 1 dhe 12

¹⁸⁹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve të Komunave

¹⁹⁰ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve të komunave, neni 4, 2014

¹⁹¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, me nenin 61 .4 të ligjit janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e këtij mekanizmi, detyra këto të cilat herë herë bien ndesh me detyrat e zëvendës kryetarit të Komunës sipas nenit 55 të po këtij ligji.

nëpërmes këtij mekanizmi pjesëtarët e komunitetit pakicë arrijnë që t'i paraqesin brengat dhe shqetësimet e tyre në mënyrë institucionale dhe direkt tek Kryetari i Komunës si organi më i lartë ekzekutiv në nivelin komunal.

d. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi- është një mekanizëm tjetër i detyrueshëm i cili vepron në nivelin komunal dhe i cili është paraparë në fillim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54 dhe më vonë edhe me Ligjin për Policinë të vitit 2008. Mandati i këtij këshilli është ndërtimi i besimit mes policisë dhe komunitetit si dhe arritja e vetëdijesimit të komunitetit në nivel lokal, identifikimi i problemeve me qëllim të rekomandimit të planeve për të zgjidhur problemet me të cilat hasen tek komuniteti.

Ky mekanizëm është themeluar pothuajse në të gjitha Komunat e Kosovës sipas Ligjit mbi Policinë e Kosovës nga viti 2008¹⁹² i cili kërkon përfshirjen e të gjitha komuniteteve që banojnë brenda një territori të komunës edhe pse disa komuna dështojnë në arritjen për të siguruar përfaqësimin e drejtë të komuniteteve. Aktet nënligjore të nxjerra me vonë për këtë qëllim i definojnë edhe më shumë mënyrën e themelimit të këtyre këshillave si dhe procedurat se si duhet të veprojnë ata këshilla dhe se si do të përfaqësohen komunitetet në këta këshilla për siguri.

Duke u nisur nga fakti se këta këshilla për siguri në bashkësi janë paraparë që të themelohen edhe me ndryshimet legislative të fundit, mund të konsiderohet se ky është një rast i mirë për të rritur përfaqësimin e komuniteteve në këto këshilla dhe arritjen e zgjidhjes së shumë problemeve me të cilat ata mund të përballen edhe në të ardhmen si komunitet.

¹⁹² Kuvendi i Kosovës, Ligji 04/L-076 mbi Policinë, neni 7, 2012

e. Zyrat komunale për komunitete - kanë qenë mekanizëm jo i detyrueshëm të cilat janë themeluar në 26 komunat të cilat kanë funksionuar para miratimit të ligjit për vetëqeverisje lokale të vitit 2008.¹⁹³ Rezultatet e formimit dhe funksionimit të këtyre zyrave i atribuohen punës së OSBE-së, e cila kishte për qëllim që sa më shumë të forconte mekanizmat e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve pakicë në jetën publike. Tani për tani ky mekanizëm është themeluar me anë të një rregulloreje¹⁹⁴ e cila ka për qëllim që të sigurojë që komunat nga fushëveprimi i kompetencave të tyre dhe sipas nevojave të komuniteteve pakicë që jetojnë në territorin e tyre, të krijojnë struktura adekuate për të promovuar të drejtat e komuniteteve, qasje të barabartë në shërbime publike dhe kthim dhe riatdhesim të të gjitha komuniteteve.

Pra, siç po shihet vendimi mbi ruajtjen, funksionimin, organizimin dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të këtyre zyrave të formuara ka qenë komplet në diskrecion të komunës e cila e ka themeluar. Për këtë qëllim një numër i konsiderueshëm i komunave, këto zyre komunale për komunitete, i kanë përfshirë si mekanizma në statutet e tyre përkatëse, duke siguruar kështu një bazë të mire ligjore të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve.¹⁹⁵ Në këto zyra komunale të komuniteteve, në disa komuna nuk pasqyrohet përbërja etnike e komuniteteve që jetojnë aty si p.sh romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët që futen në grupin e komuniteteve më të nën përfaqësuar.

¹⁹³ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë Mbrojtja dhe Promovimi I të Drejtave dhe Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009, faqe 1

¹⁹⁴ Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, 2010

¹⁹⁵ Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë Mbrojtja dhe Promovimi I të Drejtave dhe Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal, Dhjetor 2009, faqe 2

Zyrat komunale për komunitete në përgjithësi funksionojnë mirë megjithatë mbetet akoma për të dëshiruar rreth mënyrës së funksionimit dhe përfaqësimit të komuniteteve. Qëllimi i këtyre zyrave para se gjithash është identifikimi, promovimi, zbatimi dhe mbikëqyrja politike e programeve përkatëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë.

Zyrat komunale për komunitete kanë një bashkëpunim të mirë me zëvendëskryetarin për komunitete, drejtoritë komunale, zëvendës kryesuesin e Kuvendit Komunal për Komunitete dhe me Komitetin Komunal për Komunitete, ndërsa në nivelin qendror këto zyre kanë bashkërendim të aktiviteteve me njësitë përkatëse në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrinë për Punë të Brendshme, Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale etj.¹⁹⁶

Normalisht, për tu themeluar këto zyra komunale për komunitete, komunës i duhet përmbushja e disa kriterëve si: përqindja e pjesëtarëve që u takojnë komuniteteve pakicë dhe që banojnë në atë komunë, numri i komuniteteve në komune, shpërndarja gjeografike e komunitetit brenda asaj komune dhe lindja e nevojës për të siguruar shërbime më afër komuniteteve të izoluara dhe rurale etj. Kryetari i Komunës këto zyre komunale si dhe numrin e posteve të këtyre zyrave për komunitete i formon sipas rekomandimeve që i jep Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Politike dhe Financa.

Detyrat kryesore të këtyre zyrave komunale për komunitete mbesin ofrimi i këshillave për organet përkatëse të degës së ekzekutivit, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, ofrimi i një qasje të drejtë dhe të barabartë për të

¹⁹⁶Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, neni 4, 2010

gjitha komunitetet në shërbime publike, identifikimi i nevojave parësore të komuniteteve pakicë etj.

f. Zyrat Komunale për Kthim- ashtu sikurse zyrat komunale për komunitete edhe zyrat komunale për kthim janë themeluar gjatë Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe kanë funksionuar nga viti 1999 deri në vitin 2008,¹⁹⁷ si mekanizma jo të detyrueshëm, ndërsa më vonë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, konkretisht, me nxjerrjen e Rregullores për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim¹⁹⁸ në vitin 2010 këto zyre u shndërruan në mekanizma të detyrueshëm për mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë.

Pra, siç po shihet sikurse zyrat komunale për komunitete edhe zyra për komunitete dhe kthim janë ruajtur së funksionari si një mekanizëm i domosdoshëm pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës. Mirëpo ri themelimi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim si një mekanizëm i ri institucional i domosdoshëm për promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe krijimin e kushteve për ri-integrim është bërë që nga gushti i vitit 2010.¹⁹⁹ Kushtetuta e Kosovës kërkonte që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të krijojnë kushte të përshtatshme për komunitete pakicë, në mënyrë që ata t'i gëzojnë të gjitha të drejtat në mënyrë të barabartë me të gjithë të tjerët si dhe të krijohen kushte për një kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të refugjateve dhe personave të zhvendosur.

¹⁹⁷ UNMIK, Rregullorja Nr. 2000/45, me anë të cilës janë themeluar Zyrat komunale për komunitete dhe Zyrat komunale për Kthimin e komuniteteve.

¹⁹⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, 2010

¹⁹⁹ Zyra komunale për Komunitete dhe Kthim në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, faqe 6

Detyrat kryesore të këtyre zyrave komunale për komunitete dhe kthim janë hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projekteve në funksion të ri integritit të zhvendosurave. Ato janë përgjegjëse gjithashtu që të kontribuojnë në bashkëpunimin me institucionet e nivelit qendror për krijimin e kushteve për refugjatët të cilët duan të riatdhesohen dhe të gëzojnë shërbimet adekuate publike dhe integrimin e tyre. Ndërkaq, në nivelin lokal ato i ofrojnë personave të riatdhesuar informata për ndihmë në plotësim dorëzimin e kërkesave për përfitime nga programi pranë Komisionit Komunal për Ri integrim.²⁰⁰

Pra siç u tha dhe më herët, zyrat komunale për kthim sikurse zyrat komunale për komunitete janë themeluar me Rregulloren²⁰¹ e Qeverise të vitit 2010 e cila kërkon që të gjitha komunat të krijojnë strukturat adekuate administrative si zyrat komunale për komunitete dhe kthim, me anë të të cilave mund të bëhet mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve, të arrihet një qasje më e barabartë e komuniteteve në shërbime publike si dhe krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të personave të zhvendosur dhe të riatdhesuar.²⁰²

Zyra komunale për kthim të komuniteteve për të arritur qëllimet e veta për çfarë edhe ato në të vërtetë funksionojnë, kanë një bashkëpunim të mirë në nivelin lokal përveç me institucione të përgjithshme komunale edhe me Kryetarin e komunës dhe mekanizmat e tjerë të komuniteteve por edhe në nivelin qendror duke përfshirë Zyrën për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e

²⁰⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.10/2012 për Menaxhimin e Programit, organet Kompetente, Procedurat dhe Kriteret e Përfitimit për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar, 2012

²⁰¹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

²⁰² Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 156, 2008

Komuniteteve dhe Kthimit në kuadër të Legjislativit, si dhe Këshillin Konsultativ për Komunitete që funksionon në kuadër të Zyrës së Presidentit.

Ndërkaq, përmes Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 16 qershor 2008, mundësohet garantimi i barazisë së plotë dhe efektive për të gjithë qytetarët e Kosovës pavarësisht etnisë, gjuhës, kulturës, besimit fetar duke i konsideruar të gjithë si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie që bazohet në sundimin e ligjit. Në këtë drejtim, Kosova ndërmerr masat të veçanta për të siguruar këtë barazi ndërmjet komuniteteve të ndryshme pakicë që jetojnë në Kosove.

Me dispozitat e këtij Ligji, komuniteti përkufizohet si grup kombëtar, etnik, kulturor, linguistik apo fetar që tradicionalisht është i pranishëm në Republikën e Kosovës dhe që nuk është në shumicë. Statusin e pakicës në Kosovë e gëzojnë pjesëtarët e komunitetit serb, turq, boshnjak, rom, ashkalinjë, egjiptas, goran dhe komunitete të tjera. Shqiptarët i gëzojnë po ashtu të drejtat e specifikuara në këtë ligj, në komunat ku ata nuk janë në shumicë.²⁰³

Komunitetet kanë të drejtë t'i ruajnë, shprehinë dhe të zhvillojnë lirshëm kulturën dhe identitetin e tyre dhe elementet e tyre thelbësore: fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore,²⁰⁴ përfshirë ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut të radhitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve në

²⁰³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1, 2008

²⁰⁴ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 2.1, 2008

edukimin publik në të gjitha nivelet, në gjuhën zyrtare që e zgjedhin vetë. Pra, pjesëtarët e komunitetit e kanë të drejtën në edukimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre, madje edhe nëse kjo nuk është gjuhë zyrtare. Kur brenda komunës numri i nxënësve që i takojnë një komuniteti nuk është i mjaftueshëm për ta mundësuar procesin edukativ, Qeveria e Kosovës është e obliguar për të ofruar alternativa të reja (transportin e subvencionuar në një zonë ku ofrohet një shkollim i tillë, mësimi në distancë, aranzhimet me mësimdhënës udhëtues, apo ofrimi i konvikteve).

Përveç tjerash, emrat personal të pjesëtarëve të komuniteteve njihen në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin origjinal të gjuhës së tyre. Emrat familjarë dhe emrat e fëmijëve të pjesëtarëve të komuniteteve zgjedhën lirshëm dhe hyjnë si të tillë në regjistrat publik, në identifikimin personal dhe në dokumentet e tjera zyrtare në gjuhën dhe në shkrimin e komunitetit²⁰⁵.

Në vazhdim ky ligj përcakton qartë se Republika e Kosovës duhet ta promovojë përmes masave të ndryshme afirmative, barazinë e plotë dhe të efektshme të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, përfshirë edukimin, mediumet, përkujdeseni shëndetësor dhe shërbimet e tjera publike. Në këtë drejtim, përveç dispozitave të përcaktuara me ligjin special mbi përdorimin e gjuhëve në Kosovë edhe ky ligj rikujton faktin se gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe trajtohen në mënyrë të barabartë në institucionet publike të

²⁰⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 2.4, 2008

Kosovës.²⁰⁶ Ndërsa, gjuhët e komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivele komunale dhe lidhur me to zbatohen dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Sa i përket pjesëmarrjes politike të komuniteteve pakicë që jetojnë në Republikën e Kosovës, ligji në fjalë ka përcaktuar se pjesëtarët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë kanë të drejtë përfaqësimi të drejtë në vendimmarrje politike në të gjitha nivelet e qeverisjes, përmes përfaqësimit të tyre qoftë në organin legjislativ (kuvend), në qeveri, gjyqësor dhe në organet dhe institucionet tjera të Kosovës. Në këtë drejtim, siç u vërejt edhe më lartë, përfaqësimi i komuniteteve pakicë në Kosovë në organet e pushtetit lokal garantohet përmes Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili, përveç tjerash, siç u shpjegua përfshin edhe themelimin e zyrës së Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete dhe të Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete.

Gjithashtu, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, me qëllim të promovimit sa më efektiv të të drejtave të komuniteteve pakicë, krahas ndërmarrjes së masave tjera afirmative ka paraparë edhe themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitetet, si një këshill i cili do të funksionojë brenda Zyrës së Presidentit të Kosovës, që për synim parësor do të ketë organizimin dhe artikulimin e pikëpamjeve të komuniteteve pakicë që jetojnë në Republikën e Kosovës si dhe të pjesëtarëve të tyre në lidhje me çështjet legjislative, politikat dhe programet e ndryshme që ndërldihen me statusin dhe të drejtat e tyre. Për më tepër, vet ky ligj ka përcaktuar edhe

²⁰⁶Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 4.1, 2008

përbërjen e këtij këshilli i cili siç kemi theksuar me herët gjatë këtij punimi është themeluar në vitin 2008 në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës dhe është i përbërë nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, nga përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe përfaqësues nga agjenci tjera relevante të themeluara për zbatimin e ligjit.

Kur është fjala për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve²⁰⁷ përmes dispozitave të tij sigurohet përveç tjerash e drejta e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor. Në këtë drejtim, me dispozitat e këtij ligji sigurohet status i barabartë i gjuhës shqipe dhe asaj serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, si dhe të drejta të barabarta sa i përket zbatimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës.²⁰⁸ Ndërkaq, gjuhët zyrtare në komuna janë të përcaktuara po ashtu me dispozitat e këtij Ligji i cili e përkufizon gjuhën zyrtare në komunë si gjuhën e komunitetit e cila nuk është zyrtare, kur ky komunitet e përbën të paktën (5%) të popullatës së komunës njësoj si dhe përdorimin e barabartë me gjuhët zyrtare.

Dispozitat ligjore të këtij ligji përcaktojnë po ashtu, që në Komunën e Prizrenit, gjuha turke e ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë. Kur një komunitet brenda komunës e paraqet mbi (3%) të popullatës së saj dhe gjuha e tij nuk është gjuhë zyrtare, atëherë, kjo gjuhë e ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në komunë. Po ashtu, ky ligj ia jep të njëjtin status të gjuhës në përdorim zyrtar në komunë, gjuhëve të komuniteteve të cilat janë folur tradicionalisht në një komunë.

²⁰⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, korrik 2006

²⁰⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, neni 1, korrik 2006

Përmes këtij ligji arrihet të sigurohet barazia në përdorimin e gjuhëve zyrtare në të gjitha institucionet e Kosovës. Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të komunikojë dhe të pranojnë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore në cilën do gjuhë zyrtare që aplikohet në Kosovë. Prandaj ligji i obligon të gjitha institucionet publike që të sigurojnë që secili qytetarë ta gëzojë këtë të drejtë ligjore.

Po ashtu, dispozitat e këtij ligji e caktojnë barazinë e gjuhëve zyrtare të komunës në institucionet komunale, në komunikim, si dhe në ofrimin e shërbimeve dhe të dokumenteve publike, në cilëndo nga gjuhët zyrtare. Çdo person mund të komunikojë dhe t'i marrë të gjitha shërbimet dhe dokumentet, nga çdo institucion apo organ komunal, në çdo gjuhë zyrtare.²⁰⁹ Barazia e gjuhëve zyrtare vlen për takimet dhe punimet e të gjithë trupave komunalë. Kur të kërkohet, interpretimi nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën është i detyrueshëm për të gjitha takimet e të gjithë trupave komunalë. Regjistrimet, regjistrat publikë dhe dokumentet e tjerë zyrtarë, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare.

Për më tepër, ligji mundëson që madje edhe gjuhët që nuk janë zyrtare në komunë, mund të përdoren lirshëm nga pjesëtarët e komuniteteve përkatëse në punën dhe në takimet komunale dhe që pajisjet për përkthim duhet të vihen në dispozicion sa herë që të kërkohet²¹⁰. Dokumentet e dorëzuara nga pjesëtarët e tillë do të përkthehen në gjuhët zyrtare dhe përgjigjet do të jepen në gjuhën origjinale dhe po ashtu dispozitat ligjore përcaktojnë që emrat dhe shenjat zyrtare të institucioneve komunale duhet të paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët zyrtare të komunës.

²⁰⁹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, neni 7.1, korrik 2006

²¹⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, neni 8.4, korrik 2006

Në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre, ligji për përdorimin e gjuhëve ka përcaktuar obligimin jo vetëm për institucione publike të nivelit qendror dhe lokal për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhëve zyrtare, por që barazia e gjuhëve zyrtare vlen edhe për Ndërmarrjet në Pronësi Publike dhe për Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore. Kjo e përfshin të drejtën për të komunikuar dhe për të marrë shërbime dhe dokumente nga këto ndërmarrje në çdonjërin nga gjuhët zyrtare. Detyra për ta siguruar këtë të drejtë i takon Ndërmarrjeve në Pronësi Publike dhe atyre Shoqërore.

Po ashtu, edhe Ligji kundër Diskriminimit i miratuar në vitin 2004, duke pasur për bazë rëndësinë e përkrahjes së bashkëjetesës, mbrojtjes të të drejtave të njeriut, përfaqësimit të drejtë të popullit të Kosovës në procesin e ngritjes dhe zhvillimit të institucioneve demokratike të vetëqeverisjes, sigurimin e trajtimit të barabartë dhe duke siguruar që nxjerrja e rregullave mbi këto çështje të jetë në përputhje me standardet dhe normat përkatëse Evropiane dhe ndërkombëtare, ka për qëllim parandalimin dhe njëkohësisht luftimin e diskriminimit, ngritjen e shkallës së barazisë efektive në funksion të implementimit të parimit të përgjithshëm për trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Pra, me dispozitat e këtij ligji, rregullohen çështje që kanë të bëjnë me mos diskriminimin duke u mbështetur në parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual,

kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet si dhe në parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

Sipas dispozitave të këtij ligji organ i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave në baza diskriminuese është Avokati i Popullit i Kosovës, i cili do t'i shqyrtojë rastet në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë që ka sipas legjislacionit në fuqi.

6.1 Aspekte krahasuese të legjislacionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në vendet e rajonit

Duke marrë parasysh faktin se lindja e shteteve të reja nga ish Jugosllavia është si rezultat i një shthurje të përgjakshme të kësaj federate, kjo ka bërë që të trashëgohet edhe një mosbesim dhe armiqësi ndërmjet komuniteteve etnike shumicë dhe komuniteteve etnike pakicë në këto vende. Pavarësisht se ka progres në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre vendeve, prapëseprapë themi se ekziston ende një shkallë mosbesimi në marrëdhëniet ndërmjet tyre, për faktin se akoma mbizotëron frika e shfrytëzimit të komuniteteve pakicë nga vendet fqinje për qëllime të ndryshme të instrumentalizimit të pakicave për interesa të shteteve amë

Kur flasim për vendet e rajonit, mund të thuhet se të gjitha ato, përveç Shqipërisë dhe Malit të Zi, kanë kaluar përmes konflikteve të përgjakshme etnik. Në këtë mënyrë, pozicionimi i komuniteteve pakicë në këto vende u bë njëra ndër postulatet kryesore që e karakterizuan periudhën e tranzicionit të këtyre shteteve nga shoqëritë me sistem komunist, në shoqëritë demokratike. Varësisht prej shteti, e edhe periudha e këtillë transitore, është përcjellë në forma të ndryshme. Përderisa, në Kroaci, Bosnje, Kosovë, Maqedoni e deri diku edhe në Serbi, pozicionimi i komuniteteve etnike pakicë është adresuar përmes negociatave të organizuara dhe të monitoruara nga bashkësia ndërkombëtare, ndërsa, për dallim nga këto Shqipëria dhe Mali i Zi, pozitën e komuniteteve pakicë që jetojnë në ato vende, e kanë përcaktuar përmes reformave të brendshme, ani pse edhe në ato reforma në një formë apo tjetrën ka pasur ndikime nga faktori ndërkombëtar.

Kur bëhet fjalë për çështjen e përfaqësimit të komuniteteve pakicë që jetojnë në vendet e rajonit, vërehet se një përcaktim i këtillë nuk mund të thuhet se është i parapare në vendet tjera të rajonit, me përjashtim të Kroacisë apo të Republikës së Kosovës, e cila sa i përket përfaqësimit të komuniteteve pakicë të cilat jetojnë në territorin e saj është vendi më i avancuar. Mjafton të merret për baze vetëm fakti i përfaqësimit të pakicave në Kuvend nga (120) ulëse në parlament, (20) prej tyre janë të garantuara.

6.1.1. Kroacia

Duke marrë parasysh pretendimet e Kroacisë për integrim në BE, dhe në struktura euro-atlantike, asaj i'u imponua që të nxjerrë një legjislacion dhe të përmbush në praktikë të drejtat e komuniteteve pakicë e të cilat quan në krijimin dhe aplikimin e politikave të avancuara për këto komunitete, me qëllim të integritit në shoqërinë kroate. Në këtë

mënyrë fillimisht u miratua Ligji për Shfrytëzimin e Gjuhës dhe Shkrimit të Minoriteteve Nacionale në Republikën e Kroacisë, si dhe Ligji i ri Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve i cili krijoi një kornizë normative gjithëpërfshirëse për të drejtat e minoriteteve në Kroaci. Me këtë ligj, pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare në Kroaci u garantohej e drejta në përfaqësim në të gjitha organet përfaqësuese të vetëqeverisjes lokale dhe në ato të vetëqeverisjes rajonale.²¹¹

Sipas Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve në Kroaci, komuniteteve pakicë, numri i të cilëve tejkalon 8% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kroaci, i garantohej përfaqësimi proporcional në Parlamentin e Kroacisë dhe po ashtu i garantohej edhe përfaqësimi në mënyrë proporcionale në Qeverinë kroate si dhe në sistemin gjyqësor. Ndërkaq, bazuar në Ligjin për Zgjedhjen e Përfaqësuesve në Parlamentin Kroat, pjesëtarët e komuniteteve etnike pakicë që jetojnë në Kroaci dhe që numri i tyre është në kuotën nën 8% nga numri i përgjithshëm i popullsisë kroate, e kanë të drejtën për të zgjedhur, së paku (5) dhe më së shumti shtatë (7) përfaqësues të tyre në Dhomën Përfaqësuese të Parlamentit Kroat.²¹²

Vlen të theksohet se Republika e Kroacisë, viteve të fundit ka arritur një avancim të madh në sistemin për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, duke i inkorporuar këto të drejta në legjislacionin e vet dhe duke i dhënë një trajtim shumë të veçantë pikëpamjeve që ndërlidhen me komunitetet pakicë që jetojnë në Kroaci.

²¹¹ Constitutional Law on the Rights of National Minorities, Article 19 and 20

²¹² Constitutional Law on Human Freedoms and Rights and Rights of Ethnic and National Minorities, 2000, Article 17

6.1.2. Mali i Zi

Mali i Zi gjatë rrugëtimit të vet nga shpërbërja e federatës jugosllave deri tek pavarësia saj ka kaluar nëpër tri faza të rëndësishme; së pari gjatë periudhës 1992-2003 në kuadër të Republikës së mbetur Federale të Jugosllavisë, pastaj deri në vitin 2006 në kuadër të Unionit Shtetëror Mali i Zi dhe Serbi dhe së fundi nga viti 2006 si shtet i pavarur, ku edhe pozita e komuniteteve pakicë në këtë vend ka reflektuar sipas këtyre etapave.

Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të popullsisë në vitin 2011 në Mal të Zi jetojnë 45% malazezë, 29% serb, 9% boshnjak dhe 5% shqiptar.²¹³. Pavarësisht këtij fakti, edhe pse serbët marrin pjesë me siç u tha rreth 29% të numrit të përgjithshëm të popullatës në Malit të Zi, prapëseprapë edhe ata konsiderohen si komunitete pakicë në këtë shtet dhe në parim janë të shpërndarë, pothuajse në gjithë territorin e Malit të Zi. Edhe pse ata janë shumicë absolute në tri komuna dhe janë shumicë relative edhe në tri komuna të tjera të vendit.

Edhe pse komuniteti pakicë shqiptar në këtë shtet nuk është aq i madh numerikisht, duhet theksuar se sa i përket marrëdhënieve ndëretnike në Mal të Zi, pozita e tij dhe shkalla e bashkëpunimit me shoqërinë shumicë është shumë më e mirë sesa në rastin e komunitetit shqiptar të Kosovës gjatë periudhës para vitit 1999, apo edhe më e mirë se pozita e shqiptarëve në Maqedoni apo edhe në Serbinë Jugore.

Me Ligjin mbi të Drejtat dhe Liritë e Minoriteteve në Mal të Zi, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2006, në nenin 23 të saj, ishte përcaktuar se me legjislacionin mbi zgjedhjet, me qëllim të zbatimit të parimit mbi afirmimin e minoriteteve, ishte parapare sigurimi i numrit

²¹³ Population by Age and Ethnicity, Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro

shtesë të mandateve për kuvend për përfaqësues të minoriteteve. Në këtë aspekt, komunitetet pakicë të cilat në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Mal të Zi, sipas regjistrimeve të fundit zyrtar përbënin (1-5%), të cilët do të ishin të përfaqësuar në kuvend të Malit të Zi me një mandat deputeti, përveç atyre të zgjedhur sipas listave zgjedhore. Minoritetet që përbënin mbi 5% të numrit të përgjithshëm të popullsisë sipas regjistrimit të fundit zyrtar, do të kishin tri vende të garantuara për deputet të kuvendit, përveç mandateve të fituara nga listat zgjedhore.

Po ashtu, sipas të njëjtit ligj në nivel lokal, në kuvendet komunale ishte paraparë zgjedhja e një përfaqësuesi të komuniteteve pakicë nëse ai komunitet merr pjesë në numrin e përgjithshëm të popullatës në atë komunë prej (1-5%). Megjithatë, të dy këto dispozita ligjore, me vonë janë anuluar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi,²¹⁴ ku thuhet se ato dispozita nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Malit të Zi dhe se të njëjtat janë shfuqizuar ditën e publikimit të këtij Vendimi të Gjykatës në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi.

Në vitin 2011 me miratimin e Kodit të ri Zgjedhor në Mal të Zi, u vendos që minoritetet e në këtë rast edhe shqiptarët në Mal të Zi të përfaqësohen në parlamentin e vendit dhe të bëheshin parti parlamentare, ne rastin ata kalonin pragun zgjedhor i cili me ligjin e ri zgjedhor është 3%.

²¹⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 51/06)

6.1.3. Serbia

Kur flitet për Serbinë, mund të thuhet lirisht se shpërbërja e ish Jugosllavisë dhe luftërat që e përcollën atë shpërbërje, ndryshuan rrënjësisht konfiguracionin etnik në këtë vend. Së pari, vendosja e qindra mijëra serbëve në Serbi të ardhur nga Kroacia dhe Bosnja dhe po ashtu edhe zhvendosja e një numri mjaft të madh të serbëve nga Serbia në Kosovë bënë që përqindja serbeve në Serbi dhe Kosovë të rritet nga dyndjet si pasojë e luftërave. Edhe përkundër kësaj, dy komunitetet më të rëndësishme pakicë në Serbi, flasim nga aspekti i raporteve të tensionuara ndëretnike mbasin shqiptaret të cilët janë të përqendruar në Luginën e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës si dhe boshnjakët të cilët janë të përqendruar kryesisht në rajonin e Sanxhakut.

Sa i përket përfaqësimit të minoriteteve në Kuvendin e Republikës së Serbisë, me kushtetutë është përcaktuar, përveç tjerash se në Kuvendin popullor sigurohet përfaqësim i barabartë për gjinitë dhe për përfaqësues të komuniteteve pakicë në përputhje me ligj.

Megjithatë, sa i përket përfaqësimit në praktikë të minoriteteve në organin legjislativ të Serbisë kjo është një çështje len për të dëshiruar. Sa për ilustrim, romët si komunitet pakicë në Republikën e Serbisë nuk janë përfaqësuar në përbërjen e kuvendit që nga viti 2008. Përfaqësimi i minoriteteve në Serbi, është i lidhur ngushtë me ndryshimi i ligjit për zgjedhjen e deputetëve, të viti 2003.²¹⁵ Ku si masa të diskriminimit pozitiv, përveç që u vendosën kuotat sa i përket përfaqësimit gjinor, për herë të parë u sollën edhe masa të diskriminimit pozitiv për komunitete pakicë, përmes heqjes së pragut zgjedhor prej 5%. Me dispozitat e këtij ligji thuhet se subjektet politike të komuniteteve pakicë si dhe koalicionet

²¹⁵ Ndryshim plotësim i Ligjit mbi përzgjedhjen e deputeteve në Serbi, 2003

e partive minoritare marrin pjesë në ndarjen e mandateve edhe në rastet kur kanë fituar më pak se 5% të votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar.

Vlen të theksohet se para ndryshimeve ligjore, asnjëra nga partitë politike të komuniteteve pakicë nuk ka hyrë në parlament. Si rezultat i këtyre ndryshimeve për prapun zgjedhor, në përbërjen e parlamentit serb, subjektet e komuniteteve pakicë në Serbi në zgjedhjet vitit 2007 fituan (8) mandate ndërsa në vitin 2008 fituan (7) mandate. Në drejtim të zbatimit të masave të diskriminimit pozitiv për komunitetet pakicë Kushtetua e re e Republikës së Serbisë, për dallim nga Kushtetuta e vitit 1990, për herë të parë e njeh kategorinë e të drejtave minoritare dhe përcaktohet për masat e tilla afirmative për grupet minoritare.

Megjithatë dihet se Serbia është nënshkruese dhe ratifikuar konventat dhe marrëveshjet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, pas së gjithash ka nënshkruar Konventën Kornize për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve në vitin 2001.

6.1.4. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM)

Si rezultat i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e nënshkruar në gusht të vitit 2001, politika dhe rendi juridik i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë pësoi ndryshime substanciale, krahas qëllimit primar që kishte nënshkrimi i asaj marrëveshje për ndërprerjen e konfliktit. Kjo marrëveshje kishte paraparë reforma rrënjësore në fushën e decentralizimit, në fushën e sigurimit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të komuniteteve pakicë që jetojnë në këtë republikë, në fushën e arsimit, përdorimit të gjuhëve etj.

Çështja e përfaqësimit të drejtë të komuniteteve ka qenë shumë e rëndësishme dhe ka mbizotëruar temat e bisedimeve gjatë përgatitjes së kësaj marrëveshje kornizë. Si rezultat i kësaj marrëveshje, në pikën 4 ishte specifikuar qartë se me këtë marrëveshje do të respektohet parimi i mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të të gjithë personave para ligjit. Ky parim, gjeti aplikim sidomos në raport me punësimet në administratën publike dhe në ndërmarrje publike, financimi publik si dhe në zhvillim e aktiviteteve afariste.

Po ashtu, në vazhdim të kësaj pike me ligj ishte i paraparë rregullimi i çështje së punësimit në administratën publike, përfaqësimi i drejtë i bashkësive në të gjitha organet qendrore, lokale e publike dhe në të gjitha nivelet e punësimit, gjithmonë duke respektuar rregullat e kompetencës dhe integritetit, me të cilët udhëhiqet administrata publike. Sa i takon Gjykatës Kushtetuese ishte parapare që 1/3 e gjykatësve do të zgjidhet nga kuvendi me shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve që do të përmbajë shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve të cilët pohojnë se i takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni. Kjo procedurë do të aplikohet edhe gjatë zgjedhjes së Avokatit Popullor dhe tre anëtarëve të këshillit gjyqësor.²¹⁶

Si rrjedhojë e miratimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, para institucioneve shtetërore të Republikës së Maqedonisë u shtrua nevoja për një sërë ndryshimesh kushtetuese, të cilat u pasuan me një varg ndryshimesh ligjore. Këto ndryshime, një formë apo tjetrën ishin të ndërlydhura me çështjen e rregullimit të përfaqësimit të drejtë të komuniteteve pakicë që jetojnë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë drejtim, me amendamentet kushtetuese, u inkorporua parimi i përfaqësimit të drejtë të qytetarëve të komuniteteve

²¹⁶ Marrëveshja Kornize e Ohrit e miratuar me 13 gusht 2001 në Ohër

pakicë nëpër institucionet shtetërore si dhe në institucione tjera publike përfshirë të gjitha nivelet e pushtetit.

Siç u theksua më sipër, përveç ndryshimeve të nevojshme kushtetuese, parimi i përfaqësimit të drejtë, gjeti shprehje edhe në një varg ndryshimesh ligjore dhe akte tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fusha të ndryshme të jetës shoqërore, politike, sociale, ekonomike etj. Në këtë vështrim, sa i përket sistemit të drejtësisë, gjegjësisht sistemit gjyqësor, parimi i përfaqësimit të drejtë vjen në zbatim gjatë procesit të emërimit të gjykatësve dhe gjykatësve porotë si dhe prokurorëve publikë.

Po ashtu, parimi i përfaqësimit të drejtë gjen zbatim edhe gjatë punësimit të nëpunësve shtetëror dhe civil, nëpërmes një procesi transparent dhe bazuar në merita dhe profesionalizëm. Për më tepër, përmes këtij ligji institucionet publike janë të obliguara të përpilojnë plane të veçanta vjetore, për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe adekuat nëpër institucionet e tyre. Edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale, gjithashtu i kushton një rëndësi të veçantë përcaktimit me dispozita të çështjes së përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të komuniteteve përkatëse pakicë që jetojnë në komunat e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në zbatim të këtij qëllimi, komunave u është lënë në kompetencë të tyre që të nxjerrin akte në nivel komune, që do të mundësojnë avancimin e shkallës së përfaqësimit të të gjitha komuniteteve, në të gjitha fushat e jetës publike si parakusht i domosdoshëm në drejtim të konsolidimit të një shteti modern dhe demokratik.

Në funksion se sa është duke u përfillur parimi i përfaqësimit të komuniteteve pakicë në institucionet shtetërore dhe publike në këtë shtet, me ndryshimet kushtetuese si dhe me vet

Ligjin mbi Avokatin e Popullit, të njëjtit i është dhënë kompetencë për të mbikëqyrur shkallën e zbatimit të këtij parimi. Në mbështetje të këtyre dispozitave, avokati i popullit i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimit të mos diskriminimit si dhe përfaqësimit adekuat dhe korrekt të komuniteteve pakicë nëpër institucione shtetërore dhe publike në të gjitha nivelet dhe për këtë qëllim ai mund të iniciojë procedura sipas detyrës zyrtare ndaj secilit institucion për të cilin konsiderohet se i ka shkelur këto dy parime.

Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes së Ohrit, fillimisht në vitin 2004, Qeveria e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë formojë një sektor të veçantë për implementimin e kësaj marrëveshje. Sektor, pastaj në vitin 2007, u transformua në një organ tjetër të ashtuquajtur Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, i cili udhëhiqej nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë dhe ku njëra ndër përgjegjësitë kryesore të këtij sekretariati ndërlidhet me monitorimin dhe përmirësimin e nivelit të përfaqësimit të drejtë të komuniteteve pakicë në organet shtetërore dhe publike në të gjitha nivelet e pushtetit.

Në funksion të kësaj marrëveshje, ky sekretariat, në të njëjtin vit, aprovoi Strategjinë për Përfaqësim të drejtë dhe adekuat të komuniteteve etnike pakicë në IRJM. Kjo strategji pati për synim që numri i të punësuarve në institucione të korrespondoj, përafërsisht me rezultatet sipas regjistrimit të fundit zyrtar të popullatës në këtë vend.

Si derivat i ndryshimeve kushtetuese, u miratua edhe një ligj i veçantë për Komitetin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive²¹⁷, i cili komitet themelohet nga Kuvendi dhe në përbërjen e të cilit përfshihen (19) anëtarë nga radhët e deputetëve maqedonas dhe

²¹⁷ Ligji për Komitetin për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, Gazeta zyrtare nr. 150/2007.

shqiptarë të barabartë për nga numri, si dhe nga një anëtar nga radhët e deputetëve turq, romë, serbë dhe deputeteve boshnjak. Roli i këtij komiteti kryesisht ka të bëjë me shqyrtimin e çështjeve që lidhen me raportet ndërmjet bashkësive të ndryshme brenda vendit dhe po ashtu edhe me përcjelljen e zbatimit të parimit mbi përfaqësimin e drejtë të komuniteteve të ndryshme pakicë.

Sa i përket sistemit zgjedhor në Maqedoni, ai nuk parasheh masa të diskriminimit pozitiv për komunitete pakicë dhe se (120) deputetë të parlamentit zgjedhën përmes garave proporcionale në gjashtë zona elektorale të cilat zona janë të përcaktuara në bazë të ligjit zgjedhor në mënyrë që të kenë numër të përafërt apo të barabartë votuesish. Çdo zonë zgjedhore dërgon numër të njëjtë (20) deputetësh në Parlament.

6.1.5. Shqipëria

Kur flitet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë që jetojnë në Shqipëri, mund të thuhet se marrja me këtë problematikë, jo se është obligim që rrjedh nga përfshirja e Shqipërisë në shumë organizata ndërkombëtare dhe po ashtu, si detyrim në kuadër të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1999, por mbrojtja e këtyre komuniteteve vjen edhe si rrjedhojë e një realiteti të bazuar në bashkëjetesë për një kohë të gjatë ndërmjet shumicës absolute të bërë nga shqiptarët dhe pjesës tjetër të shoqërisë që e përbëjnë komunitet pakicë.

Në këtë drejtim, me qëllim të promovimit dhe avancimit të të drejtave të këtyre komuniteteve shteti shqiptar ka krijuar mekanizma institucional të nevojshëm për të trajtuar me seriozitet këtë çështje. Në këtë drejtim, me qëllim promovimit dhe përfshirjes të

qytetarëve, që u përkasin komuniteteve të ndryshme pakicë në Shqipëri, në vitin 2004 është themeluar Komiteti Shtetëror për Pakicat si një organ këshillëdhënës i Qeverisë shqiptare. Përmes këtij organi, propozohen masa konkrete lidhur me përmirësimin dhe avancimin e gjendjes së komuniteteve pakicë: greke, maqedonase, vllahë, rome, egjiptiane, serbe dhe malazeze, në të gjitha fushat si në atë të zhvillimit ekonomik, arsimor, social etj, duke rekomanduar zgjidhje konkrete lidhur me problemet e identifikuar.

Duke marrë parasysh faktin se Shqipëria është pjesë e Këshillit të Evropës, atëherë, edhe mbrojtja e komuniteteve pakicë është njëra ndër vlerat themelore demokratike që ajo i kushton vëmendjen e veçantë duke e arsyetuar këtë me faktin se, pa pjesëmarrjen e plotë të këtyre komuniteteve në jetën publike të vendit, shoqëritë që pretendojnë të jenë demokratike nuk mund të funksionojnë me efektivitet.

Për të vërtetuar se çfarë rëndësie i ka kushtuar Republika e Shqipërisë, çështjes së zbatimit të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të mbrojtjes së komuniteteve pakicë që jetojnë në këtë shtet, kjo mund të vërehet më së miri në dispozitat e Kushtetutës,²¹⁸ sipas të cilave çdo konventë ndërkombëtare e ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka epërsi ndaj ligjeve të brendshme që nuk pajtohen me to. Në këtë aspekt, bazuar në Ligjin Nr. 8496 të datës 03 qershor 1999, Kuvendi kishte ratifikuar Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, duke marrë kështu mbi vete detyrime që lidhen me mbrojtjen e këtyre komuniteteve.

²¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 122

Pavarësisht faktit se në Shqipëri deri sot nuk ka një ligj të veçantë që do të merrej ekskluzivisht me mbrojtjen e pakicave, prapëseprapë, përveç që kjo çështje është e përfshirë në Kushtetutën e vendit, e cila minoritetet i konsideron si pjesë e pandashme e rëndësishme e shoqërisë shqiptare, ekzistojnë edhe një sërë ligjesh tjera të veçanta që rregullojnë fusha të caktuara e që në kuadër të tyre shqyrtojnë edhe çështje që ndërlidhen me respektimin e të drejtave të këtyre komuniteteve pakicë, siç janë: Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurave Administrative, Kodi Zgjedhor, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Partitë Politike etj. si dhe akte tjera të rëndësishme nënligjore.

Sikurse sistemi zgjedhor në Maqedoni, po ashtu, edhe sistemi zgjedhor në Shqipëri nuk parashohin masa të diskriminimit pozitiv për pakicat etnike dhe të gjithë deputetët e Parlamentit shqiptar zgjedhën përmes konkurrencës në (12) zona zgjedhore të cilat janë të përcaktuara sipas (12) qarqeve administrative. Ndërkaq, numri i mandateve të deputetëve që secili qark dërgon në Parlament varet nga numri i votuesve në këtë që e përbëjnë territorin e atij qarku. Garat proporcionale në rajone bëhen përmes listave të mbyllura të partive dhe koalicioneve dhe pragu zgjedhor për partitë në çdo zonë zgjedhore është (3%) ndërsa për koalicionet është (5%). Partitë dhe koalicionet janë të obliguara që (30%) e kandidatëve në listat e tyre zgjedhore po ashtu sikurse edhe në Kosovë, të jenë femra.

Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve pakicë në Kuvendin e Shqipërisë, siç u theksua nuk kanë ndonjë masë të diskriminimit pozitiv të tyre, megjithatë mund të thuhet se nga zgjedhjet e para post komuniste të organizuara në Shqipëri, minoritetet kanë pasur përfaqësuesit e tyre në parlament. Për më tepër, Partia e të Drejtave të Njeriut, si një

subjekt politik që vepron në Shqipëri dhe që përfaqëson minoritetet, për një dekadë të tërë vazhdon të jetë pjesë e koalicioneve që kanë qeverisur me shtetin, pavarësisht spektrit politik të djathtë apo të majtë që kanë qenë në pushtet.

Ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet kur është fjala për Shqipërinë, është fakti se Republika e Shqipërisë me Kushtetutë ka paraparë mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar që jetojnë përkohësisht apo përherë jashtë kufijve të saj, duke ju siguruar ndihmën e nevojshme për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.²¹⁹ Kjo do me thënë për më tepër se Shqipëria ka detyrim kushtetues që të përkujdeset për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve të saj, në ato shtete ku shqiptarët janë komunitete pakicë sidomos fjala vjen për shqiptaret që jetojnë në trojet e tyre në Luginën e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, ku të drejtat e tyre vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të shkelen në mënyrë sistematike nga ana e autoriteteve shtetërore të këtyre vendeve.

²¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 8

KAPITULLI VII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga gjithë ajo që është elaboruar deri më tani në këtë temë, duke marrë për bazë në këtë rast edhe aspektet krahasuese me vendet e tjera si Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë, mund të konkludohet se: përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe pjesëtarët e tyre që jetojnë në Republikën e Kosovës nga aspekti i legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë gëzojnë të drejta të mëdha të cilat të drejta u janë garantuar me ligje e akte nënligjore por edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si akti më i lartë të saj.

Në kuadër të këtyre të drejtave siç është vërejtur, gjatë shtjellimit të punimit, pa dyshim se është e drejta e organizimit dhe pjesëmarrjes në parti politike, e drejtë kjo cila pakicave u mundëson përfaqësim të denjë në jetën politike të vendit, gjë që paraqet një hap të rëndësishëm për demokratizimin e shoqërisë dhe shtetit. Po ashtu, siç u vërtetua komunitetet pakicë edhe në sferën e punësimit kanë të drejta të rezervuara sa i përket përfaqësimit të tyre në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke filluar nga nivelet komunale, e deri tek nivelet më të larta të pushtetit, në Zyrën e Presidentit të Kosovës.

Konkluzionet:

Ato, që realisht, mund të konsiderohen si konkluzione të këtij punimi doktorial janë të paraqitura si në vijim:

- Duke u nisur nga fakti se sot në Evropë kemi një mungesë sistemi koherent, i cili do të merrej me mbrojtje të minoriteteve kombëtare në Evropë, dhe të cilit i

mungojnë dispozitat, apo mekanizmat të përgjithshëm detyruese të së drejtës ndërkombëtare që do të ndikonin në respektimin e këtyre dispozitave nga të gjitha shtetet që kanë probleme me çështjet e minoriteteve, pavarësisht kësaj, mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve në Kosovë me Kushtetutë dhe akte ligjore, i është kushtuar një rëndësi e veçantë që rrallë mund ta hasësh në vende të tjera. Nisur nga kjo pikëpamje, për sa i përket respektimit të drejtave të minoriteteve në të ardhmen Kosova mund të shfrytëzohet si model, jo vetëm për rajonin por edhe për gjithë Evropën, si një shtet shumë etnik, ku serbët dhe pakicat tjera që jetojnë në Kosovë gëzojnë shkallën më të lartë të avancimit të të drejtave të tyre.

Nisur nga kjo që u theksua kur bëhet fjalë për rregullimin e pozitës kushtetuese dhe juridike të komuniteteve që përfaqësojnë pakicën brenda një vendi, nuk ka asnjë dilemë, se sot Kosova i tejkalon edhe standardet e së drejtës ndërkombëtare, kur është fjala për çështjen e të drejtave komuniteteve. Vlerësim të veçantë në këtë drejtim meriton avancimi i të drejtave të përgjithshme të komunitetit serb, të drejta këto që janë përcaktuar nëpërmjet Planit të Ahtisarit që si të tilla janë bërë pjesë normative e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë madje, edhe primatin e të ekzistuarit si akti suprem juridik brenda shtetit.

- Duke u nisur nga rrethanat e deritashme që kanë mbretëruar në vendin tonë, mund të konkludohet se Kosova paraqet një test dhe sfidë për sistemin ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të të drejtave të pakicave, sepse respektimi i të drejtave të pakicave në Kosove i avancojnë kushtet për stabilitet politik dhe shoqëror dhe për një paqe koherente në Kosovë dhe rajonin. Përveç një mbrojtje të përgjithshme me Kushtetutë, konfirmohet se në Kosovë, ekzistojnë edhe

një varg obligimesh mbrojtëse ekskluzive për komunitetet pakicë, që në fakt përbëjnë një sistem gjithëpërfshirës për mbrojtjeje të minoriteteve. Ndryshe, këto të drejta të komuniteteve pakicë që jetojnë Kosovë mund të trajtohen edhe si të drejta plotësuese në raport me të drejtat e pjesëtarëve të tjerë që janë shumicë.

- Sa i përket çështjes së përfaqësimit apo rezervimit (20) vendeve për pjesëtarët e komuniteteve pakicë prej (120) vendeve sa ka Parlamenti i Kosovës, mund të konkludohet se edhe në këtë aspekt Kosova paraqet rast të veçantë sui generis në praktikën e të drejtave të komuniteteve pakicë. Pra, çështja e ndarjes së vendeve të garantuara dhe të rezervuara për minoritetet, jo vetëm në kuvend por edhe në qeveri, gjyqësor etj. përbën rastin e pa precedencë në historinë e shtetit dhe të së drejtës jo vetëm në rajon por edhe më gjerë.
- Republika e Kosovës ka një kornizë ligjore të sofistikuar dhe shumë të favorshme për sa i përket, punësimit dhe përfaqësimit proporcional të komuniteteve pakicë në Shërbimin Civil të Kosovës. Pra, si konkluzion, kur flasim për përfaqësimin nga ana e minoriteteve në shërbimin civil gjatë këtij punimi u konstatua se serbët, boshnjakët dhe turqit kanë mbi përfaqësim të minoriteteve në proporcion me ashkalinjët, egjiptianët, goranët dhe romët, të cilët janë dukshëm më të nën-përfaqësuar. Arsyeja pse është një gjendje e tillë e nën- përfaqësimit të kësaj pjese të minoritetit varet nga shumë faktorë, por faktori kryesor është mungesa e kualifikimeve arsimore të kësaj pjese të komunitetet. Ndërsa, kur është fjala për mosarritjen e kuotës nga ana e pjesëtarëve të komunitetit serb, përveç faktorëve të tjerë të rëndësishëm, pengesë ka qenë sidomos bojkotimi i institucioneve vendore nga ana e këtij komuniteti si pasojë e politikës së presioneve të udhëhequr nga

autoritetet e Beogradit. Pengesë tjetër ka qene dhe është gjithashtu edhe refuzimi i shkollimit të lartë të pjesëtarëve të këtij komuniteti në institucionet shkollore e universitare të Kosovës, për dallim nga orientimi i tyre për shkollim në institucionet shkollore në anën veriore të Mitrovicës, institucione këto të përfshira në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë, dhe për pasojë diplomat e lëshuara nga këto institucione së paku deri tani kanë qenë pa vlefshme dhe nuk janë pranuar nga institucionet publike të Republikës së Kosovës.

- Kur është fjala për përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal sipas hulumtimeve të kryera, rezulton se gjatë proceseve të rekrutimit të stafit nëpër administrata komunale, shpallen konkurse mbi aplikim për vende të punës, enkas për pjesëtarë të komuniteteve pakicë dhe se ato përsëriten dhe u zgjaten afatet, madje deri në (3) herë, standard ky të cilin nuk mund ta gjesh në asnjë dispozitë ligjore dhe as në praktikë të vendeve të rajonit dhe më gjerë.
- Një konkludim tjetër që rrjedh nga ky studim është fakti se arritja e përfshirjes së komuniteteve pakicë në institucionet e vendit nuk është vetëm një proces i brendshëm, por ky proces është shumë i ndikuar nga faktorë të tjerë të jashtëm. Ky element është vënë re shumë herë gjatë këtij punimi, posaçërisht kur bëhet fjalë për integrimin e plotë të pjesëtarëve të komunitetit serb brenda institucioneve publike në Kosovë. Presionet e vazhdueshme politike, si dhe presionet e jashtme mbi pjesëtarët e këtij komuniteti kanë ndikuar në një masë të madhe që shkalla e rezistencës, për tu bashkuar me institucionet e Kosovës të rritet vazhdimisht. Bisedimet që janë duke vazhduar në Bruksel ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe

të Serbisë mund të premtojnë se rezultatet e tyre do të kontribuojnë në përfshirjen më të madhe të pjesëtarëve të komunitetit serb në institucione të vendit.

- Avancimi i të drejtave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë shihet edhe më Marrëveshjen e arritur në mes të dy Kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar, me datë 19 prill 2013. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte shuarja e strukturave paralele të përqendruara në veri të vendit. Kjo marrëveshje ka shumë mangësi dhe paqartësi e cila më shumë krijon probleme se sa që i zgjidhë ato. E para, me anë të kësaj marrëveshje nuk është rregulluar edhe gjykimi i rasteve në shkallë të parë, të cilat raste gjykohen në gjykatën themelore. Pastaj kjo marrëveshje bie ndesh me ligjin mbi gjykatat, i cili parasheh se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë të drejtë të shtrijnë juridiksionin e tyre në tërë territorin e vendit dhe treta dhe e fundit me këtë marrëveshje nuk është specifikuar dhe nuk është qartësuar edhe (15%) i vendeve të rezervuara për komunitete brenda këtyre gjykatave, ashtu siç është paraparë me ligjin mbi gjykatat. Pra, sipas kësaj shihet se krijimi i një sistemi efektiv të drejtësisë në Kosovë, mbetet akoma një sfidë për institucionet e vendit edhe pas një periudhe prej (15) vitesh nga koha e fillimit të ndërtimit dhe krijimit të shtetësisë së Kosovës. Megjithatë, kjo sfidë si e tillë, më tepër është politike dhe se vendosja e një sistemi të drejtësisë gjithëpërfshirës në tërë territorin e Republikës së Kosovës paraqet një detyrim madhor për faktorin vendor dhe atë ndërkombëtar. Vendosja në një ombrellë e tere sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të autoriteteve kosovare, sepse sistemi i drejtësisë si çdo sistem tjetër në botë duhet të ketë një hierarki institucionale dhe jo institucione paralele, sepse për ndryshe nuk mund të

ketë sistem të rregullave dhe përgjegjësisë dhe nuk mund të themi se ekziston një sistem juridik unik dhe në përputhshmëri me Kushtetutën e vendit.

Rekomandimet:

Duke i nisur nga fakti se avancimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve pakicë nacionale paraqet një kusht stabiliteti për Kosovën dhe për rajonin, atëherë faktori ndërkombëtar duhet ta ketë parasysh që çështjen e këtyre pakicave e veçanërisht të atij serb mos ta shoh si minoritet të privilegjuar karshi shumicës dhe komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosove.

Arritja e një stabiliteti politik të Kosovës dhe rajonit, si dhe integrimi i tyre drejt BE-se arrihet duke u përpjekur që çështjet e minoriteteve në rajon t'i shoh nga i njëjti prizëm, duke i trajtuar dhe përkrahur njëtrajtshëm të gjitha këto komunitete pakicë, pa privilegjuar asnjërën nga to. Prandaj si rezultat që u tha më lartë rekomandojmë:

- Që bashkësia ndërkombëtare të shtojë përpjekjet dhe trynitë e saj mbi Qeverinë e Beogradit, që kjo e fundit të ndalojë presionet dhe ndikimet e saj mbi komunitetin pakicë serb që jeton në Kosovë, në mënyrë që ky komunitet të integrohet brenda këtyre institucioneve, duke i njohur ato si institucione të vetme legjitime, që janë në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj pa dallim race, gjinie, kulture, etnie etj. Shkëputja një herë dhe përgjithmonë nga politika e Beogradit dhe orientimi drejt integritetit në institucionet e Kosovës, do të ndikonte që të përmirësohej niveli i përfaqësimit, sidomos i komunitetit serb por edhe i komuniteteve të tjera. Pra, ky komunitet duhet të respektojë legjislacionin e Kosovës duke përfshirë në këtë

kontest edhe të drejtat e komuniteteve të tjera pakicë që jetojnë në Kosovë, ashtu edhe siç është e paraparë edhe me nenin 20 të Konventës Kuadër të vitit 1995.

- Rekomandohet gjithashtu, që institucionet e vendit, e veçanërisht politikëbërësit nga radhët e komuniteteve pakicë që mbajnë vende të garantuara, të bashkërendojnë bashkërisht përpjekjet në mënyrë që të ngritin vetëdijen tek vetë këto komunitete pakicë, për shkollim, kualifikim dhe integrim brenda këtyre institucioneve.
- Duke u mbështetur në disa prej konkluzioneve të dala sidomos sa i përket çështjes së përfaqësimit gjegjësisht punësimit të komuniteteve pakicë, që jetojnë në territorin e Kosovës, ku siç është vërejtur pavarësisht miratimit të legjislacionit të favorshëm për komunitetet, në praktikë ka akoma ngecje nga ana e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike dhe shpesh herë ka nën-përfaqësim të një pjese të komuniteteve pakicë. Prandaj, sa i përket çështjes së përfaqësimit të komuniteteve pakicë nëpër institucione dhe ndërmarrje publike, është shumë vështirë të parashikohet se mund të ketë rritje të përfaqësimit të tyre pa zbatimin e masave aktive të punësimit. Prandaj, institucioneve publike u rekomandohet që ta rrisin komunikimin e tyre me masat aktive të punësimit për të siguruar se obligimet e politikave kuptohen ashtu siç duhet nga të gjithë zyrtarët nëpër institucionet e vendit dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë bazuar në kornizën ligjore të sofistikuar dhe shumë të mirë për sa i përket punësimit dhe përfaqësimit proporcional.
- Po ashtu, rekomandohet që të bëhet vlerësim i rregullt mbi progresin e arritur në drejtim të përmirësimit të punësimit të komuniteteve pakicë, për të gjitha institucionet si dhe duhet parashikuar që dështimi i vazhdueshëm në zbatimin e

masave aktive të punësimit nga ana e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike do të ketë pasoja lidhur shkurtimet buxhetore.

- Gjatë këtij studimi po ashtu është vërejtur se Qeveria e Kosovës duke dashur të tregojë përkushtimin maksimal të saj para bashkësisë ndërkombëtare, nuk hezitonte t'i jepte të drejta minoriteteve në Kosovë, shpeshherë edhe duke bërë diskriminim për minoritetet në Kosovë. Duke vepruar në këtë është krijuar një numër shumë i madh i mekanizmave institucionalë të cilët merren me çështjen e komuniteteve dhe të cilët janë të përfaqësuara kryesisht nga komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë. Këta mekanizma janë të organizuar dhe funksionojnë si në nivelin qendror të pushtetit, po edhe në nivelin e pushtetit lokal. Ka raste kur te këta mekanizma shfaqet konflikti i kompetencës në mes tyre në të cilët ka një përfaqësim jo të drejtë të të gjitha komuniteteve. Prandaj, për të eliminuar këto probleme, me ndryshimet legislative që mund të ndodhin në të ardhmen duhet të parashihet formimi i mekanizmave ndoshta më të paktë në numër, por të cilët do të ishin më të konsoliduar në mënyrë që të arrihet një përfaqësim me serioz dhe me i drejtë i të gjitha komuniteteve në këta mekanizma, ku roli i tyre në institucionet shtetërore do të ishte më i madh dhe në këtë mënyrë, do të arrihej të shmangej konflikti i kompetencës.
- Qeveria e Kosovës rekomandohet që të përgatis politika dhe të përpilojë dokumente më të avancuara dhe më të drejta, në mënyrë që të arrihen rezultate më të sakta rreth statistikave të popullsisë minoritare që jeton në Kosovë, për shkak se, nga ato varet shumë përcaktimi i një varg të drejtave për të gjitha komunitetet pakicë dhe në këtë sens edhe përcaktimi i kuotave për përfaqësim në institucione si në rastet e

planifikimit, ndarjes së buxhetit dhe në çështje të tjera që lidhen me komunitetet në përgjithësi.

- Institucionet shtetërore të Kosovës, në të ardhmen, me rastin e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve nuk duhet të fokusohen vetëm në respektimin e kuotave sipas legjislacionit të aplikueshëm, por duhet të angazhohen edhe në respektimin e profesionalizmit dhe kriterëve të aplikuar nëpër konkurse.
- Rekomandohen ndryshime të nevojshme legjislative sa i përket vazhdimit të konkursit edhe për (7) ditë të tjera vetëm për minoritete në nivelin qendror sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil, ngase kjo përbën tejkalim të standardeve të demokracisë apo edhe shkelje të së drejtës ndërkombëtare, duke ditur faktin se gjuha serbe është gjuhë zyrtare në Kosovë dhe se çdo konkurs që hapet publikohet në të dy gjuhët, si në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Ky standard bie ndesh edhe me nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili i trajton si të barabartë para ligjit të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallime etnie.
- Rekomandohet që institucionet publike të Kosovës, po ashtu, të angazhohen në drejtim të krijimit të një skeme për punë praktike, në të cilën do të përfshiheshin sidomos ato komunitetet pakicë që janë të nën-përfaqësuara dhe se këto skema për punë praktike, brenda mundësive buxhetore të jenë me kompensim me qëllim që të bëhen më atraktive për pjesëtarët e këtyre komuniteteve pakicë. Nga ana tjetër, një qasje e tillë mundëson që komunitetet pakicë të familjarizohen me punën e institucioneve publike dhe të fitojnë një përvojë në kuadër të punëve që ato institucione bëjnë.

- Po ashtu, për ta arritur një shkallë më të kënaqshme të përfaqësimit të komuniteteve pakicë, rekomandohet që institucionet publike të vendit, të krijojnë skema trajnimi me fokus të veçantë për ato komunitete pakicë siç u tha edhe më sipër që janë tejet të nën-përfaqësuar, e që këto skema të trajnimesh të synojnë kërkesat dhe nevojat të këtyre komuniteteve, për tu aftësuar në profile të ndryshme e atraktive që shkojnë në favor të interesave të komuniteteve.
- U rekomandohet institucioneve të vendit të bëjnë përpjekje të vazhdueshme, që në bashkëpunim edhe me faktorin ndërkombëtar, të ndërtojnë një sistem unik të drejtësisë, ku do të ekzistojë hierarkia e institucioneve të drejtësisë dhe jo sistem paralele siç është përcaktuar me marrëveshjen shqiptaro-serbe për themelimin e një Gjykatë të Apelit në veri të vendit. Pra, këto institucione duke u bazuar në praktika të vendeve më të zhvilluara, do të duhej të ndërtonin një sistem me hierarki të qartë institucionale dhe të angazhohen, që duke respektuar parimin e profesionalizmit dhe meritës si dhe kuotave, të cilat janë të përcaktuara me legjislacion, t'i integrojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë në strukturat organizative të këtij sistemi unik. Sepse vetëm në këtë mënyrë, mund të shihen strukturat paralele të përbëra nga serbët lokalë të mbështetur nga Qeveria e Beogradit, dhe vetëm në këtë mënyrë mund të bëhet integrimi i vërtetë i tyre në institucionet e vendit dhe ku do të krijohet një sistem i rregullave dhe përgjegjësi, i cili do të vlente për tërë territorin e vendit.

Përfundimisht, niveli në të cilën ndodhen sot të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë, mund të shërbejë si një shembull apo model i avancimit dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve për gjithë rajonin por edhe më gjerë.

Bibliografia:

Burime parësore:

- Abit Hoxha (KCSS). Pesë vite të sektorit të sigurisë në Kosovë - Analizë kontekstuale 2008-2013, Prishtinë, 2013.
- Agjencioni Statistikor i Kosovës, Rezultate përfundimtare të regjistrimit të popullsisë, shtator 2012
- Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë 2010,
- Asambleja Parlamentare, Rekomandimi 285(1961), 1961
- Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 2200 A(XXI), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike , 1966
- Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Pakti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike
- Asambleja Parlamentare, Rekomandimi 1134(1990), 1990
- Asociacioni Qytetar MOST, Doracaku për Përfaqësim, 2010
- Dokumenti i takimit të Kopenhagës të Konferencës për Dimensionet Njerëzore të KSBE-së, Kopenhagë, 29 qershor 1990
- Enver Hasani& Ivan Cukalovic, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2013
- ECHR, Art. 1 dhe 24, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e nënshkruar më 4 Nëntor 1950
- Enti i Statistikave të Kosovës. Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës 1948-2006. Shkurt 2008

- European Centre for minority issues Kosovo, Komunitetet minoritare në rezultatet e regjistrimit të popullsisë 2011 në Kosovë, dhjetor 2012
- Florence Benoti-Rohmer, Çështja e minoriteteve ne Evropë, Tiranë 1996
- Grupi Ndërkombëtarë i Krizave, Raporti Evropian, 2009
- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (IKQL) Raport: Korniza dhe Dispozitat për Komunitetet Pakicë, 5 Maj, 2009
- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale(IKQL), Centralizimi një peshë e rëndë për ta realizuar, 2011
- KIPRED- Review of "Reform of Local Self-Government and Public Administration in Kosovo: Final Recommendation" By the council of Europe Decentralisation Mission in Kosovo, 2003
- Konventa Kornizë për Mbrojtjen Pakicave Kombëtare, 1995
- Kosovo Human Development Report 2012: Privat sector and employment, 2012
- Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar ne prill 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komuna në Republikën e Kosovës, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre ne Republikën e Kosovës, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës,2010
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, 2007

- Kuvendi i Kosovës, Ligji nr.03/L-046 për Forcat e Sigurisë, qershor 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Kosovë, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji nr.03/L- 082 mbi Shërbimin në FSK, neni 3, qershor 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-45 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
- Kuvendi i Kosovës Ligji 03/L-076 mbi Policinë, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, gusht, 2010
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-063 për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, prill 2012
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, 2006
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, prill 2012
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, shtator 2011
- Kuvendi i Kosovës , Ligji Nr.03/L-199 për Gjykatat
- Kuvendi i Kosovës Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, shkurt 2004
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, shkurt 2012
- Marrëveshja Kosovë-Serbi, 19 Prill 2013
- Ministria e Administratës Publike, Rregullorja Nr. 04/2010 për Procedurat e Përfaqësimit të duhur dhe proporcional të komuniteteve që nuk janë shumicë në Shërbimin Civil të Kosovës, 2010
- Ministria e Administratës Publike, Raporti tre mujor mbi të punësuarit në Shërbimin Civil , dhjetor 2012
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve të Komunave
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport përmbledhës për Promovimin e të Drejtave të Njeriut në Komunitet në Republikën e Kosovës, 2012
- Ministria për Komunitete dhe Kthim, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, Raporti i OSBE-së për Vlerësimin e Komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës ,2013
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë, 2009
- Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 2007

- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, mars 2014
- Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për komunitete dhe Kthim , 2010
- Raporti i Progresit për Kosovën, i hartuar prej Komisionit Evropian 2009, 2010, 2011, 2013,2014
- Raporti përmbledhës për promovimin e të Drejtave të Njeriut në Komunitet e Republikës së Kosovës(2012)
- UNMIK, Rregullore Nr. 1999/1 për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,1999
- UNMIK, Rregullore Nr. 2001/1 për Strukturën e Përbashkët të Administratës së Kosovës, 2000
- UNMIK, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/33 për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, nëntor 2001
- UNMIK, Rregullorja Nr. 2004/9 mbi Komisioni Qendror të Zgjedhjeve,2004
- UNMIK, Rregullorja Nr. 2007/26 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2004/12 mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, gusht 2007
- UNMIK, Rregullorja Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, 2001
- UNMIK, Rregullorja Nr. 2007/30 për Qeverisjen e Komunave në Kosovë, 2007
- Taylor, Hannis, The Outlook for Parliamentary Government. The North American Review, 1895

- Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim mbi punësimin e pjesëtarëve të Komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në Ndërmarrjet Publike, maj 2013

Burime dytësore:

- Adamson, Kevin and Jovic, Dejan, “The Macedonian–Albanian political frontier: the re-articulation of post-Yugoslav political identities”, *Nations and Nationalism* 10 (3), 2004.
- Agon Demjaha and Lulzim Peci, “Insurgencies in the Balkans: Albanian Liberation Armies”, in Albrecht Schnabel and Rohan Gunaratna ed. *Wars from Within: Understanding and Managing Insurgent Movements*, London: Imperial College Press, 2015.
- Aziri, Etem, “Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement, *Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures*.
- Braham, M., *The untouchables: a survey of Roma people of central dhe Eastern Europe*. Geneva:UNHCR, 1993.
- Beha, Adem, “Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?,” *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol 13, No 4, 2014.
- Bieber, Florian, “The instrumentalisation of Minorities in the Montenegrin Dispute over Independence”, *The European Centre for Minority Issues*, March 2002.

- Biserko, Sonja, Minorities in Serbia, Belgrade: Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, 2000.
- Bjelajac, Mile and Žunec, Ozren “The War in Croatia, 1991-1995”, Round table in Zagreb, Scholars Initiative report, 20 October 2007.
- Burg, Steven, and Shoup, Paul, The War in Bosnia-Herzegovina: Ethnic Conflict and International Intervention, New York: M. E. Sharpe, 1999.
- “Bosnia: What does Republika Srpska want?”, International Crisis Group, Europe Report N°214, 6 October 2011.
- Brand, Judith and Idrizi, Valdete, “Grass-root Approaches to Inter-Ethnic Reconciliation in the Northern Part of Kosovo”, Kosovar Institute for Policy Research and Development, Prishtina, February 2012.
- Cahn, C., ed, “Roma Rights: Race, Justice, dhe Strategies for Equality” New York: The International Debate Education Association, 2002.
- Cahn, C., Chirico, D., McDonald, C., Mohacsi, V., Proc, T., Szkely, A., Roma in the educational system of Central and Eastern Europe, in the Roma Resource Book, Open Society Institute-Institute for Educational Policy, Budapest, 1999.
- Demjaha, Agon “Kosovo: A Perspective from Inside”, in Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel ed., Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, United Nations University Press, Tokyo, December 2000.

- Džankić, Jelena, “Montenegro’s Minorities in the Tangles of Citizenship, Participation, and Access to Rights”, *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol. 11, No 3, 2012.
- ECMI Kosova, ‘Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave të komuniteteve dhe përdorimi i treguesve: sfidat dhe mundësitë’, 2013
- ECMI Kosova, ‘Doracak për anëtarët e KKK-së. Dokumente ligjore dhe doracakë për trajnime’, 2010
- ECMI Kosova, ‘Procesi ligjvënës në Kosovë: doracak për organet për pjesëmarrje politike të komuniteteve’, 2011
- ECMI Kosova, ‘Politikat e gjuhëve në Kosovë. Zbatimi në marrëdhëniet me organet publike’, 2011
- ECMI Kosova, ‘Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore: pilotimi i përdorimit të treguesve në punën e Kuvendit të Kosovës, 2014.
- Greene , M. Friedman, J. dhe Bennet, R. (2012). Ndërtimi I Shërbimit Policor në një vakum të Sigurisë: Përpjekjet Ndërkombëtare në Kosovë, 1999 - 2011. SHBA: Universiteti Princetown
- Gearóid Ó Tuathail and John O'Loughlin “After Ethnic Cleansing: Return Outcomes in Bosnia-Herzegovina a Decade Beyond War”, *Annals of the Association of American Geographers*, Vol.99, Issue 5, 2009.
- Glenny, Misha, *The Fall of Yugoslavia*, 3rd edition, London: Penguin Books., 1996.
- Hivzi Islami, “Demographic Reality of Kosovo”, in Dusan Janjic and Shkelzen Maliqi, eds., *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of*

the Balkans, Subotica: Open University, European Civic Centre for Conflict Resolution, 1994.

- North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, International Crisis Group, Europe Report N° 211, 14 March 2011
- Ortakovski, Vladimir, "Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia", Southeast European Politics, Vol. 2, No. 1, May 2001.
- Qehaja , R., Ferati , H., Kosumi , K., & Qehaja, F. (2008). Themelimi, operacionalizimi dhe funksionimi demokratik i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë .
- Prof. Dr. Hilmi Ismaili dhe Prof. Dr. Fatmir Sejdiu - "Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore", Prishtinë 2009
- Prof. Dr. Arsim Bajrami – "Demokracia parlamentare", Prishtinë 2005
- Ron, James, "Boundaries and violence: Repertoires of state action along the Bosnia/Yugoslavia divide," Theory and Society, No. 29, 2000.
- Rossi, Michael, "Ending the impasse in Kosovo: partition, decentralization, or consociationalism?," Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity, Vol. 42, No. 5, 2014.
- Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009-2015
- "Second Opinion on Montenegro adopted on 19 June 2013", ACFC/OP/II(2013)002, Advisory Committee on the Framework Convention for the

Protection of National Minorities, Council of Europe, Strasbourg, 24 February 2014.

- “Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation”, International Crisis Group, Europe Report N°223, 19 February 2013.
- “Serbia: Maintaining Peace in the Presevo Valley”, International Crisis Group, Europe Report N°186, 16 October 2007.
- Stevens, G. (2008). Mbushja e Vakumit: Sigurimi i Mbrojtjes dhe Mjetet Juridike për Minoritetet në Kosovë. Prishtinë: Grupi Ndërkombëtar për të drejtat e Minoriteteve.
- The Lausanne Principle: Multi ethnicity, Territory and the Future of Kosovo’s Serbs, European Stability Initiative, Berlin/Pristina, 7 June 2004.
- The Position of National Minorities in the Republic of Croatia - Legislation and Practice, Ombudsman Report, Republic of Croatia, Zagreb, April 2008.
- Žunec, Ozren, “Operations Flash and Storm’, in Magaš and Žanić, The War in Croatia and Bosnia-Herzegovina 1991-1995, New York: Frank Cass Publishers, 2001.

Burime tjera:

- Estimation of Kosovo Population 2012, Press Release, Kosovo Agency of Statistics, 06 March 2013; <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40> (16.11.2014).

- Davies, Jack, “Is Macedonia on the brink of another ethnic conflict,” Vice, 15 July, 2014,<http://www.vice.com/read/albanians-in-macedonia-are-pissed-off-jack-davies-777> (27.10.2014).
- Independent Montenegro: Early Assessment and Prospects for Euro-Atlantic Integration,” Committee Reports, 160 CDS 07 E BIS, 2007 Annual Session of NATO Parliamentary Assembly, 2007; <http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=1162> (02.11.2014).
- Karadaku, Linda, “Kosovo completes 2011 census without data from north,” SETimes, 16 October 2012; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/10/16/feature-04 (20.11.2014).
- Military Technical Agreement”, <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm> (09.01.2015).
- Minorities in Montenegro Legislation and Practice, Report number 1, Human Rights Protection Program, Youth Initiative for Human Rights, Montenegro, February 20th 2007.
- Montenegro formally recognises Kosovo's independence, SETimes, 13 October 2010; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/10/13/feature-01 (02.11.2014).

- Political Participation, Office of the Prime-minister of the Republic of Kosovo, Office for Community Affairs; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=2,88> (02.12.2014).
- Rettman, Andrew, "Ethnic Serbs vote as normal in Kosovo elections," EUobserver, 10 June 2014; <http://euobserver.com/foreign/124538> (02.12.2014).
- Structure of population by ethnicity per municipalities in %, "Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro, <http://www.monstat.org/eng/page.php?id=393&pageid=57> (30.10.2014).
- Sfidat në procesin e emigrimit në Kosovë: Emigrimi në rritje i romëve, ashkalinjëve, dhe egjiptasëve
<http://www.ecmikosovo.org/wpcontent/uploads/2014/12/Albanian.pdf>
- Përngjitja e ndarjes: Themelimi i një bordi të përbashkët për qytetin e Mitrovicës
http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Policy-Brief_Joint-Board-Final-shqip.pdf
- Përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve politike nga ana e ECMI Kosovës: Komunitet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik -
<http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/10/Albanian1.pdf>
- Një vështrim i shkurtër mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë -
<http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/11/Albanian.pdf>
- Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një shikim i çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Information-Bulletin-Minority-Party-Elections-SQ.pdf>